Seid Ismail Ali

Bazat e edukimit islam

LOGOS·A

BAZAT E EDUKIMIT ISLAM

Seid Ismail Ali

©LOGOS·A
SHKUP
PRISHTINË
TIRANË
2021

BOTON: LOGOS-A
BIBLIOTEKA: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili
Kryeredaktor: Husamedin Abazi
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahimi

Redaktor gjuhësor: Shkëlzen Halimi
Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi
Redaktor teknik: Sedat Halimi
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili
Shtypi: Focus Print
Rr. Pellagonia 3 - Shkup

www.logos-a.com
ISBN 978-9989-58-858-7 Paperback
Copyright©Logos-A, 2021
©Center for Advanced Studies
©The International Institute of Islamic Thought (IIIT)

Tirazhi: 800

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës.
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.
Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.

MENDIMI ISLAM

BAZAT E EDUKIMIT ISLAM

Seid Ismail Ali

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:
Ziber Lata

TITULLI I ORIGJINALIT:
Seid Ismail Ali,
أصول التربية الإسلامية
USULU 'T-TERBIJJETI 'L-ISLAMIJJEH,
The International Institute of Islamic Thought (IIIT),
First Edition 1423/2003, Herndon, USA
ISBN: 978-9773-422-64-6 (Hardback)

Ky libër u botua me mbështjen e
Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam (IIIT)

PËRMBAJTJA:

Parathënie për botimin shqip 7
Hyrje 9

KREU I PARË 15
Struktura konceptore 17
Hyrje 17
E para: kuptimi "terbijeh" (edukim) 20
E dyta: orientimi islamik i edukimit 39
E treta: edukimi islam 58
E katërta: metodologjia e hulumtimit në fundamentet e edukimit islam 72

KREU I DYTË 89
Përbërësit themelorë të doktrinës islame 91
Hyrje 91
E para: Allahu 94
E dyta: Universi 109
E treta: njeriu 125
E katërta: shoqëria 136
E pesta: njohja 149

KREU I TRETË 165
Themelimi i pedagogjisë sipas Kur'anit 167
Hyrje 167
E para: parimet themelore kur'anore 168
E dyta: probleme pedagogjike 195

KREU I KATËRT 247
Tradita pejgamberike si argument pedagogjik 249

Hyrje 249
Pozita e sunetit në raport me Kur'anin Fisnik 250
Rëndësia e mbështetjes së aktivitetit pedagogjik në sunet 254
Themelimi epistemologjik i strukturës kulturore 258

KREU I PESTË 319
Eksperienca kulturore 321
Kultura dhe pedagogjia 321

KREU I GJASHTË 387
Trashëgimia pedagogjike 389
Hyrje 389
Shkollat e mendimit pedagogjik islam 416
Shkolla fikhore 416
Shkolla kelamiste 424
Shkolla filozofike 432
Shkolla sufiste (mistike) 442
Disa shembuj nga trashëgimia jonë pedagogjike 451

KREU I SHTATË 465
Problemet e së tashmes dhe ambiciet e së ardhmes 467
Problemet dhe sfidat aktuale të umetit 468
Jehonat pedagogjike 503
...derisa ta ndryshojmë veten tonë! 515

Përfundim 538

Parathënie për botimin shqip

Pedagogjia është një fushë studimore dinamike e cila zhvillohet në përputhje me rrethanat dhe kushtet e kohës, edhe pse thelbi çdoherë është i njëjtë, pra, kërkon të edukojë njeriun. Nisur nga ky koncept, mësimet tradicionale islame mund të konsiderohen si një fondament i çmuar, por i papërpunuar dhe i përshtatur për edukimin e muslimanit modern.

Pejgamberi (a.s.) është edukatori më i shkathët dhe më i denjë që ka njohur historia e njerëzimit, sepse për një periudhë dydekadëshe ia arriti ta përmbysë injorancën kolektive që kishte kapluar atëbotë njerëzimin. Në dy tre shekujt e parë pas vdekjes së tij muslimanët arritën t'i zhvillojnë mirëfilli konceptet edukative për kohën e vet, mirëpo pastaj ky zhvillim filloi të zbehet dhe të stagnojë.

Në anën tjetër, në perëndim konceptet pedagogjike filluan të zhvillohen furishëm dhe të përhapen anembanë botës.

Shekulli XX është periudha e konsolidimit dhe perfeksionimit të shumë disiplinave shkencore, prandaj edhe muslimanët, në pamundësi për t'i zhvilluar vetë dhe sipas paradigmës së tyre ato, filluan t'i përshtatin mësimet tradicionale islame me zhvillimet moderne të botës së qytetëruar. Pikërisht në këtë frymë edhe profesor Seid Ismail Ali punoi dhe derdhi mundin e vet në këtë sferë, ku filloi t'i ripërtërijë konceptet klasike brenda kallëpeve pedagogjike moderne.

Në këtë mënyrë ai paraqet një mori parimesh, konceptesh dhe fondamentesh islame të ritrajtësuara sipas konceptit pedagogjik modern.

Vepra "Bazat e edukimit islam" e përkthyer nga gjuha arabe, renditet ndër veprat që shtëpia botuese Logos-A u ka ofruar lexuesve dhe dashamirësve të pedagogjisë në përgjithësi dhe të pedagogjisë islame në veçanti.

Botuesi

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit

Hyrje

Zakonisht hyrjet e librave u japin përgjigje përafërsisht pyetjeve si kjo: përse duhet ky libër? Mirëpo, unë kërkoj falje nga lexuesi, sepse i jam shmangur kësaj pyetjeje, për t'iu përgjigjur një pyetjeje tjetër: "Përse ky shkrimtar ta shkruajë këtë libër?", edhe pse realisht shumë pjesë të kreut të parë ngërthejnë një përgjigje të zgjeruar për pyetjen e parë "Përse duhet ky libër?".

Diskutim i ri i shtruar duket si një trajtë e re e bisedës për unin. Krahas faktit se ky diskutim është aktual, e siguroj lexuesin se kjo tematikë ndërlidhet ngushtë edhe me orientimin që trajton kjo vepër. Tregu i librit në Botën Islame njeh shumë vepra që mbajnë titullin e njëjtë "Bazat e edukatës islame", prandaj kjo e ngarkon shkrimtarin e ri me barrën dhe përgjegjësinë e shmangies së përsëritjes dhe të ofrimit të qasjes së re.

Kur u themelua Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Ez'herit në vitin 1971, për herë të parë pamë një fakultet edukimi me program të veçantë të quajtur "Edukimi islam". Atëkohë, dekani i ndjerë, doktor Muhamed Ibrahimi Kadhimi kërkoi nga unë ta ligjëroj lëndën në fjalë, dhe atë në studimet pasuniversitare (*të përgjithshme dhe të specializuara*).

E pranova detyrën dhe nisa të mendoj: si ta realizoj këtë detyrë kur lëmi në fjalë është pothuaj i palëvruar, përpos tri librave: "Et-Terbijetu fi 'l-islami ev et-ta'limu fi re'ji 'l-kasi", disertacion doktorate (*i botuar*) i doktor Ahmed Fuad Eh-

vanit, "Mebadiu 't-terbijjeti 'l-islamijjeti", punim i botuar i magjistraturës i autores Esma Fehmi, dhe vepra "Menhexhu 't-terbijjeti 'l-islamijjeh" i autorit Muhamed Kutub?

Pa hyrë në hollësi, ndjeva se këto vepra, krahas faktit që ishin të padiskutueshme dhe tepër serioze, nuk i përmbushnin kërkesat. Atëherë, si të arrihej deri tek aspekte të reja dhe të përshtatshme?

Në vitet e pesëdhjeta, në Degën e Filozofisë në Fakultetin e Letërsisë, gjegjësisht në Universitetin e Kajros, patëm mësuar filozofinë islame, mistikën islame dhe apologjetikën. Në krejt këto nuk mungonin edhe vështrimet për edukimin islam, megjithatë ndjeja se këto nuk ishin të mjaftueshme.

Me këtë rast m'u kujtua kjo vepër e rëndësishme (*Temhidun li tarihi 'l-felsefeti 'l-islamijjeh*) e Mustafa Abdurrazikut, ish rektor i Ez'herit dhe profesor i filozofisë islame në Universitetin e Kajros, vepër të cilën e kemi studiuar në studimet pasdiplomike në Degën e Filozofisë. Ishte e njohur atëkohë për çdokënd që dëshironte të studionte mendimin e vërtetë islam, i cili shprehej përmes mendësisë muslimane, duhej të hulumtonte rreth kësaj çështje esencialisht në sferën e "usuli fikhut".

Fillova realisht të lexoj një sërë veprash të usuli fikhut dhe më lindi një ndjesi bindëse e ngritur mbi këtë bazë, nga ku shihet domosdoshmëria e ndjekjes së metodës së studiuesve të usulit në strukturimin e edukimit islam. Në këtë frymë realizova dy studime, e para me titull "Mesadiru 't-terbijjeti 'l-islamijjeh" dhe dyta "Mushkiletu 'l-menhexhi fi diraseti 't-terbijjeti 'l-islamijjeh", me pretekstin se tematika e këtyre dy temave është vendimtare për realizimin e kësaj detyre.

Pastaj, Allahu e kishte caktuar që në vitin 1975 të shkoja si profesor honorar (*i huazuar*) në Fakultetin e Edukimit në Universitetin "El-Melik Abdulaziz" (*i cili sot quhet "Ummu 'l-Kurra"*) në Mekën e Ndritur, ku për herë të parë hasa një

lëndë me emrin "Bazat e edukimit islam". Asnjëri nga kolegët nuk e pranonte ta ligjëronte atë, prandaj më mbeti mua ta pranoja këtë detyrë. Kështu, lidhja akademike dhe profesionale me sferën e bazave të edukimit islam sa vinte e bëhej më e fortë. Në këtë mënyra fillova të ligjëroja, të hulumtoja, të studioja dhe të shkruaja në këtë frymë.

Më pastaj mësova për projektin e Institutit Botëror të Mendimit Islam, se kishte përpiluar një libër universitar referencial në këtë sferë. Kështu tregova gatishmërinë time për t'u ballafaquar me këtë detyrë jo të lehtë dhe iu përkushtova punës për vite me radhë apo më shumë se tridhjetë vjet. U gëzova edhe më shumë kur pashë se dëshira ime u mirëprit nga vëllezërit e nderuar dhe nga doktorët: Abdulhamid Ebu Sulejman, kryetar i Institutit, Fet'hi Melkavi dhe Abdurrahman Nekibi.

Unë jam plotësisht i vetëdijshëm se krejt këto pjesë hyrëse, edhe pse mund të shihen si "përligjje të përcaktimit (*tim*)", ato në asnjë mënyrë nuk sigurojnë se libri ka sjellë imazhin e kërkuar (*të çështjes në fjalë*). Ajo që më shumë aspirojmë dhe ëndërrojmë, krahas përpjekjes sonë të zbehtë, na bën të ndjejmë se ajo që kemi realizuar është thjesht hedhje e një hapi në këtë rrugë, i cili mund të pranohet dhe të refuzohet. I pa të meta është vetëm Allahu i Përkryer, i Vetëm që nuk ka shok.

Meqë "konceptet në çdo sferë shkencore përfaqësojnë gjuhën e mirëkuptimit dhe të dialogut, atëherë ne permës mësimit të tyre duhet ta fillojmë tërësinë e studimeve tona në këtë libër, veçanërisht në këtë sferë, ku krahas mendimit të lashtë për këtë problematikë, ajo përfaqëson një mënyrë shkencore dhe metodologjike që ende është moderne, e turbullt në disa raste dhe kontraverse në disa mendime dhe prapavija.

Gjithashtu, menduam se hapi i radhës duhet të jetë trajtimi i sfondit ideologjik dhe dogmatik në të cilin mbështe-

temi në mbarështimin e këtij libri, pra, bëhet fjalë për sfondin ideologjik islam, siç përfaqet me theks të veçantë në Kur'anin fisnik. Krahas faktit se ky sfond përbën strukturën themelore të librit, ai po ashtu është i çiltër dhe transparent me lexuesin, ku ne e shpërfaqim identitetin tonë ideologjik qysh në fillim. Këtu mund të shtohet se kjo vepër u bën thirrje edhe të tjerëve që merren me probleme të edukimit islam që edhe ata të pajisen me këtë sfond ideologjik.

Nuk mendojmë se kemi nevojë të sjellim argumentet, dëshmitë dhe provat që e justifikojnë përkushtimin tonë të veçantë (*në kreun e parë*) ndaj Kur'anit fisnik dhe traditës së dëlirë pejgamberike, mirëpo ajo që duam të spikatim këtu është që qasja dhe përpjekja jonë ndaj këtyre dy fundamenteve themelore të edukimit islam të jetë një udhëzues për lexuesin dhe hulumtuesin, gjegjësisht me mënyrën e bashkëveprimit të këtyre dyjave në spektrin edukativ, apo thënë më saktë: si mund të nxjerrim nga ata dy (*nga Kur'ani dhe Suneti*) pikëpamje edukative që na ndihmojnë në formimin e identitetit musliman, i cili na afron me Zotin e botëve dhe na jep forcë shtytëse, e cila do ta shpjerë umetin drejt përparimit kulturor.

Përderisa kreun e tretë dhe të katërt e kemi veçuar për Kur'anin dhe Sunetin, dy krerët vijues, të pestin dhe të gjashtin, i kemi veçuar për të kaluarën e umetit islam, jo për t'u zhytur, për ta gjykuar dhe për ta demantuar atë, por për t'iu qasur asaj në formë kritike dhe përzgjedhëse për të apostrofuar nga ajo atë që ndihmon për ta kuptuar të tanishmen dhe për ta ndërtuar perspektivën. Kuptohet duke e trajtuar atë si të shenjtë, sepse në anën tjetër ekziston një vështrim tjetër i cili ia kthen shpinën asaj, e konsideron si të skaduar dhe të shkuar të cilën nuk kemi nevojë ta rishikojmë.

Të shkuarën e kemi trajtuar përmes dy sferave: sfera e parë ndërlidhet me gjithëpërfshirjen e lëvizjes kulturore

islame, pa u zhytur në hollësitë politike dhe ushtarake, dhe sfera e dytë ndërlidhet me trashëgiminë edukative të prodhuar nga mendjet islame.

Pastaj, kreu i fundit është si një vështrim ndaj një sërë problemesh dhe sfidash, me të cilat përballet populli në kohën tonë, në harmoni me umetin musliman, i cili pohon se edukata në përgjithësi i përthith apriori disa ballafaqime nga realiteti i njerëzve dhe kështu përgatitet për të nisur përpjekjen drejt horizonteve ku aspirojmë të lëvizë dhe të avancojë realiteti dhe e ardhmja jonë.

Këtë vepër e paraqes si një hyrje të denjë në rrugën e njohjes edukative islame, veçanërisht në këto rrethana që i jeton krejt bota dhe të cilat e kanë mbërthyer Islamin, muslimanët dhe mendimin islam me shumë mëdyshje të errëta. Këto faqe proklamojnë se Islami është një besim (*dogmë*) që e ndërton njeriun i cili i druhet Allahut, i do vëllait atë që i do vetvetes, mediton, përsiat dhe debaton me të tjerët në formën më të mirë, në mënyrë që përgjegjësinë e të qenit mëkëmbës ta realizojë përmes ndërtimit dhe ngritjes.

E lus Allahun t'i drejtojë hapat tonë në rrugën e vërtetë!

KREU I PARË

Struktura konceptore

Hyrje

Konceptet dhe termat në rrjetin shkencor janë si monedhat në marrëdhëniet mes njerëzve në jetën e përgjithshme. Prandaj, gjersa njerëzit në këtë apo atë shoqëri kanë ujdi për llojin e monedhës kombëtare dhe vlerën e saj me të cilën bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, ku përndryshe marrëdhëniet rrënohen, atëherë patjetër edhe në sferën shkencore "çdo vatan shkencor", nëse mund ta quajmë të tillë, apo çdo sistem shkencor të ketë një sërë konceptesh dhe termash, për të cilat kanë ujdi studiuesit e asaj sfere dhe të cilat e lehtësojnë hulumtimin, shkrimin dhe kuptimin e saj.

Diçka e tillë është realizuar shumë kohë më parë në shkencat natyrore, kurse në sferën e shkencave humane dhe sociale paksa është vonuar, kuptohet me diferencime në nivelin e përparimit dhe në tipizimin e tij (*të edukimit*) me theks të veçantë. Nëse përqendrohemi në sferën e edukimit, do të shohim se fatkeqësisht situata nuk është siç duhet në shumë aspekte:

Aspekti i parë është se ekzistojnë një numër jo i vogël që ende e shohin edukimin si art, kurse siç dihet arti është një sferë që ngrihet mbi përvetësimin e një tufe të shkathtësive shkencore që fitohen përmes ushtrimit dhe përvojës, gjegjësisht përmes imitimit dhe kopjimit. Pra, këta nuk e konsiderojnë atë shkencë që ngrihet mbi një fundament të fortë të teorive, parimeve, njohurive dhe bazamenteve, të cilat janë përftuar nga përpjekjet intelektuale dhe hulumtuese që zakonisht merrnin shumë kohë. Po ashtu, këto përpjekje kërkojnë trajnim në nxënie dhe në mësimdhënie për vite me radhë.

E vërtetë është se ky vështrim nuk është i njohur te studiuesit dhe te profesorët e edukimit, as te specialistët tjerë të teorisë dhe të praktikës. Mirëpo, problemi qëndron në atë se shumica dërmuese e atyre që vendosin, në shumicën e rasteve janë nga grupi që posedojnë pushtet rreth krejt asaj që ndërlidhet me edukimin, të cilët krijojnë legjislacione të sistemuara, firmosin ndëshkime, akordojnë buxhete, publikojnë kalendarë e tjera, megjithatë krejt këto ndikojnë negativisht në disiplinat edukative (*pedagogjike*) dhe në vatrat kryesore të saj, gjegjësisht në fakultetet e edukimit dhe në qendrat e hulumtimit edukativ (*pedagogjik*).

Aspekti i dytë është rezultat i të parit, ngase sa i përket termave, koncepteve, metodave dhe tematikave të hulumtimit, pedagogjia mbështetet në disiplina dhe në sfera të tjera shkencore. Ndoshta nuk ka asgjë të keqe këtu, sepse urat e bashkëpunimit, të citimit, të përfitimit dhe të bashkëveprimit mes rrjeteve shkencore çdoherë duhet të jetë të ngritura dhe të njohura, mirëpo këtu ka shkuar shumë larg doza e mbështetjes te tjetri. Duke e ditur se konceptet dhe termat nuk janë çdoherë të paanshme, por ato lidhen me një kontekst kulturor i cili në shumicën e rasteve është produkt i rrethanave, p.sh. termi "evoluim", i cili përdoret në pedagogji, është huazim nga disiplinat shkencore të biologjisë dhe i cili nënkupton kalimin nga një gjendje në një gjendje tjetër më të zhvilluar. Mirëpo, kur përdoret në pedagogji, konkretisht në pjesën e historisë (*së pedagogjisë*), nuk nënkupton domosdoshmërisht kalimin nga një gjendje në gjendjen tjetër më të zhvilluar. Evoluimi i edukimit në shoqërinë islame nga Epoka e Halifëve të Drejtë deri në Epokën Abasite të Parë, mund të nënkuptojë zhvillimin në horizontet e reja shkencore që i njeh edukimi islam, mirëpo mund të konsiderohet krejt e kundërta në një sërë vlerash etike dhe humane, të cilat janë shtyllë themelore në këtë lloj edukimi me theks të veçantë.

Aspekti i tretë është se një numër i koncepteve dhe termave të edukimit aktual janë përkthyer dhe bartur nga kulturat të tjera dhe shumë ndryshe nga kultura islame. Vërtet, bartja dhe huazimi janë të zakonshme në zhvillimin kulturor, mirëpo në rastin tonë bartja dhe huazimi ishin të pranishme në një nivel shumë të lartë dhe gëzonin shumë hapësirë, sepse po potencojmë edhe një herë se konceptet dhe termat janë pjellë e kontekstit kulturor që zhvillohet në atë mjedis. Pra, konceptet dhe termat fryhen me dozën e pikëpamjeve dhe të standardeve që i ngërthen ai kontekst kulturor.

Aspekti i katërt është se edhe ata që merren me pedagogjinë islame kanë dallime dhe ndasi në kuptimet e termave dhe të koncepteve që përdoren. Përpjekjet janë të pranishme dhe divergjencat janë të lejuara, mirëpo ka koncepte dhe terma që e formojnë (*strukturën esenciale*) të edukatës islame. Prova më e sheshtë me të cilën mund ta dëshmojmë këtë problematikë, është vetë koncepti i pedagogjisë islame dhe i bazave të edukimit islam, i cili është objekt i studimit tonë në këtë libër. Atëherë, ne nuk mendojmë se pjesa dërmuese do të pajtohen me kuptimet që do t'u japim ne këtyre koncepteve. Pavarësisht kësaj, fatkeqësisht ende sundon mendimi i gabuar, ku çdokush që shtron një ide të caktuar nuk lë të hapur mundësinë e të qenit mendimi i tij i gabuar, kurse mendimi i tjetrit i saktë. Kjo mendësi i pakëson shanset e bashkëveprimit mes ideve, koncepteve dhe përpjekjeve ndryshe.

Mirëpo, nëse i pyesim studiuesit e usuli fikhut se çfarë synojnë me këtë term (*me usuli fikhun*), do të shohim se janë pothuaj në ujdi për atë. Njësoj është nëse i pyesim edhe sociologët se çfarë nënkuptojnë, për shembull, me sociologjinë politike apo me sociologjinë ekonomike... Njësoj qëndron puna me një sërë disiplinash shkencore, ku edhe pse shihen aspekte të mospajtimit, kryesisht ato janë të natyrës dytësore apo tipizim anësor i idesë.

Kjo na detyron të ndalojmë pak më gjatë para këtij termi të cilin ne e kemi zgjedhur si objekt të studimit në këtë libër, për të analizuar komponentët përbërës të tij, për të shpalosur kuptimin, për të hulumtuar sinonimet e tij, për të gërmuar në brendinë e tij bashkë me tematikat dhe temat që trajton, dhe për të zbuluar realitetin e metodologjisë së hulumtimit në të. Ne, në asnjë mënyrë nuk pretendojmë se ajo që e kemi arritur është e vërteta që nuk duhet menduar ndryshe, por ajo është caku i asaj që Allahu na ndihmoi të mbërrijmë deri tek ajo në bazë të aftësive që na fali Vetë Ai, prandaj e ofrojmë si "një anë të vizionit (*bazë*)" apo si "një pikëpamje" që mund të hapet porta e diskutimit rreth saj, dhe në këtë mënyrë kjo sferë të pasurohet më shumë, të kaliten mendimet dhe të ngushtohet hendeku mes hulumtuesve të këtij lëmi.

E para: kuptimi "terbijeh" (edukim)

Në shikim të parë kjo tematikë duket si një aventurë në "gjërat e ditura", me të cilën nuk duhet humbur kohë dhe as energji, veçanërisht kur dihet se kuptimi themelor i punës shkencore është vardisja pas të panjohurës, zbulimi dhe hedhja dritë mbi të. Mirëpo, ne mendojmë se këtu ka ende çështje që duhet sqaruar, prandaj na duhet të shtojmë se hulumtimi shkencor nuk është vetëm vardisje ndaj "të panjohurës", por ndonjëherë mund të jetë rimendim apo ripërtëritje e të menduarit nga një kënd tjetër, për të cilin shumica kanë menduar se nuk ka hapësirë për mendim ndryshe. Pastaj do të përpiqemi në pjesën vijuese të këtij kreu të sqarojmë kuptimet gjuhësore të terbijes (*edukimit*) bashkë me termat e përafërt dhe ato sinonimikë. Gjithashtu do t'i sqarojmë përdorimet kur'anore të këtyre termave, kurse pastaj do ta trajtojmë kuptimin aktual të këtij termi në librat pedagogjikë bashkëkohorë për të parë nivelin e afërsisë apo

largësisë me kuptimet gjuhësore dhe përdorimet kur'anore, çdoherë duke marrë parasysh se këto dy çështje përbëjnë një hyrje të patjetërsueshme që të mund të sqarojmë se çfarë nënkuptohet me edukimin (*pedagogjinë*) islame.

Kuptimet gjuhësore dhe përdorimet kur'anore

Terbijeh (*edukim*): në fjalorin "Lisanu 'l-arabi" të Ibn Mendhurit thuhet se rrënja e fjalës terbijeh[1] (تربية) është rebehe (ربه) që do të thotë të posedosh, prandaj Allahu cilësohet si Rabbun, sepse është Zot dhe Posedues i çdo gjëje, pra Ai ka vetinë e posedimit ndaj çdo krijese. Fjala rabbun nuk përdoret për askënd, përpos si shoqërues me një fjalë tjetër në rasën gjinore, p.sh. mund të themi *zot (posedues) i shtëpisë* apo *zonjë (poseduese) e shtëpisë*, dhe atë mbi parimin se ai apo ajo janë zotërues të asaj gjëje. Këtë e shohim edhe në lutjen e ezanit "O Allah, Zoti (rabbu) i kësaj thirrjeje" apo poseduesi i saj.

Shprehja *rebebtu 'l-kavme* (ربيت القوم) do të thotë *tregoj epër-si kundrejt popullit*, prandaj arabët e përdornin shprehjen (لأن يربني فلان أحب إلي من أ يبرني فلان), e cila do të thotë *më mirë ta kem mbi kokë apo zotëri (rabbun) filanin se filanin*. Kur përdoret ndaj gjërave e mban kuptimin e ndreqjes apo riparimit. Ka kuptimin e mbrojtjes dhe kujdesit për diçka, siç është në hadithin (لك نعمة تهما) *"...një begati të cilën e ruan"*. Gjithashtu, përdoret edhe fraza (يربي الرجل ولده) *njeriu kujdeset për fëmijën e vet*, pra, ka kuptimin e kujdesit të denjë ndaj fëmijës derisa ai ta kalojë fëmijërinë, pavarësisht nëse është fëmija i vet ose jo.

Në fjalorin "El-Mu'xhemu 'l-vesit" thuhet: *rebbe 'l-velede* (رب الولد) e cila do të thotë: e mbikëqyr dhe kujdeset për fëmi-jën duke e ushqyer, rritur dhe edukuar.[2]

[1] Ibn Mendhuri, *Lisanu 'l-Arabi*, Kajro, Daru 'l-Mearifi, vëllimi III, f. 1546.
[2] Mexhmeu 'l-Lugati 'l-Arabijjeh, *El-Mu'xhemu 'l-vesitu*, Kajro, botimi III, vëllimi 1, f. 333.

Në fjalorin "Mu'xhemu 'l-elfadhi 'l-Kur'ani 'l-Kerim", për tri shkronjat rrënjësore të fjalës terbijeh (ربو) i gjejmë këto kuptime[3]:

Kuptimi i parë: shtim, fryrje apo rritje. Me këtë kuptim përdoret folja e së shkuarës *rebet* (رَبَتْ) në këtë ajet kur'anor (فَإِذَا أَنْزَلْنَا عَلَيْهَا الْمَاءَ اهْتَزَّتْ **وَرَبَتْ** وَأَنْبَتَتْ مِنْ كُلِّ زَوْجٍ بَهِيجٍ...) *"E kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet,* ***shtohet*** *dhe nga të gjitha llojet rritë bimë të këndshme."* (*El-Haxhxh: 5*). Në suren Er-Rrum përdoret folja e kohës së tashme *jerbu* (يَرْبُو), ku thuhet (وَمَا آتَيْتُمْ مِنْ رِبًا **لِيَرْبُوَ** فِي أَمْوَالِ النَّاسِ فَلَا يَرْبُو عِنْدَ اللهِ...) *"Dhe çka të jepni nga pasuria për ta* ***shtuar e rritur*** *(me kamatë), në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet tek Allahu"* (Er-Rrum: 39). E njëjta fjalë në trajtën e pjesores aktive paraqitet në suren Er-Rra'd: (...فَاحْتَمَلَ السَّيْلُ زَبَدًا رَابِيًا...) *"...kurse vala bart mbi vete shkumë* ***të fryrë*** *lart..."* (Er-Rra'd: 17). Në suren En-Nahl përdoret në trajtën *er'ba* (أَرْبَى), ku thuhet (...أَنْ تَكُونَ أُمَّةٌ هِيَ **أَرْبَى** مِنْ أُمَّةٍ...) *"për shkak se një popull është* ***më i madh*** *se tjetri."* (En-Nahl: 92)

Kuptimi i dytë: zhvillim apo evoluim. Allahu i Lartësuar në suren El-Bekare thotë: (يَمْحَقُ اللهُ الرِّبَا **وَيُرْبِي** الصَّدَقَاتِ...) *"Allahu e zhduk kamatën dhe* ***i zhvillon*** *lëmoshat"* (*El-Bekare: 276*).

Kuptimi i tretë: rritje apo edukim në gjirin e dikujt. Sipas këtij kuptimi rrënja e fjalës terbijeh (تَرْبِيَة) është *rebebe* (ربب), por B-ja e fundit është shndërruar në J për lehtësim.[4] Allahu i Madhërishëm thotë: (...وَقُلْ رَبِّ ارْحَمْهُمَا كَمَا **رَبَّيَانِي** صَغِيرًا) *"dhe thuaj: o Zot, mëshiroji ata siç më* ***edukuan*** *mua në vegjëli!"* (El-Isra, 24). Po ashtu, Zoti i Lartësuar thotë: (...قَالَ أَلَمْ **نُرَبِّكَ** فِينَا وَلِيدًا وَلَبِثْتَ فِينَا مِنْ عُمُرِكَ سِنِينَ) *"A nuk* ***të rritëm*** *ty si fëmijë në mesin tonë, ku i kalove disa vjet të jetës sate."* (*Esh-Shu'ara': 18*).

Në bazë të kësaj që u tha, në përdorimin kur'anor kjo fjalë paraqitet me kuptim të rritjes dhe edukimit vetëm në

[3] Mexhmeu 'l-Lugati 'l-Arabijjeh, *Mu'xhemu el'fadhi 'l-Kur'ani 'l-kerimi*, Kajro, vëllimi I, f. 352.
[4] Po aty, f. 4535.

dy raste, gjegjësisht në suren Esh-Shu'ara' dhe në suren El-Isra'. Ky përdorim më shumë mbulon periudhën e fëmijërisë, sepse në ajetin e parë përdoret fjala *sagiren* (vegjëli), kurse në ajetin e dytë fjala *veliden* (*fëmijë*). Pra, në këtë mënyrë fjala *terbijeh* paraqitet pothuaj me kuptimin e përkujdesjes fizike, ngrënies, pijes dhe gjërave të ngjashme, përfshirë këtu edhe aspektet shëndetësore. Ky është kuptim që përqendrohet në një fushë të ngushtë, nuk e arrin kuptimin e gjerë që synojmë përmes këtij termi në librat tanë të pedagogjisë moderne, veçanërisht kur vështrojmë atë që u tha në paragrafin paraprak për edukimin (*terbijen*), se ajo është një proces kujdestarie dhe mbikëqyrjeje derisa "të kalohet fëmijëria". Kjo përputhet edhe me përdorimin kur'anor.

Disa studiues muslimanë të hershëm u përpoqën ta interpretojnë fjalën *terbijeh* (*edukim*).[5] Kadi Bejdaviu në veprën "Envaru 't-tenzili ve esraru 't-te'vil" ka thënë: "Terbijeh (*edukim*) është aspirim për kah përkryerja dalëngadalë". Siç duket, sipas këtij përkufizimi fjala *terbijeh* (*edukim*) është më gjithëpërfshirëse, ngase nuk e përfshin vetëm njeriun, por njeriun, kafshët dhe bimët, madje çdo gjë. Ne e dimë se fjala *terbijeh* (*kultivim*) përdoret për dhentë, për devetë dhe për të gjitha llojet tjera të kafshëve. Gjithashtu, fjala *terbijeh* (*kultivim*) përdoret edhe për lulet, drunjtë, bletët etj.

Ibn Sinai[6] mendon se një kuptim i terbijes (*edukimit*) është *tradita*. Fjala *traditë* nënkupton përsëritjen e një veprimi shumë herë dhe për një kohë të gjatë. Edhe pse ky përkufizim në masë të madhe përmban një ngjyrim të terbijes (të edukimit) të karakterit njerëzor, përsëri ka një kuptim të ngushtë, nga i cili nxirret aspekti epistemologjik me gjithë thelbin që posedon procesi i arsimit. Një analizim më i the-

[5] Seid Ismail Ali, *Fikhu 't-terbijjeh,* Kajro, Daru 'l-fikri 'l-arabijji, 2001, f. 13.

[6] Abdurrahman En-Nekib, *El-Fikru 't-terbevijju inde Ibn Sina, mendhurun islamijjun muasirun*, Kajro, Daru 'l-Fikri 'l-Arabijj, 2002, f. 122.

lluar do të na çojë drejt përkufizimit të terbijes (*edukimit*) në frymën e aspektit bihejvijorist-tradicional. Në një vend tjetër, Ibn Sinai flet për terbijen (*edukimin*) mbi bazën e tendencës së unit drejt përsosmërisë për të cilën është krijuar. Edhe pse ky kuptim i fundit është më gjithëpërfshirës se parapraku dhe më afër kuptimit real, por përsëri në të shohim tendencën aristoteliane. Kjo nuk është për t'u çuditur, sepse Ibn Sinai është prej filozofëve muslimanë që u ndikuan shumë nga filozofi i njohur grek Aristoteli në disa mendime dhe ide. Krahas kësaj, këtë kuptim për terbijen (*edukimin*) e kemi hasur edhe te një studiues tjetër (*Bejdaviu*).

Te'dibun (تَأْدِيبٌ) është fjalë që përdoret në vend të terbijes (*edukimit*).

Në fjalorin "Lisanu 'l-arabi" fjala *el-edebu*[7] përdoret për veprimin e dikujt që kërkon të edukohet, quhet e tillë, sepse individi në fjalë i thërret njerëzit në vlera të larta, pra në punë të vyera dhe të lavdëruara, dhe i ndalon nga veprimet e shëmtuara dhe të urryera. Kuptimi thelbësor i fjalës *edeb* është *thirrje*, prandaj manifestit ku thirren njerëz i thuhet *mud'atun* (مدعاة) ose *me'debetun* (مَأدبة).

Gjithashtu, fjala edeb vjen me kuptim të edukimit të shpirtit dhe mësimit. Po ashtu, vjen edhe me kuptim të mirësjelljes. Këtë term Zuxhaxhi e përdorte edhe për Allahun, ku thoshte: "Kjo është ajo me të cilën Allahu e ka edukuar (*me edeb*) të dërguarin e vet a.s.", prandaj Muhamedi a.s. thoshte: "Më ka edukuar (me edeb) Allahu. Sa edukim i mirë që është!"

Në të njëjtën kohë, nga kuptimet e përftimeve të fjalës *edeb* është edhe gostitja (مَأدُبَة), gjegjësisht ushqimi që përgatitet për aheng, dasmë apo rast tjetër gëzimi. Në hadithin e transmetuar nga Ibn Mes'udi r.a. thuhet: "Ky Kur'an është me'dubetu (*gostitje*) nga Allahu në Tokë, prandaj mësoni

[7] *Lisanu 'l-Arabi*, vëllimi I, f. 43.

nga me'dubja e Tij." Në interpretimet e hadithit thuhet se në rastin konkret Kur'ani është dhënë si alegori e mirësive të Zotit ndaj njerëzve, prandaj i thërret në të.

Në fjalorin "El-Mu'xhemu 'l-vesit" fjala *edeb*[8] përdoret si thirrje e njerëzve për gosti. Po ashtu, përdoret për trajnimin e dikujt për sjellje të mira etike dhe tradicionale. Pra, fjalën *te'dib* e përdorim si sinonim të procesit të edukimit, veçanërisht aspektet etike. Gjithashtu, fjala *edeb* ngërthen zgjuarsinë për artet letrare, d.m.th. kur përdoret si folje (أَدَبَ), krahas kuptimit të pajisjes me virtyte të larta morale, ka edhe kuptimin e mësimit të arteve letrare. Pra, *el-edebu* do të thotë stërvitje (*aftësim*) për t'u arsimuar dhe edukuar sipas asaj që kërkohet. Në jetën e përditshme, njeriun që ka moral të mirë, veçanërisht fëmijën, e cilësojmë si mueddeb (*i edukuar*). Megjithatë, në këtë mënyrë përsëri dolëm në përdorimin e përgjithshëm dhe të përditshëm të kësaj fjale, gjegjësisht si sinonim i procesit të edukimit. Kështu duket sikur ne synojmë finalizimin e ndëshkimit. Kjo bëhet e qartë veçanërisht kur e dëgjojmë mësuesin duke e këshilluar prindin për ndonjë nxënës apo për të birin, ose e kundërta, ku i thotë "Duhet ta edukosh (*te'dib*) atë", duke synuar me të ndëshkimin, derisa ai të ndalojë së vepruari keq apo mbrapsht.

Edeb (*edukata*) quhet tërësia e vetive të duhura të cilat duhet t'i ketë çdo zanat apo art, si p.sh. edukata (*edebi*) e gjykatësit, e shkrimtarit etj. Edeb (*letërsi*) është krijimtaria e bukur poetike dhe prozaike. Po ashtu, fjala *edeb* përfshin gjithë prurjen intelektuale njerëzore të secilit lloj, prandaj shohim se si disa hulumtues, tërësinë e studimeve dhe hulumtimeve të kaluara të një sfere të caktuar e quajnë edeb, ku thonë "edebi i kësaj...", kurse disa të tjerë e paraqesin në trajtën e shumësit "edebijjati i ..." (أدبيات). Te'dibun do të thotë edukim, shpërblim dhe gjykim me të cilin syno-

[8] El-Mu'xhemu 'l-vasit, vëllimi I, f. 9.

het mbrojtja e interesit publik, kurse mueddib është ofiq që i jepet secilit që edukon dhe arsimon dikë. El-Edib quhet ai që kap virtytet etike dhe ai që tregon zgjuarsi letrare dhe artistike. Ndërsa fjala *adab*, e cila është shumësi i fjalës edeb, nënkupton traditën e pranuar nga të gjithë.

Asnjë trajtë e këtyre fjalëve nuk është dhënë në Kur'an.

Patjetër ta rishikojmë diskutimin për raportin mes këtyre tri sferave që gërshetohen në këtë fjalë (*gjegjësisht në fjalën edeb*). Tri sferat janë këto: edukimi, ushqimi dhe artet letrare. Gjithashtu, nga analiza gjuhësore paraprake që u realizua më herët nëpër fjalorë, bëhet e qartë se mes tyre ka dallime dhe barriera deri në shkallën e ndarjes. A është kjo e vërtetë?

Realisht fjala te'dib te klasikët arabë njihej pothuaj si sinonim i fjalës terbijeh (*edukim*) që njihet sot. Me fjalën edeb në atë ambient arab synohej fisnikëria, mikpritja dhe bujaria në ushqim. Arabët thoshin فلان أدب القوم "Filani i thirri dhe i gostiti njerëzit", siç theksuam më parë. Përderisa bujaria me ushqim në atë ambient shkretinor dhe të thatë i përmblidhte të gjitha vetitë e mira, ishte parullë e ngritjes morale, ishte krenari dhe burrëri, filluan që fjalën edeb ta përdorin për çdo virtyt të lartë moral, prandaj në këtë mënyrë fjala edeb filloi t'i përfshijë të gjitha virtytet e larta morale shoqërore dhe individuale në jetën e tyre.[9] Pastaj, ata e panë se transmetimi i poezisë është divan i krenarisë dhe se mësimi i historisë arabe është nder që stimulon ndjenjat e trimërisë dhe burrërisë, dhe ashtu i pajis me virtyte të larta etike, prandaj filluan ta përdorin fjalën *edeb* për poezinë dhe për të gjitha dijet sentimentale (*lirike*). Nga fjala *edeb* me këtë kuptim, u formua fjala *te'dib* apo *mueddib,* e cila është sinonim i termit *murebbi* (*edukator*) që përdoret sot.

Tehdhib (تَهْذِيبٌ) është po ashtu fjalë sinonimike e fjalës terbijeh.

[9] Seid Ismail Ali, *Evdau 'l-murebbine 'l-arabi*, Kajro, Daru Neshri 'th-Thekafeh, 1979, f. 9.

Fjala *tehdhib* në "Lisanu 'l-Arab"[10] do të thotë: kullim, dëlirje. Prej kësaj rrjedh fjala muhedhdhib, që do të thotë i pastër nga të metat dhe me moral të dëlirë. Esenca e tehdhibit është pastrim i kungullit nga lëvorja dhe heqja e farave derisa t'i hiqet hidhëtia dhe të jetë i gatshëm për t'u ngrënë. Gjithashtu përdoret edhe për hurmën derisa t'i hiqen fijet e fundit dhe të pastrohet mirë.

Në "El-Mu'xhemu 'l-vesit" fjala *hedh-dhebe* (هَذَّبَ)[11] përdoret me kuptim të kullimit të të shprehurit nga ajo që të turpëron para elokuentëve, prandaj thuhet (فُلانٌ هَذَّبَ الْكِتَابَ) "Filani e kulloi librin" d.m.th. e pastroi nga të gjitha shtesat e panevojshme. Për fëmijën përdoret me kuptim të edukimit dhe shmangien e tij nga çdo vepër e shëmtuar.

Me krejt këto kuptime shohim se fjala tehdhib përmban një dozë të lartë të terbijes (*edukimit*), me theks të veçantë dimensionet etike të edukimit. Përderisa edukata në vetvete përmban mbjelljen e vlerave etike në personalitetin e njeriut, i cili pastaj posedon parime të përzgjedhjes në sfera të ndryshme të sjelljes, atëherë një pune të tillë patjetër t'i paraprijë një proces negativ përmes së cilit shkulet dhe çrrënjoset krejt ajo që e zbeh çiltërsinë e personalitetit.

Fjala tehdhib nuk është dhënë në Kur'an në asnjë trajtë.

Tezkijeh (تَزْكِيَة)[12] është një fjalë tjetër që i afrohet kuptimit të fjalës terbijeh.

Në fjalorin "Lisanu 'l-Arab" fjala *zeka* (زكا) ka kuptimin e zhvillimit dhe rritjes. Në thënien që i përshkruhet imam Aliut r.a. thuhet: "Pasuria kur jepet harxhohet, kurse dituria kur jepet, *shtohet* (*jezku*)." Po ashtu, me këtë fjalë i quajmë frutat që i jep Allahu. Kur përdoret për tokën e ka kuptimin e pjellorisë dhe bollëkut etj.

[10] *Lisanu 'ul-Arab*, vëllimi VI, f. 4642.
[11] *El-Mu'xhemu 'l-Vesitu*, vëllimi II, f. 1018.
[12] *Lisanu 'l-Arab*, vëllimi III, f. 1849.

Fjala zeqat (زكاة) do të thotë edhe përmirësim, e cila kur përdoret për njeriun kuptohet si i dëlirë. Gjithashtu, përdoret edhe me kuptimin e lavdërimit. Ndërsa me zeqati i pasurisë është i njohur si pastrim i saj.

Në "Mu'xhemu 'l-Elfadhi 'l-Kur'ani 'l-Kerim" kjo fjalë përdoret si në vijim:[13]

(...وَلَوْلَا فَضْلُ اللهِ عَلَيْكُمْ وَرَحْمَتُهُ مَا زَكَا مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ أَبَدًا...) *"e sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, askush prej jush nuk **do të pastrohej** kurrë (prej mëkateve)"* (*En-Nur: 21*).

(قَالَ إِنَّمَا أَنَا رَسُولُ رَبِّكِ لِأَهَبَ لَكِ غُلَامًا زَكِيًّا) *"Tha: vërtet unë jam i dërguari i Zotit tënd për të të dhuruar një djalë **të pastër**."* (*Merjem: 19*)

Ky term lidhet edhe me arsimimin dhe me përkryerjen arsimore. Allahu i Madhërishëm thotë: (...يَتْلُو عَلَيْكُمْ آيَاتِنَا وَيُزَكِّيكُمْ...) *"Jua lexon juve dëshmitë tona dhe **ju pastron**"* (*El-Bekare: 151*). Pra, leximi është pjesë e dijes, por nuk duhet ndalur në këtë stad, por duhet pastruar dhe përmirësuar, prandaj Allahu thotë: (...وَيُعَلِّمُكُمُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ...) *"Jua mëson Librin dhe urtësinë"* (El-Bekare: 129), d.m.th. i pastron pastaj i bën funksionalë me urtësi. Njësoj jepet në ajetin 164 të sures Alu Imran dhe në ajetin e dytë të sures El-Xhumuah. Po ashtu, Allahu Fuqiplotë thotë: (وَمَا يُدْرِيكَ لَعَلَّهُ يَزَّكَّى) *"Ku e di ti?! Ndoshta ai do **të pastrohet**"* (*Abese, 3*), të pastrohet nga politeizmi dhe mëkatet. Njësoj Zoti i Gjithëfuqishëm thotë: (فَقُلْ هَلْ لَكَ إِلَى أَنْ تَزَكَّى) *"E thuaj: a do **të pastrohesh**?!"* (*En-Naziat, 18*).

Kur nxirret përqindja e caktuar nga pasuria e dikujt për t'u destinuar në format e përcaktuara sipas sheriatit, atëherë bëhet edhe pastrimi i pasurisë. Në këtë mënyrë kjo pasuri trajtohet e mirë, funksionale dhe e bekuar. Kjo sasi e pasurisë quhet zeqat (زكاة).[14] Allahu i Madhërishëm thotë: (خُذْ مِنْ أَمْوَالِهِمْ صَدَقَةً تُطَهِّرُهُمْ وَتُزَكِّيهِمْ بِهَا) *"Merr nga pasuritë e*

[13] *Mu'xhemu Elfadhi 'l-Kur'ani 'l-kerim*, vëllimi I, f. 518.
[14] Po aty, f. 519.

tyre zeqat, t'i pastrosh dhe ***t'i përmirësosh ata*** *me të!"* (*Et-Tevbe: 103*). Pra, sipas këtij ajeti pas pastrimit të pasurisë vjen përmirësimi dhe funksionaliteti i tyre si rezultat i kësaj pasurie.

Pastaj vjen në shprehje termi *ta'lim*, i cili është më i përhapur, bile shumica dërmuese e njerëzve e njohin si synonim të plotë të termit terbijeh.

Fjala ta'lim është folje me tri bashkëtingëllore rrënjësore, gjegjësisht ajn, lam dhe mim (علم) që do të thotë dituri apo dijeni. Ilmi (*dituria*) është veti e Allahut xh.sh., prandaj Allahu është El-Alim (العليم), El-Alim (العالم) dhe El-Al-lam (العلّام),[15] të cilat tregojnë përsosmërinë e diturisë së Zotit xh.sh. Allahu i Lartësuar thotë: (...وَهُوَ الْخَلَّاقُ الْعَلِيمُ) *"Dhe Ai është Krijuesi,* ***i Gjithëdijshmi****"* (Jasin: 81); (...عَالِمُ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ...) *"...****Njohësi*** *i të fshehtës dhe i të sheshtës..."* (*El-En'am: 73*); (...أَنْتَ عَلَّامُ الْغُيُوبِ...) *"...Ti je* ***i Gjithëdijshmi*** *i fshehtësive."* (*El-Maideh: 109*). Allahu është i Gjithëdijshëm për atë që ka ekzistuar, për gjithçka para ekzistimit dhe për atë se çfarë do të ndodhë pas ekzistimit. Ai vazhdimisht është i Gjithëdijshëm në eternitet, nuk i fshihet asgjë në tokë e as në qiell. I pa të meta dhe i lartësuar është Ai, i Cili me diturinë e tij përfshin në formë të përkryer çdo gjë të brendshme dhe të jashtme, të imët dhe të madhe.

Dituria është antonim i injorancës. Ibn Xheniju bën dallim mes termit *muteal-lim* dhe *alim*.[16] Muteal-lim (nxënës) quhet personi që është në proces të nxënies apo në fillim të rrugëtimit të diturisë, ndërsa pasi të ketë kaluar një rrugë të gjatë në fushën e diturisë dhe ta ketë ushtruar mirë atë, atëherë quhet *alim* (*i ditur*).

Gjithashtu, prej kësaj rrënje dalin disa kuptime: të njihesh me gjërat, t'i ndjesh disa gjëra, t'i përvetësosh mirë etj.

[15] Lisanu 'l-Arab, vëllimi IV, f. 3082.
[16] Po aty, f. 3082.

Folja علم (*alime*) është dy herë kalimtare, me dy kundrinorë, p.sh. علمت عبد الله عاقلا "E kam ditur Abdullahun të ditur" etj.

El-Ilmu (dituri) do të thotë perceptim i realitetit të diçkasë. Thuhet se ilmi (dituria) është perceptim i përgjithshëm dhe kompleks, kurse ma'rifeh është perceptim parcial dhe i thjeshtë, prandaj thuhet عرفت اللهَ "E njoha Allahun" jo علمت اللهَ "E mësova Allahun"..

Në Kur'an janë paraqitur trajta të ndryshme të fjalëve nga rrënja علم (*alime*),[17] por ne do t'i paraqesim vetëm disa shembuj, të cilët lidhen me fjalën تعليم ta'lim, sepse siç thamë kjo njihet te shumica si sinonim i terbijes.

(وَعَلَّمَ ءَادَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا) *"Dhe **ia mësoi** Ademit të gjitha emrat..."* (*El-Bekare: 31*); (عَلَّمَ الْقُرْءَانَ) *"**Ia mësoi** Kur'anin"* (*Er-Rrahman: 2*); (...وَإِذْ عَلَّمْتُ الْكِتَابَ...) *"Atëherë ta **mësova** ty librin."* (*El-Maide: 11*); (...وَمَا عَلَّمْتُمْ مِنَ الْجَوَارِحِ...) *"...dhe nga kafshët që i **keni mësuar** (dresuar)..."* (*El-Maide: 4*); (لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا...) *"Nuk kemi aspak dituri përpos asaj që **na mësove Ti**."* (*El-Bekare: 32*); (...وَعَلَّمْتَنِي مِنْ تَأْوِيلِ الْأَحَادِيثِ...) *"**Më mësove** interpretimin e fjalëve..."* (*Jusuf: 101*).

Së fundi, e paraqesim fjalën *hidajetun* (هِدَايَة)...

Çuditërisht këtë fjalë askush nuk e trajton si sinonim të fjalës terbije apo ta'lim. Megjithatë, aspekti gjuhësor dhe përdorimi kur'anor jep një dozë të madhe sinonimike të saj me fjalët e cituara më parë.

Dihet se një nga emrat e Allahut është El-Hadi (الهادي).[18] Ibn El-Ethiri për këtë emër të Allahut ka thënë: "Ai u fali robërve arsyen, ua mësoi rrugën për ta njohur Atë dhe për ta pranuar madhështinë e Tij. Ai e orientoi çdo krijesë drejt gjërave të domosdoshme për të qëndruar dhe për ta vazhduar ekzistencën."

[17] *Mu'xhemu elfadhi 'l-Kur'ani 'l-kerim*, vëllimi II, f. 60.
[18] *Lisanu 'l-Arab*, vëllimi VI, f. 4638.

Ibn Sejjidi konfirmon se el-huda (udhëzimi) është antonim i fjalës ed-dalalu (*devijim*). Hidajet është udhëzimi në rrugën e qëndresës dhe të së vërtetës. Pra, pikërisht kjo është ajo të cilën e kërkojmë dhe e cila na duhet në procesin e edukimit. Do të thotë, hidajeti në këtë rast nuk kufizohet vetëm në kuptimet etiko-morale, por përfshin edhe njohjen, madje jo çfarëdolloj njohje, por njohjen e drejtë, gjegjësisht të Vërtetën. Pejgamberi Muhamed a.s. në një rast i ka thënë Ali bin Ebi Talibit r.a.: "Kërkoja Allahut udhëzimin (hudanë)!",[19] ndërsa në një transmetim tjetër thuhet: "Thuaj: o Zot, më udhëzo dhe më drejto me saktësi!" Përkujto me fjalën huda udhëzimin dhe orientimin në rrugë, kurse me fjalën *sedad* saktësinë e shtizës. Kuptimi (*i hadithit*) është kështu: Kur t'i lutesh Allahut, kujtoja zemrës tënde rrugën e drejtë, dhe kërkoji Atij përqendrimin me saktësi njësoj siç sillesh në rrugë, sepse çdokush që lëviz në një rrugë, i përmbahet mirë asaj nga frikë që mos dalë nga rruga. Po ashtu, kur dikush gjuan me shigjetë, kujdeset ta gjuajë mirë shtizën drejt cakut, prandaj edhe ti binde zemrën tënde të lutet dhe të kërkojë saktësinë e gjuajtjes.

Nëse i kthehemi fjalorit "Mu'xhemu elfadhi 'l-Kur'ani 'l-kerim" do t'i gjejmë këto përdorime:[20]

Thuhet هداه الطريق d.m.th. e mësoi dhe ia hoqi hutinë në rrugën e trasuar.

Po ashtu, thuhet هداه الحق d.m.th. e drejtoi dhe e orientoi drejt një caku të mirë me butësi dhe me dëshirë. Ky është kuptimi alegorik i kuptimit paraprak. Pra, ky udhëzim (*hidajet*) është orientim në kuptime dhe në ndjenja, dhe pikërisht ky është udhëzimi që u përshkruhet pejgamberëve, librave qiellorë, vaizëve etj.

Gjithashtu, thuhet هدى له الأمر d.m.th. e sqaroi dhe e qartësoi një çështje.

[19] *Sahihu Muslim*, Kitabu 'dh-dhikri ve 'd-duai, hadithi nr. 4904.
[20] *Mu'xhemu elfadhi 'l-Kur'ani 'l-kerimi*, vëllimi II, f. 592

Në vijim do t'i paraqesim disa përdorime kur'anore të kësaj fjale (*el-huda*). Allahu i Madhërishëm thotë: (قَالَ رَبُّنَا الَّذِي أَعْطَى كُلَّ شَيْءٍ خَلْقَهُ ثُمَّ هَدَى) *"Tha: Zoti ynë është Ai i Cili u dha krijesave të veta çdo gjë pastaj i **drejtoi**."* (*Taha: 50*), d.m.th. ia mësoi gjërat dhe veprimet e dobishme dhe e inspiroi për punë të dobishme duke e inspiruar t'i mbërrijë ato; (رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا...) *"Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi i **drejtove** ato..."* (*Alu Imran: 8*), me hidajet (*udhëzim*) këtu kuptohet sinjalizimi për të mbërritur diku, siç thuhet këtë ajet (...فَاتَّبِعْنِي أَهْدِكَ صِرَاطًا سَوِيًّا) *"Më ndiq të **të drejtoj** në rrugë të drejtë!"* (*Merjem: 43*), po ashtu edhe në ajetin (وَقَالَ الَّذِي ءَامَنَ يَا قَوْمِ اتَّبِعُونِ أَهْدِكُمْ سَبِيلَ الرَّشَادِ) *"Tha ai i cili besoi: o populli im, më ndiqni t'ju **drejtoj** në rrugën e të drejtës!"* (*Gafir: 38*). Hidajeti (*udhëzimi*) çdoherë është i lidhur me rrugën e drejtë, prandaj Allahu xh.sh. thotë: (...وَيُتِمَّ نِعْمَتَهُ عَلَيْكَ وَيَهْدِيَكَ صِرَاطًا مُسْتَقِيمًا) *"...e plotëson begatinë e Vet ndaj teje duke të **drejtuar** në rrugë të drejtë."* (*El-Fet'hu: 2*). Për këtë arsye, në shumicën e ajeteve udhëzimi është i lidhur me Allahun, sepse Ai është Udhëzuesi më i mirë, si p.sh. (...قَالَ عَسَى رَبِّي أَنْ يَهْدِيَنِي سَوَاءَ السَّبِيلِ) *"...tha: siguristh Zoti im, do të më **drejtojë** në rrugë të drejtë."* (*El-Kasasu: 22*) dhe (قَالَ كَلَّا إِنَّ مَعِيَ رَبِّي سَيَهْدِينِ) *"Tha: Assesi, me mua është Zoti im. Ai do **të më drejtojë**."* (*Esh-Shu'ara': 62*).

Kuptimi pedagogjik (*edukativ*) i hidajetit shihet në lutjen të cilën e bën çdo musliman gjatë leximit të sures El-Fatiha, gjegjësisht në çdo reqat përgjatë pesë kohëve obliguese të namazit, ku thotë (اِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ) *"Udhëzona në rrugën e drejtë!"*. Për të qenë njeriu gjatë gjithë jetës në rrugë të drejtë, duhet të para vetes një personalitet të përsosur, i cili ka arritur pikën maksimale të kërkuar nga procesi edukativ. Hidajeti (*udhëzimi*) në krejt Kur'anin vetëm një herë është shoqëruar me rrugën jo të drejtë (...فَاهْدُوهُمْ إِلَى صِرَاطِ الْجَحِيمِ)

"Udhëzoji ata në rrugën e skëterrës!" (*Es-Saffat: 23*). Kjo është bërë vetëm për ironi dhe sarkazëm.

Në komentin e Muhamed Abduhusë për ajetin paraprak të sures El-Fatiha[21] thuhet: "Allahu i ka dhënë njeriut katër hidajete (*udhëzime*) apo katër "edukime" përmes së cilave e mbërrin lumturinë:

I pari: udhëzimi i ndërgjegjes së zakonshme dhe inspirimi i qenësishëm. Këtu futen ato që ne i quajmë "aftësi dhe përgatitje të qenësishme", të cilat janë të pranishme te fëmijët që në lindje. Fëmija pas lindjes ndjen nevojën e ushqyerjes, prandaj qan. Në këtë mënyrë e kërkon atë që i duhet përmes fitres (*nga natyrshmëria*). Sapo t'i afrohet gjiri te goja, inspirohet për ta kapur dhe për ta thithur atë.

I dyti: udhëzimi i shqisave dhe i ndjenjave. Këto e plotësojnë udhëzimin paraprak të jetës shtazarake (*që e jeton njeriu*). Deri këtu njeriu është njësoj me shtazët, bile shtaza i ka më të kompletuara këto, sepse shqisat dhe instinkti i kafshës zhvillohen menjëherë pas lindjes, kurse te njeriu gradualisht për një kohë. Njeriu pas lindjes nuk i dëgjon mirë zërat e as që i shikon qartë imazhet. Pastaj, pas një kohe shikon, por jo shumë larg, bile nuk e dallon largësinë e objekteve, objektin e largët e sheh si të afërt, prandaj e zgjat dorën ta kap atë, qoftë edhe hënën në qiell. Vazhdon të veprojë në këtë formë derisa të zhvillohen mirë shqisat.

I treti: udhëzimi i arsyes. Njeriu është krijuar të jetojë në shoqëri, por nuk i është dhënë instinkt (*apo inspirim*) i mjaftueshëm për jetën sociale siç i është dhënë bletës apo milingonës, të cilave Allahu u ka dhuruar instinktin e nevojshëm për të jetuar në shoqërinë e tyre, ku secila e kryen detyrën e vetë sociale dhe individuale në formë instinktive, prandaj shohim tipa të ndryshëm jetese te secili lloj

[21] Muhamed Abduhu: Durusun mine'l-Kur'ani'l-Kerimi, Kajro, Daru 'l-Hilali, Silsiletu kitabi 'l-hilali (96), mars 1959, f. 69.

i kafshëve, siç duken në realitet. Sa i përket njeriut, nuk është pjesë e natyrshmërisë së tij instinkti shtazarak, sepse Allahu e ka dalluar me një udhëzim shumë të avancuar se instinkti i shqisave, pra me arsyen, me të cilën i përmirëson gabimet e shqisave dhe të ndjenjave. Gjithashtu, përmes arsyes njeriu i kupton dhe i sqaron shkaqet, ngase konstatimi i shqisave pa arsye shpeshherë është i rrejshëm, si p.sh. shikimi nga larg i objektit të madh parimisht e sheh atë të vogël apo drurin e drejtë në ujë ta tregon të shtrembët etj., kurse arsyeja e kundërshton këtë perceptim të gabuar.

I katërti: udhëzimi i fesë.[22] Arsyeja nuk është e privuar nga gabimi gjatë perceptimit njësoj si shqisat tjera. Disa herë njeriu i përdor shqisat dhe arsyen për të fituar lumturinë personale apo grupore, prandaj i trason udhëzuesit e rrugës së gabuar dhe kështu i vendos ato (*shqisat dhe arsyen*) në shërbim të epshit dhe të unit të vet. Në këtë mënyrë ato e çojnë drejt shkatërrimit. Nëse ndjenjat bien në gremina dhe epshet e sundojnë arsyen, atëherë arsyeja fillon të prodhojë justifikime dhe hile të ndryshme. E si mund të jetojë njeriu kështu i lumtur?! Sigurisht që jo, sepse egoja nuk ka çati për ta kufizuar. Njeriu nuk jeton i vetëm në këtë botë, ndërsa egoja shpeshherë e nxit drejt gjërave që janë të njerëzve të tjerë, prandaj në këtë formë egoja nxit edhe në armiqësi me njëri-tjetrin, e shkatërron mirëqenien dhe ndoshta çon edhe në shkatërrim të anëtarëve të shoqërisë. Nga e gjithë kjo kuptohet nevoja e udhëzimit të fesë që njerëzit t'i nxjerrë nga humnerat e egos, veçanërisht t'u mësojë se shtylla kryesore e saj (*e fesë*) është besimi se ekziston një Zot i Vetëm i këtij kozmosi, i Cili do të na ringjallë të gjithëve Ditën e Gjykimit, për ta marrë në përgjegjësi keqbërësin dhe për ta shpërblyer të mirëbërësin.

[22] Po aty, f. 70.

Kurse fjala اهتدى *ihteda*[23] vjen me kuptim të njohjes dhe të qartësimit të rrugës. Kjo ka të bëjë me ndjenjat dhe me kuptimet. Kur thuhet për njeriun اهتدى الرجل d.m.th. se njeriu i është nënshtruar të vërtetës dhe e ka trasuar rrugën e saktë dhe të drejtë në fe, siç është shprehur Allahu xh.sh.: "Vërtet ju ka ardhur e vërteta nga Zoti juaj. Kush udhëzohet është udhëzuar për veten..." (*Junus: 108*). Pra, këtu shihet se dobia e udhëzimit i takon vetë robërve, sepse Allahu është Pasaniku Absolut dhe i Panevojshëm për asgjë.

Përderisa këto janë kuptimet gjuhësore dhe kur'anore, atëherë cili është kuptimi terminologjik?

Kuptimi terminologjik

Nuk kemi ndërmend të ndalemi para gjithë asaj gërmadhe të përkufizimeve që qarkullojnë nëpër librat pedagogjikë, sepse dallimet mes tyre janë të qartë dhe ato reflektojnë nivelin apo llojin kulturor që shfaqet në to. Gjithashtu, ato pasqyrojnë këndvështrimin e atij që shkruan dhe analizon, pavarësisht profesionalizmit. Prandaj, do të hidhemi drejt te kuptimet më të pranuara dhe më të njohura te specialistët e fushës në kohën bashkëkohore. Ky kuptim e bën pedagogjinë një proces i cili mëton ta përgatitë njeriun qysh në fëmijëri të jetojë në shoqërinë së cilës i përket, duke e bërë atë pjesëmarrës të kësaj shoqërie, qoftë përmes vendeve specifike përgatitore, siç janë shkollat, institutet apo institucionet e sistematike arsimore, apo përmes vetë përditshmërisë së jetës në shtëpi dhe në rrugë. Më mirë është që të mos ndalemi fare te kjo e fundit, sepse njeriu kur piqet, rritet dhe zë vendin e vet në shoqëri (*në jetë*), atëherë në shumicën e rasteve i rishikon dhe i kritikon vetë gjërat që i ndihmojnë: mund të heqë nga ajo që ekziston, mund të shtojë diçka të

[23] Mu'xhemu 'l-elfadhi 'l-Kur'ani 'l-kerim, vëllimi II, f. 592

re, mund të ndryshojë apo modifikojë etj. Në këtë formë procesi i edukimit zhvillohet, ndryshohet dhe reformohet. Përndryshe, shoqëria do të stagnojë në suazat e të zakonshmes, do të mbetet e prapambetur dhe do t'i shmangë elementet të cilët vazhdimisht rigjenerohen.

Sa i përket natyrës së procesit të edukimit, nga ajo që kaloi duket se është një proces që sjell ndryshim te fëmija: në fizikun, në aftësitë, në të menduarit, në sjelljet e tij të zakonshme, në orientimet e tij e tjera, gjegjësisht në aspekte të ndryshme të personalitetit të tij. Kështu, fëmija ndryshon krejtësisht nga gjendja e mëparshme, por me kusht që ky proces edukativ të realizohet me kompetencë të lartë individuale dhe shoqërore.[24]

Pra, është shumë me rëndësi të ruhet kjo (*moshë*) ndaj së cilës tregon kujdes çdo edukator, sepse në këtë moshë nuk është i mirëpritur çfarëdolloj ndryshimi. Ne e dimë se si veprojnë disa grupe, të cilët i edukojnë, i mësojnë dhe i ushtrojnë fëmijët e grabitur për vjedhje, grabitje dhe veprime të tjera të paligjshme. Ka të atillë që i mësojnë vajzat për prostitucion dhe për veprime tjera kriminale. Disa shokë të këqij i mësojnë shokët e tjerë për punë të mbrapshta, si p.sh. ua mësojnë pirjen e duhanit, pirjen e alkoolit, përdorimin e lëndëve narkotike etj. Krahas me këto mund t'i përmendim edhe vetitë që disa i përfitojnë në ambientet e varfra fetare, si p.sh. shprehjet, fjalët dhe zakonet jo të hijshme.[25]

Bazuar në këtë, është patjetër të kushtëzohet ndryshimi të cilin e shkakton edukimi në personalitet, pra të realizojë atë që përputhet me vlerat dhe standardet e grupit, dhe të aspirojë ambiciet dhe gjithçka të denjë rreth tij. Kështu shfaqet rëndësia e doktrinës fetare si një kriter dhe udhëzues i

[24] Sa'd Mursi Ahmed: *Terbijetu 'l-insani*, Kajro, Alemu 'l-Ma'rifeti, 1965, f. 87.

[25] John Dewey, *Ed-Dimukratijjetu ve 't-terbijjeh*, e përkthyer në gjuhën arabe nga Mina Akravi dhe Zekerija Mihail, Kajro, Lexhnetu 't-Te'lifi ve 't-Terxhemeti ve 'n-Neshri, 1954, f. 44.

rëndësishëm. Kjo ndodh sepse edhe në shoqërinë ku u kushtëzua ndryshimi, ndonjëherë grup i caktuar mund të shkojë në drejtim jo të mirë dhe të padobishëm, siç shohim në ato shoqëri që edukohen dhe rriten në atë frymën e atyre standardeve. Disa zhvillohen vetëm në mirësi, kurse disa të tjerë vetëm në të keq dhe degjenerim, p.sh. siç ka qenë në Spartë gjatë shekujve të antikitetit, në Gjermaninë naziste në epokën moderne apo siç shohim në kohën bashkëkohore Izraelin sionist. E mira e përgjithshme domosdoshmërisht është në përputhje me intencat e sheriatit, bile për të janë dakord të gjithë studiuesit dhe dijetarët e umetit, siç është e njohur madhështia e Qabesë në disiplinat fetare dhe në normat etike (*islame*). Pra, këtu nuk bëhet fjalë për shpallje të këtij apo atij udhëheqësi, të cilët shfaqen kohë pas kohe në shoqëri dhe kështu krijojnë drejtime, ide dhe qëndrime të ndryshme.

Përderisa edukimi është një proces ndryshimi pozitiv në personalitet nga ana e grupit dhe në përputhje me objektivat e sheriatit, kjo do të thotë se edukimi është një proces evoluues. Kjo formë e të kuptuarit të edukimit si proces evoluues është tezë e hedhur nga filozofi i njohur amerikan, John Dewey.[26] Çuditërisht, qëndrimi i filozofit përputhet me kuptimin gjuhësor që mban fjala terbije (*edukim*) në fjalorët arabë dhe të cilën e trajtuam më herët, ku potencuam se folja رَبَا *reba* do të thotë *zhvillim* dhe *shtim*.

Ka shumë diskutime për raportin e *terbijes* me *ta'limin*.

Nëse i përgjithësojmë të gjitha kuptimet rrjedhëse të terbijes (*edukimit*) dhe ta'limit (*arsimimit*), të gjitha orientimet dhe filozofitë e tyre, atëherë do të shohim se mendimi më i përhapur që bën dallimin mes terbijes dhe ta'limit është se terbija (*edukimi*) përfshin krejt atë që njeriu e përvetëson nga influenca e faktorëve të ndryshëm në jetën që e rrethon,

[26] Po aty, 45.

pavarësisht nëse ndikimet ndodhin me qëllim apo pa qëllim, janë njerëz apo sende tjera. Pra, terbija nuk fokusohet vetëm në atë që njeriu e mëson në institucionet e arsimit. Po ashtu, shihet se vendi ku njeriu e merr terbijen (*edukatën*) është krejt hapësira ku ai lëviz personalisht. Këtë terbije (*edukim*) mund ta fitojë çdokush që u ekspozohet këtyre faktorëve influencues. Kurse nga aspekti kohor edukimi fillon me lindjen, madje edhe më përpara, por kjo varet prej rrethanave të prindërve. Po ashtu, edukimi (*terbija*) mund të jetë i llojllojshëm, varësisht sipas përvojave të ndryshme që kalohen në jetë.

Ndërsa ta'limi (*arsimimi*) dallon në botëkuptimin e përgjithshëm, sepse ai (*arsimi*) përfaqëson pjesën e sistemuar të edukimit e cila realizohet në përputhje me rregullat shkencore të përcaktuara paraprakisht, prandaj programet studimore i quajmë me emra të veçantë, si p.sh. gjeografia, gjuha, matematika e tjera, kurse për t'i ligjëruar këto programe themelohen institute, shkolla apo universitete bashkë me punëtorët shkencorë, të cilët janë të specializuar për ta kryer këtë detyrë, dhe ata quhen mësues. Pavarësisht kësaj, ky shkollim është i përkohshëm dhe i kufizuar. Kalon në disa nivele dhe faza të cilat përfundojnë me kontrollim të diturisë për të konstatuar se nxënësit apo studentët e kanë përvetësuar dhe e kanë mësuar mirë lëndën apo programin studimor.

Megjithatë, realiteti që duhet vënë re është se në vrojtimin bashkëkohor arsimimi (*ta'limi*) e ka zgjeruar kuptimin e tij deri në atë nivel saqë pothuaj e ka bërë si sinonim të edukimit (*terbijes*). Koncepti bashkëkohor i arsimimit (*ta'limit*) është zgjeruar dhe ka përfshirë krejt atë që synohet me edukim (*terbije*) dhe arsimim (*ta'lim*). Vetë përkushtimi universal ndaj arsimimit për vite me radhë, i cili ndryshe quhet edhe *arsimim i vazhdueshëm*, synon që edhe arsimi të shndë-

rrohet në edukim për çdo faqe të jetës, t'i përfshijë të vegjlit, të rriturit dhe moshën e mesme, t'i prekë të gjitha anët edukative të mundshme duke marrë parasysh të gjitha aspektet fizike, mendore dhe shpirtërore. Po ashtu, duke marrë në konsideratë individin dhe shoqërinë, pavarësisht nëse edukimi për nevoja personale apo shoqërore, për përfitime materiale apo kuptimore, për dëfrim apo për përfitim etj. Pra, ky lloj arsimi e lidh diturinë me praktikën, librin me jetën, shkollën me shoqërinë dhe çdo eksperiencë të gjallë e bën objekt studimi dhe mësimi.

E dyta: orientimi islamik i edukimit

Përse islamik?

Përderisa umeti para vetes ka shumë qëndrime dhe shumë probleme, të tjerët vazhdojnë të hedhin hapa të mëdhenj përpara. Ndonjëherë (*umeti*) qëndron në vend, ndonjëherë hedh hapa aq të vegjël sa nuk i mjaftojnë për ta kapërcyer një gropë të vogël, madje ndonjëherë hedh hapa të tillë të cilët e shtynë prapa atë.... Kur e sheh umetin në këtë gjendje, atëherë dijetarët, reformatorët dhe liderët e tij duhet t'i bien çekanit për ta alarmuar realitetin e kësaj krize, për të gjurmuar mënyrën dhe rrugën e mundshme e cila do t'u ndihmojë për tejkalimin e këtyre krizave dhe sfidave me gjithë forcë dhe energji. Pastaj nuk ndalon këtu, por e ndihmon atë për të siguruar një pozitë të denjë mes popujve tjerë. Sa i përket umetit islam, ai nuk duhet të ndalet vetëm në faktin për të qenë umet i denjë, por ta realizojë cilësimin që ia jep Krijuesi umetit islam "umeti më i mirë i nxjerrë për njerëzit". Ky cilësim që Zoti ia jep umetit islam nuk është një gjendje e trashëguar dhe i gatshëm vetvetiu, por është rezultat i përpjekjes, i angazhimit, i vuajtjes, i punës së mundimshme, i zellit dhe i durimit.

Ndoshta duket paradoksale kërkesa që edukimi të merr drejtim islam në shtëpitë e arabëve dhe të vetë muslimanëve, por habia së shpejti do të kalojë kur do të kuptojmë se shumica e shteteve të Botës Islame në shekullin e fundit janë distancuar nga aplikimi i ligjit të Zotit për një apo për një shkak tjetër. Për këtë arsye umeti është dobësuar dhe është lodhur. Gjithashtu, edhe sistemin edukativ dhe arsimor e goditi e njëjta gjëmë e copëtimit dhe e lajthitjes. Në vazhdim do t'i numërojmë disa faktorë të kësaj tatëpjete:[27]

- Të gjitha vendet islamike për një kohë të gjatë lënguan nga prapambetja, gjegjësisht qëkur kultura islame ndaloi së vepruari nga roli i saj udhëheqës në prurjen kulturore, dhe atë pas luftës së mongolëve dhe veçanërisht pas luftës së kryqëzatave.

- Periudha para kolonializmit modern cilësohet si periudhë e stagnimit kulturor dhe qytetërimor në Botën Islame. Gjithë angazhimi kulturor ishte i fokusuar në sqarime, imitime dhe përsëritje.

- Në fund të shekullit XVIII viset islame filluan të bien nën sundimin dhe ndikimin e shteteve kolonialiste evropiane.

- U realizuan disa tentativa islame për t'u çliruar nga kolonializmi dhe për ta rikthyer umetin islam si një umet të vetëm e të çliruar, por fuqitë kolonialiste i vunë veshin mirë kësaj pune qysh në zanafillë dhe deri më tani duke punuar pareshtur për t'i sfiduar dhe për t'i bërë të dështojnë këto lëvizje me gjithë mjetet dhe mundësitë që kishin. Këto mjete të kolonialistëve ndryshojnë dhe ripërtërihen në varësi të kohës dhe rrethanave që krijohen në mjediset ku jetojnë muslimanët.

[27] Muhamed Seid Rida El-Buti: *Ezmetu 'l-ma'rifeti ve ilaxhuha*, në (Taha Xhabir El-Alvani dhe të tjerë: El-*Menhexhijjetu 'l-islamijjetu ve 'l-ulumu 's-sulukijjetu ve 't-terbevijjeh*, Hirend, Virxhinia, El-Ma'hedu 'l-Alemijju li 'l-Fikri 'l-Islamijji, 1990), vëllimi I, f. 60

- Lëvizjet për pavarësi në të gjitha viset islame u ngritën mbi bazat nacionale dhe provinciale të ngushta. Në çdo vend u paraqitën udhëheqës që besonin në faktin e ndarjes nga umeti islam. Kështu, u shfaqën edhe grupe politike me kontura gjeografike të cilat u zhvilluan në fillim të epokës së pavarësisë, ku secili prej tyre kërkonte të jetë shtet i pavarur me qenësi sociale dhe ekonomike të pavarur.[28]

Përhapja e injorancës, e legjendave dhe e analfabetizmit në mesin e muslimanëve i solli faktorët e cituar më parë. Pikërisht këto e shtynë muslimanin e rëndomtë drejt tërheqjes në vetvete dhe mbështetjes në besimin formal, në imitimin e verbër dhe në përkushtimin ndaj interpretimit të gabuar të atyre që propagandonin me këto legjenda. Në këtë mënyrë umeti u ndje i dobët dhe i pafuqishëm për t'u ballafaquar me sfidat dhe ndikimet e jashtme. Kur bota moderne e mundi në çdo anë, atëherë e dobësoi ushtarakisht, politikisht dhe ekonomikisht, madje e frikësoi dhe e gjunjëzoi. Pastaj nën ndikimin e kësaj goditjeje kërkoi zgjidhje mesatare për ta rikuperuar gjendjen, duke besuar se me shkop magjik do ta rikthejë shumë shpejt atë që e ka humbur dhe që i ka ikur nga dora. Kështu u mbështet masa më e madhe e popullit pa vetëdije dhe pa arsye, kurse një pjesë e zgjedhur e njerëzve që kishin sadopak vetëdije dhe ishin të arsyeshëm, u dalldisën verbërisht ndaj kulturës perëndimore, duke u mbështetur në mjetet dhe idetë e tyre, kuptohet pasi këtyre iu ofruan justifikimet, argumentet dhe dëshmitë e nevojshme dhe pasi këtë ua zbukuruan këshilltarët perëndimorë dhe këshilltarët vendas që mendonin dhe përpiqeshin t'i imitojnë perëndimorët. Kurse në rajonet që menaxhoheshin nga kolonialistët u imponua metoda perëndimore, ku udhëheqësit e promovonin dhe e inkurajonin atë me gjithë mundësitë që kishin.[29]

[28] Po aty, f. 61.

[29] El-Ma'hedu El-Alemijju li 'l-Fikri 'l-Islamijji: *Islamijjetu 'l-ma'rifeh*, Kajro, Metabiu 'l-Ehrami, 1986, f. 28.

Kështu u formua një sistem arsimor profan që promovonte vlerat dhe konceptet përmes metodave perëndimore. Në këtë mënyrë, së shpejti do të fillonte ta fundoste shoqërinë islame përmes gjeneratave të diplomuara te perëndimorët në shkallë të ndryshme shkencore, të cilët posedonin dituri në fushat e tyre të specializimit, por fatkeqësisht në përgjithësi ishin injorantë në punët e fesë dhe të trashëgimisë islame. Kështu, këta të diplomuar filluan të humbin besimin te dijetarët muslimanë të cilët ishin kujdestarë dhe mbrojtës të trashëgimisë islame. Këta të diplomuar filluan të importojnë shumë devijime dhe të abuzojnë me diturinë e trashëguar në formë të përgjithësuar dhe të detajuar, pa bërë dallim mes asaj që lejohet dhe nuk lejohet të preket nga Kur'ani, nga suneti dhe nga parimet aksiomatike të dijetarëve islamë. Kështu u thellua hendeku mes dijetarëve muslimanë që e kundërshtonin metodën shekullariste dhe afetare, dhe mes shekullaristëve afetarë që ndiqnin metodën perëndimore në të menduar dhe propagandonin për të. Kolonialistët i rregulluan punët në atë mënyrë që shekullaristët afetarë të jenë dora e zgjatur dhe të zotët e vendimmarrjes në shumë shtete të Botës Islame.[30]

Fatkeqësisht, rrethanat jo të mira e ndihmuan këtë. Kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës e përjetuan atë që njihet si "ngjarja e njëmbëdhjetë shtatorit" në vitin 2001, një fushatë mbarë botërore u ngrit me pretekstin e luftimit të terrorizmit. Mirëpo, fatkeqësisht shanset dhe mundësitë e fuqive kundër Islamit u rritën edhe më shumë pas kësaj ngjarjeje, u shënjestruan disa vende islamike, e pastaj u dyndën ekspeditat me qëllime dhe metoda të ndryshme kundër gjithçka që ishte islame, edhe pse dihet se Islami është fe që përshëndetje të vetën e ka "paqen", është fe që çdoherë nis nga parimi "i barazisë" se esenca e të gjitha krijesave është

[30] Po aty, f. 29.

"nga një shpirt i vetëm" dhe është fe e cila vrasjen e njeriut të pafajshëm e konsideron si vrasje të tërë njerëzimit.

Megjithatë, e vërteta që duhet thënë është se spikatja e krizës që e ka përjetuar dhe që vazhdon ta përjetojë umeti islam dhe parashtrimi i dilemave për shkaqet e kësaj krize, bashkë me përgjigjet e ndryshme, nuk është një problem i ri dhe bashkëkohor, por kjo ka ndodhur qëkur ka dalë në skenë ixhtihadi islam personal, i cili përfaqësohet nga një mori dijetarësh të shquar,[31] si p.sh. Imam Gazaliu (450-505 h. / 1058-1111 m.), Izz bin Abdusselam (577-660 h. / 1699-1772 m.), El-Karafi, Ahmed bin Idriz (684h. / 1285 m.), Velijjullah Ed-Dehleviu (1101-1176 h. / 1699-1762 m.), Esh-Shevkani, Muhamed bin Ali (1173-1250 h. / 1760-1834 m.). Po ashtu, edhe qysh në epokën e thirrjeve dhe lëvizjeve të kryesuara nga kolosët reformatorë, si p.sh. Muhamed bin Abdulvehabi (1115-1206 h. / 1703-1792 m.), Es-Senusi, Muhamed bin Ali (1202-1276 h. / 1787-1859 m.), El-Mehdiu, Muhamed Ahmed (1260-1302 h. / 1844-1885 m.), Xhemaludin Afganiu (1254-1314 h. / 1838-1897 m.) etj. Diskutimi dhe kundërshtitë për shkaqet e kësaj krize ende vazhdojnë të jenë të pranishme. Po ashtu, edhe diskutimi për mënyrën e tejkalimit dhe flakjen e kësaj krize vazhdon të jetë i pranishëm. Të gjithë janë të një mendje se shkak kryesor i krizës së umetit është ngecja dhe prapambetja.

Sado që shtohen përpjekjet për rizgjimin islam dhe për ixhtihadin islam, me kontribute të llojllojshme dhe shpeshherë kundërshtuese për krizën e mendimit islam, përsëri nuk besojmë se ka hapësirë për divergjencë për gjërat e domosdoshme dhe me rëndësi të veçantë, madje është detyrim që një pjesë e mendimtarëve të umetit në kohën bashkëkohore t'i përkushtohen formësimit të Islamit dhe ta paraqesin atë si alternativë kulturore përballë modelit perë-

[31] Muhammed Ammareh, *Mealimu 'l-menhexhi 'l-islamijji*, Kajro, Daru 'sh-shuruk, El-Ez'heru 'sh-Sherif, El-Ma'hedu 'l-Alemijju li 'l-Fikri 'l-Islamijji, 1991, f. 14.

ndimor i cili është i importuar, sundon pjesën më të madhe të skenës së mendimit dhe është influencues në realitetin dhe mendimin tonë.[32] Po ashtu, ky formësim i Islamit paraqitet si alternativë përballë mendësisë së prapambetjes së trashëguar, e cila i ka reduktuar potencialet e umetit, i ka ngujuar hapat dhe e ka humbur forcën e kreativitetit dhe të përcaktimit të asaj që është e rëndësishme dhe e domosdoshme në përcaktimin e udhëzuesve të kësaj alternative kulturore islame. Gjithashtu, kjo alternativë duhet të jetë si udhëzues praktik i çdo aktivisti që vepron në sfera të ndryshme të kornizës së renesancës islame. Në të njëjtën kohë, të japë kontribut në prurjen kulturore, në dialektikën që zhvillohet në formën më të mirë, të bazohet në logjikën kritike dhe të sjellë modele në fushën e sjelljes, të dialogut, të punës së përgjithshme dhe të asaj specifike.

Edhe pse mënyra dhe rruga e aspiruar realisht nuk është e panjohur, ngase është metoda islame, megjithatë, ka nevojë për vetëdijesim, mirëkuptim dhe perceptim të drejtë. Po ashtu, ka nevojë për aplikim dhe realizim. Përcaktimi ynë për metodën islame nuk është i paarsyeshëm dhe komik. As nuk është i ngritur vetëm mbi trashëgimi apo transmetim, por mbështetet edhe në hulumtim, studim dhe analizë. Gjithashtu, është i ndërtuar mbi dialog racional dhe argumentim të logjikshëm.

Njësoj si në shumë fusha tjera, kjo çoi në paraqitjen e lëvizjes për "islamizim të diturisë", duke i konsoliduar disiplina të ndryshme shkencore sipas fundamenteve ideologjike që ngrihet vetë doktrina islame, duke i pajisur me sistemin e vlerave etike për të cilat thërret kjo doktrinë dhe duke i orientuar kah objektivat e saj.[33] Prej kësaj periudhe,

[32] Po aty, f. 15.

[33] Muhibbuddin Ahmed Ebu Salih: Tesavvurun mukterehun havle menhexhi 'l-bahthi, në "*El-Menhexhijjetu 'l-islamijjetu ve 'l-ulumi 's-sulukijjeti ve 't-terbevijjeh*, referimi i mëparshëm), vëllimi III, f. 16.

në sferën e edukimit (*të pedagogjisë*) dolën në skenë termat "pedagogji islame" duke iu referuar termit "dituri islame", dhe termi "islamizim i pedagogjisë" duke iu referuar termit "islamizim i dijes". Po ashtu edhe termi "zanafilla islame e pedagogjisë", i përftuar nga termi "zanafilla islame e diturisë apo e shkencave".

Bazat e edukimit islam

Domethënia e përgjithshme e nocionit *bazat e edukimi*. Procesi edukativ i jep njeriut humanizmin aq sa ai investon nga mundësitë edukative që i ka falë Allahu. Këto mundësi mishërohen në potencialin e tij madhështor për të mësuar, për të përfituar shumë njohuri dhe informacione, për t'i kuptuar të vërtetat, orientimet, prirjet, vlerat, zakonet dhe shkathtësitë. Në këtë mënyrë procesi edukativ me rolin e vet akumulon përvojë, i zhvillon njohuritë shkencore, e avancon njerëzimin dhe e rrit nivelin e polemizimit kulturor mes shoqërive njerëzore në rrafshin intelektual dhe praktik.

Natyrisht se rezultati i këtij përkushtimi dhe i kësaj vlere të procesit të edukimit do ta nënshtronte vetë atë ndaj përsiatjeve pedagogjike, të cilat rezultojnë me njohuri të bollshme pedagogjike që i pasqyrojnë themelet mbi të cilat duhet ngritur edukata, mënyrën shembullore të arsimit, shkencat dhe prioritetet që njeriu duhet t'i mësojë gjatë fazës së zhvillimit, të nevojës shoqërore, të përfytyrimit të veçantë ndaj karakterit të nxënësit dhe shumë pikave të tjera ku kanë dhënë kontribut shumë mendimtarë të mëdhenj të skenës së mendimit njerëzor, si p.sh. Sokrati, Platoni dhe Aristoteli,[34] bashkë me një numër jo të vogël të mendimtarëve të Botës Islame.

[34] Jusuf Kerem: *Tarihu 'l-felsefeti 'l-junanijjeh*, Kajro, Lexhnetu 't-te'lifi ve 't-terxhemeti ve 'n-neshri, 1946, f. 100, 201.

Njohuritë e dhëna nga mendimtarët janë rezultat i meditimeve, të cilat e kanë bërë edukimin peng (*të përvojës*), pa i lënë mundësinë dijes pedagogjike që të ballafaqohet me praktikën pedagogjike, dhe duke e ndihmuar atë me rezultate shumë të rëndësishme.

Pastaj metoda shkencore, dija e konfirmuar dhe logjika e thukët racionale, ia arritën që dijen pedagogjike ta çojnë disa hapa përpara, e cila pastaj e fitoi cilësinë e të qenit disiplinë (*e veçantë*) shkencore. Kështu që pedagogët filluan të mendojnë se i janë afruar realizimit të ëndrrës që pedagogjia të bëhet disiplinë shkencore. Megjithatë, ata ende nuk arritën realizimin e kësaj ambicieje. Jo për shkak të paaftësisë, të prapambetjes apo të përkeqësimit të zhvillimit të dijes pedagogjike, por për shkak të shembullit apo modelit me të cilin ata i matën hapat e tyre drejt kësaj rruge të zhvillimit.[35]

Për një kohë të gjatë u bë përshtatja e shkencës me fizikën, veçanërisht me mekanikën. Metoda shkencore përputhej me metodat eksperimentale brenda kushteve të përshtatshme për punë. Kjo i krijoi hapësirë mendimit se shkenca përfaqëson një metodë të thukët dhe eksperimentale që çon drejt zbulimit të "ligjeve natyrore". Kur u zbuluan disiplinat tjera shkencore, si gjeologjia, botanika, biologjia, metrologjia, oqeanografia etj., pastaj më vonë ekonomia, psikologjia, mjekësia, sociologjia dhe shkencat politike, të cilat u përkufizuan veçmas në një disiplinë të zgjeruar shkencore, atëherë nuk ishte e mundur vështrimi i saj si diçka e thukët dhe as zbulimi i "ligjeve natyrore" në sfera të ndryshme. Biologu, meteorologu dhe ekonomisti do të ballafaqohen me një pozicion që mban qindra miliona faktorë të parregullt. Në këto rrethana studiuesi vetëm mund të provojë marrëdhëniet empirike dhe statistikore, apo disa disi-

[35] Abdussemi' Sejjid Ahmed: *Dirasatun fi ilmi 'l-ixhtimai 't-terbevijji*, Aleksandri, Daru 'l-Ma'rifeti 'l-Xhamijjeti, 1993, f. 130.

plina të tjera shkencore t'i klasifikojë mbi bazën e lidhshmërive apo t'i përshkruajë ato.

Kështu, pedagogjia e pati patjetër të influencohet nga marrëdhëniet me disiplinat tjera të përafërta dhe nga aspektet e ndryshme kulturore, ekonomike dhe politike. Në këtë mënyrë u bë sferë më e afërt me teknologjinë derisa u bë shkencë e pavarur me ligje të veçanta dhe kufij të ngushtë, njësoj si kimia dhe fizika. Pedagogjia është sferë ku aplikohen me mjeshtëri dhe me art rezultatet e disiplinave tjera shkencore, njësoj si në agronomi dhe në mjekësi.[36] Agronomia nuk trajtohet si shkencë e mëvetësishme, por u ndihmon disiplinave të ndryshme shkencore në shumë elemente përbërëse të saj, prandaj kështu ndërlidhet edhe me edukimin, me prodhimtarinë, me klimën, me tregun dhe me të tjera. Për këtë arsye, agronomia mbështetet edhe në disiplinat e insekteve, të ekonomisë dhe në të gjitha disiplinat tjera që lidhen me të. Njësoj është situata edhe me mjekësinë e cila objekt studimi ka trupin e njeriut. Ajo nuk është shkencë krejt e pavarur, por është e ngritur mbi rezultatet e shumë disiplinave të ndryshme shkencore, si p.sh. anatomia, patologjia, farmaceutika, botanika dhe biologjia. Rezultatet e këtyre disiplinave aplikohen në fushën e diagnostifikimit dhe të studimit të trupit të njeriut bashkë me sëmundjet që ballafaqohet, të cilat zbulohen dhe u përshkruhet ilaçi.

Nga kjo mund të kuptojmë se pedagogjia mbështetet në bazat e shumë disiplinave shkencore dhe të studimeve që e ndihmojnë atë t'i kuptojë aspektet e ndryshme të saj, si p.sh. në disiplinat fetare, psikologji, sociologji, histori, politikë, ekonomi, filozofi, biologji etj.

- Pedagogjia posedon edhe fundamente fetare, ku për muslimanët Kur'ani fisnik dhe suneti pejgamberik janë dy fundamente nga të cilat përfitohen komponentët themelorë

[36] Muhamed El-Hadi Afifi: *Fi usuli 't-terbijjeti, el-usulu 'th-thekafijjeh*, Kajro, El-Enxhlu 'l-Misrijjetu, 1973, f. 63.

(*juridikë apo doktrinarë*), mbi të cilat ngrihen sistemet dhe përfytyrimet e ndryshme të tyre. Për këtë arsye lindën edhe disiplina të tjera, si p.sh. historia e pedagogjisë islame, filozofia e pedagogjisë islame, fundamentet e pedagogjisë islame, pedagogjia islame krahasimtare.

- Fundamentet sociologjike dhe kulturore të pedagogjisë. Këto janë fundamente të cilat e bënë procesin pedagogjik që të mos sillet vetëm rreth individit, por edhe rreth shoqërisë, prandaj edhe u formua ajo që quhet pedagogjia sociale, antropologjia e pedagogjisë.[37]

- Fundamentet psikologjike, të cilat mbështeten mbi faktin se ai (*nxënësi*) është ena në të cilën procesi edukativ i derdh rezultatet e tij. Këto i japin vetëdijes së nxënësit potencial, përgatitje, prirje, veçori në sjellje, shëndet psikik dhe i mundësojnë marrëdhënie të shëndetshme me individët dhe grupet e ndryshme që trajton psikologjia. Kështu u formua psikologja pedagogjike e cila konsiderohet si trungu kryesor nga ku degëzohen disiplinat të tjera shkencore, si psikologjia arsimore, psikologjia zhvillimore, psikologjia shkollore etj.

- Fundamentet filozofike të pedagogjisë. Procesi edukativ është implementim dhe diagnostifikim i një kornize ideologjike të përgjithshme të trilluar nga ky apo ai mendimtar për këtë apo për atë shoqëri. Pastaj po ky mendimtar lë gjurmë dhe ndikim në procesin e punës edukative, p.sh. siç kemi parë te shoqëritë që ndoqën metodën marksiste në Bashkimin Sovjetik për më shumë se shtatëdhjetë vjet, apo siç ndodhi para saj në Gjermaninë naziste, në Italinë fashiste etj. Kështu u zhvillua një sistem epistemologjik i quajtur "filozofia e edukimit (*pedagogjisë*)".

Ndoshta nga e gjithë kjo mund të vijmë në përfundim se pedagogjia ka veçantinë dhe mëvetësinë e saj. Veçantia e saj është tematika, apo me fjalë të tjera, veçantia e intuitës edu-

[37] Po aty, f. 67.

kative e cila çon drejt objektit që meriton të studiohet, sepse nuk gjendet mënyrë hulumtimi që prodhon objekte (*studimore*), siç nuk bëjnë (*vetë*) fjalët poezi. Sa i përket pavarësimit të saj nga fushat tjera specializuese, gjegjësisht për ta shmangur ndjekjen e sistemeve epistemologjike dhe ndërhyrjen e tyre në njëra-tjetrën, kjo është një çështje që nuk duhet diskutuar fare. Ne e dimë se historiani i njohu britanik, Toynbee, ishte unik, sepse mishëroi historinë me disa teori të psikologjisë dhe të sociologjisë. Shumica e mendimeve të pedagogut të njohur amerikan, John Dewey, mbështeten në disiplinat psikologjike dhe në teoritë filozofike dhe logjike.[38]

Kjo disiplinë shkencore, gjegjësisht sfera e bazave të edukimit shpalos marrëdhëniet dhe lidhjet mes sistemeve të ndryshme shoqërore dhe shkencave që lidhen me to. Ndihmon disiplinat tjera pedagogjike që të vetëdijesohen mirëfilli për realitetin (*e umetit*) për të cilin dhe nën ombrellën e të cilit veprojnë. Studimet fundamentale përpiqen t'i përgjigjen pyetjes së rëndësishme dhe kryesore, me të cilën ballafaqohet pedagogu: përse edukojmë? Kurse në anën tjetër e gjejmë një shkencë tjetër si metodologjia, e cila i përgjigjet pyetjes: çfarë mësojmë?

Fundamentet e edukimit (*pedagogjisë*) islame në veçanti: përkufizimi ynë për fundamentet dhe sferën e edukimit islam mund të sqarojë një sërë përmasash logjike që janë të ngritura mbi një numër të konsiderueshëm të të vërtetave shkencore dhe sociale sipas pasqyrimit në vazhdim:

Vështro një nga imazhet e një lënde që e përdorim në jetën e përditshme, p.sh. drurin në gjendjen fillestare: çfarë ndryshimesh dhe formash gjen tek ai?

Ndryshimet janë të kufizuara, sepse ato janë dallime të një burimi dhe të një lloji, të cilat mund të jenë pllaka të gjata apo të shkurtra, të gjera dhe të ngushta e të tjera. Nëse e

[38] Abdussemi' Sejjid Ahmed: *Dirasatun fi ilmi 'l-ixhtima'i 't-terbevijji*, f. 177.

marrim një marangoz profesionist, do të shohim se drurin do ta transformojë në trajta të ndryshme dhe të pakufishme, ku secila trajtë ka veçantinë e vet që e dallon nga të tjerat, krahas llojllojshmërisë së sferave të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tij.

Diçka të ngjashme si kjo, si përmasa me dallimin, e shohim te njeriu...

Nëse e vështron fëmijën e porsalindur që ka bërë vetëm disa minuta, orë apo vetëm disa ditë në këtë botë, do të shohësh se bëhet fjalë për një krijesë e cila nga fëmijët e tjerë dallohet vetëm në disa karakteristika nacionale, si p.sh. forma dhe ngjyra e flokëve, lloji apo ngjyra e syve, ngjyra e lëkurës apo diçka e ngjashme.

Ne e quajmë këtë (*foshnjë*) njeri, edhe pse realisht cilësinë e të qenit njeri e merr pasi ta fitojë personalitetin, i cili ka veti të marra nga grupi njerëzor të cilit i takon. Ky grup njerëzor mund të jenë arabë, indianë, anglezë, francezë dhe të tjerë, të cilët mund t'i quajmë grup me un shoqëror të përbashkët. Gjithashtu, ky grup patjetër të posedojë veti unike, të cilat do ta bëjnë këtë apo atë individ të veçantë dhe të cilin mund ta quajmë un personal.[39]

Uni social fitohet përmes dijes, përmes ushtrimit të gjuhës, doktrinës, filozofisë, traditave dhe dokeve të grupit. Po ashtu, fitohet përmes metodave të njohura të të menduarit tek ata, përmes veshjes së teshave, ngrënies së ushqimit, reagimit ndaj problemeve dhe çështjeve që u përkasin atyre, dhe përmes pjesëmarrjes në ndërtimin e së tashmes dhe të ardhmen e tyre.[40]

Procesi i fitimit të unit personal le te ne atë që u ngjan gjurmëve të veçanta të gishtave. Për shembull, të gjithë ne

[39] Gaston Mialaret: *Med'halun ila 't-terbijjeh*, përkthim i Nesim Nasrit, Bejrut, Menshuratu Uvejdat, 1985, botimi V, f. 13.

[40] Abdullah Abdu 'd-Dajim: *Devru 't-terbijjeti ve 'th-thekafeti fi binai hadaretin insanijjetin xhedidetin*, Bejrut, Daru 't-Taliati, 1998, f. 79.

kemi gishta përafërsisht të ngjashëm në formën e jashtme dhe në funksion, mirëpo secili ka gjurmë të veçanta, të cilat i dallojnë gjurmët e gishtave të tij nga gjurmët e të tjerëve, prandaj merret si shenjë përfundimtare dhe dalluese e përcaktimit të personalitetit individual. Gjithashtu, sado të flasim me një gjuhë, të kemi tradita, doke dhe dogma të njëjta, përsëri secili gjurmën (*të veçantën*) personale që shfaqet në zërin dhe në vështrimin e tij, në mënyrën e të folurit dhe të ecurit, në metodën e të menduarit, në orientimin e tij ideologjik dhe në nivelin e kulturës...

Pavarësisht nëse bëhet fjalë për procesin e përfitimit të unit social apo të unit personal, krejt kjo njihet me emrin edukim...

Kështu, kur kemi parasysh përmasën bashkë me dallimin, shohim se procesi i edukimit, i rritjes dhe i zhvillimit të njeriut ka shumë nevojë për një model që i pasqyron se si njeriu duhet ta ndërtojë personalitetin individual dhe atë social, ashtu që t'i mundësojë edukatorit proces të mirë të edukimit, zhvillim të drejtë dhe formësim të ekuilibruar.

Ne preferojmë vazhdimisht që fjalët tona t'i krahasojmë me shprehjen "përmasa me dallimin", sepse njeriu nuk është element pasiv si druri apo si gjërat e tjera që vetëm të pranojë gjërat në formë pasive, por është qenie e gjallë me vullnet, me arsye dhe me ndjenja. Njeriu ka rol aktiv në çdo gjë që ndihmon formësimin dhe zhvillimin e tij në nivele të ndryshme, varësisht sa i jepet hapësirë mundësisë njerëzore.

Ndërtues (*edukator*) i personalitetit të njeriut nuk është vetëm mësuesi në shkollë apo profesori në universitet, por secili që lë aktivisht gjurmë me karakter të vazhdueshmërisë në formësimin e personalitetit. Vendin e parë këtu e zë babai dhe nëna, pastaj thirrësi, spikeri, personalitetet tjera që kanë nivele të ndryshme të ndikimit, qofshin ato që kanë marrëdhënie të ndërsjella dhe të vazhdueshme.

Duke e parë rëndësinë e modelit i cili është i patjetërsueshëm për ta ecur drejt procesin e edukimit dhe të zhvillimit, në kohë të ndryshme gjatë historisë shumë filozofë, mendimtarë dhe reformatorë i kushtuan vëmendje të veçantë filozofisë dhe teorisë që përcakton veprimtarinë, synimet, metodat dhe format e realizimit, siç shihet te filozofët e lashtë grekë, si Sokrati dhe Platoni, apo te filozofët e epokës moderne në Evropë, si Jean Jacques Rousseau, John Locke, Immanuel Kant, Friedrich Frobel, Johann Heinrich Pestalozzi, Georg Hegel, John Dewey dhe shumë të tjerë.

Nga gjitha modelet perëndimore të të menduarit konstatohet se gjurmimi i historisë ideologjike dhe sociale, cilido model qoftë ai, nuk ka arritur ndonjë sukses të madh në këtë çështje, sepse secili ka interpretime dhe mendime ndryshe nga të tjerët. Modelet ndryshojnë, sepse disa i takojnë një periudhe kohore, por janë të shtrira në shoqëri të ndryshme, kurse disa të tjera janë të shtrira në një shoqëri, por në periudha të ndryshme kohore. Pikërisht për arsyen e shumë faktorëve është e pamundur të supozohet se kjo apo ajo teori, ky apo ai model mund të pasqyrojnë realitetin e njeriut, gjegjësisht procesin edukativ të përshtatshëm dhe zhvillimin e nevojshëm.

Me këtë rast, nuk mund t'i ikim pa e paraqitur atë dilemë spontane: a nuk u krijua ky njeriu nga asgjë dhe a nuk është Rritësi dhe Zhvilluesi i tij më i Dituri dhe më i Denji për të ditur se çfarë i duhet atij? Pra, a nuk është modeli intelektual që paraqiti Ai më i saktë dhe më meritor që procesi i edukimit të orientohet nga Ai dhe Vetë Ai t'i përcaktojë trajektoret dhe rrugët e realizimit të këtij edukimi?

Kështu mbërrijmë te realiteti themelor:

Njeriu nuk mund të quhet njeri realisht pa e fituar unin social dhe atë personal, kurse procesi edukativ është rruga për të mbërritur atje...

Mesazhi hyjnor në formën përmbyllëse, d.m.th. Islami, është modeli që duhet trasuar dhe ndjekur.[41]

Lexuesi i Kur'anit Fisnik me shumë lehtësi mund të spikatë këmbëngulësinë që domosdo Islami të merret si model jete, dhe si burim i dijes. Allahu xh.sh. thotë: (وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ) *"Kush kërkon fe tjetër jashtë Islamit, nuk do t'i pranohet..."* (*Alu Imran: 85*). I Lartësuari xh.sh. thotë: (إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللهِ الْإِسْلَامُ) *"Vërtet fe tek Allahu është Islami"* (*Alu Imran: 19*). Islamizimi i diturisë është punë e pejgamberëve, e të dërguarve dhe e ndjekësve të tyre. Zoti Fuqiplotë thotë:

(إِذْ قَالَ لَهُۥ رَبُّهُۥٓ أَسْلِمْ ۖ قَالَ أَسْلَمْتُ لِرَبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ ١٣١ وَوَصَّىٰ بِهَآ إِبْرَٰهِـۧمُ بَنِيهِ وَيَعْقُوبُ يَٰبَنِيَّ إِنَّ ٱللَّهَ ٱصْطَفَىٰ لَكُمُ ٱلدِّينَ فَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُم مُّسْلِمُونَ ١٣٢ أَمْ كُنتُمْ شُهَدَآءَ إِذْ حَضَرَ يَعْقُوبَ ٱلْمَوْتُ إِذْ قَالَ لِبَنِيهِ مَا تَعْبُدُونَ مِنۢ بَعْدِى ۖ قَالُوا۟ نَعْبُدُ إِلَٰهَكَ وَإِلَٰهَ ءَابَآئِكَ إِبْرَٰهِـۧمَ وَإِسْمَٰعِيلَ وَإِسْحَٰقَ إِلَٰهًا وَٰحِدًا وَنَحْنُ لَهُۥ مُسْلِمُونَ ١٣٣ تِلْكَ أُمَّةٌ قَدْ خَلَتْ ۖ لَهَا مَا كَسَبَتْ وَلَكُم مَّا كَسَبْتُمْ ۖ وَلَا تُسْـَٔلُونَ عَمَّا كَانُوا۟ يَعْمَلُونَ ١٣٤)

"Kur Zoti i tij i tha: "Përulu! (bëhu musliman)" - ai u përgjigj: "Iu përula Zotit të gjithësisë!" Ibrahimi ua dha këtë porosi fëmijëve të tij; po ashtu edhe Jakubi: "O bijtë e mi! Pa dyshim, Allahu ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj mos vdisni ndryshe veçse duke qenë muslimanë të nënshtruar ndaj Atij!" A ishit ju të pranishëm kur Jakubit iu afrua vdekja dhe i pyeti të bijtë: "Çfarë do të adhuroni pas meje?" - Ata u përgjigjën: "Ne do të adhurojmë Zotin tënd, që është edhe Zoti i etërve të tu: Ibrahimit, Ismailit dhe Is'hakut, një Zot të vetëm. Ne Atij i nënshtrohemi!" Ata njerëz tashmë kanë kaluar. Ata do të kenë çfarë kanë merituar dhe ju do të keni atë që meritoni e nuk do të pyeteni për veprat e tyre." (*El-Bekare: 131-134*)

Insistim për t'i dhënë edukimit orientim islam nuk është radikalizëm fetar apo nxitje për përçarje fetare. Përkundrazi, është një lloj sinqeriteti dhe amaneti shkencor

[41] Seid Ismail Ali, *El-Usulu 's-sijasijjetu li 't-terbijjeh*, Kajro, Alemu 'l-Kutubi, 1997, f. 245.

sipas direktivave të shpalljes dhe arsyes së shëndoshë. Po ashtu, është thënie haptas e parimeve dhe aplikimi i tyre. Ka pasur edhe më shumë se kaq, ku me shumë këmbëngulje dhe vendosmëri një numër i madh i studiuesve natyralistë të ish Bashkimit Sovjetik "pohonin pareshtur se shkencë sovjetike nuk është pjesë e shkencave botërore, por është tip i veçantë me qenësi të pavarur, pra, dallohet krejtësisht nga të tjerat. Veti themelore e shkencës është se ajo ngrihet mbi bazën e një filozofie të qartë dhe të dallueshme, kurse konstatimet shkencore kanë nevojë për një themel. Themeli i shkencave tona natyraliste është filozofia materialiste. Tani shtrohet pyetja: a nuk kanë muslimanët më shumë përparësi se krejt të tjerët të përfaqësohen me identitetin e tyre islam?!

Nëse puna qëndron kështu, atëherë a nënkupton se edukimi (*pedagogjia*) islame kanë koncept të veçantë ndryshe nga të tjerët?

Është e vërtetë se ne, sipas asaj që do të flasim më gjerësisht më vonë, nuk pretendojmë se pedagogjia islame ndahet tërësisht apo ka koncept krejt të veçantë dhe ndryshe nga pedagogjia e përgjithshme. Vetë termi pedagogji islame ka dy fjalë: *terbijeh* (*pedagogji apo edukim*) dhe *islamijjeh* (*islame*). Në vija të përgjithshme ky koncept përputhet me konceptin e përgjithshëm. Pedagogjia islame ka edhe një dimension tjetër i cili e specifikon dhe e dallon atë nga edukimet tjera. Nuk është për t'u habitur që në sferën pedagogjike të dëgjohet edhe termi *pedagogji marksiste*,[42] *pedagogji ekzistencialiste*, *pedagogji pragmatiste* e tjera, pra varësisht sipas thelbit ideologjik, sektar, filozofik që ka objekt edukimi. Në vazhdim, nëse duam ta kufizojmë konceptin e pedagogjisë islame, mund të shtrojmë formulimin në vijim:

[42] Seid Ismail Ali: *Sukutu terbijjeh*, Kajro, Alemu 'l-Kutubi, 1995, hyrja.

"Pedagogjia islame është një sistem i kompletuar i njohurive rreth koncepteve, proceseve, metodave, vlerave dhe organizimeve që lidhen njëra me tjetrën, duke bashkëvepruar dhe duke qenë në koordinim. Ky sistem është ngritur mbi përfytyrimin islam për universin, për njeriun dhe për shoqërinë, i cili mëton të realizojë synimin e të qenit rob i Allahut përmes zhvillimit të aspekteve të ndryshme të personalitetit individual dhe shoqëror i cili përputhet me objektivat e përgjithshme të sheriatit për të siguruar më të mirën për njeriun në këtë dhe në botën tjetër."

Fraza "sistem i kompletuar" nënkupton një sistem të madh dhe gjithëpërfshirës, i cili përfshin një numër sistemesh dytësore që ndërlidhen me çdo komponent të veprimtarisë edukative. Po ashtu, përfshin mësuesin, nxënësin, metodat arsimore, përgatitjet, eksperimentet, menaxhimin edukativ, godinat edukative, stilet e programeve, metodat, librat studimorë, aktivitetet, investimet dhe shpenzimet etj.

Konceptet, për shembull: koncepti eksperiencë, sigurimi i shanseve, karakteri i nxënësit, njohuritë, liria, sistemi, drejtësia e tjera, ku duhet marrë në konsideratë se konceptet zakonisht janë të ngritura mbi bazën e një modeli epistemologjik, i cili ndryshon në varësi të shkollave, filozofive dhe doktrinave.

Proceset, për shembull: mësimdhënia, nxënia, arsimimi, angazhimi, luajtja, kuptimi, meditimi, përsëritja...

Metodat, për shembull: mjetet e arsimit, metodat e ndryshme të mësimdhënies, metodat e bashkëpunimit, marrëdhëniet njerëzore...

Vlerat, për shembull: vlerat e të mirës si amaneti dhe çiltërsia, vlerat e të vërtetës si saktësia dhe racionalizmi, vlerat e të bukurës...

Organizimet, për shembull: politikat e pranimit, provimet, menaxhimi, programet studimore...

Kurse frazën "të qenit rob i Allahut" e trajtojmë në kuptimin e gjerë, sepse ky parim nënkupton realizimin e konditave të Islamit dhe i mundëson njeriut të luajë rolin e vet në ndërtimin e jetës dhe në përdorimin e ligjeve të Allahut në kozmos. Po ashtu, ky parim kërkon që fjala e Allahut të jetë më e larta, kurse pëshpëritjet e mohuesve të jenë më të ulëtat.

Sa i përket përfytyrimit islam dhe objektivave të sheriatit, për këto do të flasim më gjerësisht në pjesët vijuese me lejen e Allahut.

Edhe pse nuk e kemi përdorur mbiemrin *islamike* për edukatën që të mos e ekzagjerojmë, megjithatë krejt përkufizimi është ndërtuar mbi bazën e logjikës dhe të provës (*islame dhe profane*). Pra, në kontekst të asaj që u tha, nënkuptohet se *fundamentet udhëzuese* nga të cilat e fitojmë edukimin janë pikërisht fundamentet islame.

Vrojtimi i disa librave të publikuar viteve të fundit me titullin "fundamentet e edukimit islam" tregon se për këtë koncept ka disa mospajtime. Disa me konceptin e fundamenteve nënkuptojnë "potencialet kulturorë influencues". Pastaj, si rezultat i kësaj, fundamentet e edukimit islam kuptohen si fundamente filozofike, sociale, ekonomike, psikike, menaxhuese...

Disa të tjerë konceptin e fundamenteve e konsiderojnë si një tufë komponentësh, parimesh dhe pikëpamjesh, të cilat fitohen nga Islami. Kështu ato paraqiten si hyjnore, të përsosura, të ekuilibruara dhe gjithëpërfshirëse... apo paraqiten si veçori apo norma themelore në varësi të përpjekjes së studiuesit.

Nehlaviu përmbledh konceptet si "burime" të fundamenteve, "themele", "parime", "pikënisje" dhe "program". Kjo vepër e tij mori shumë jehonë në këtë sferë.[43]

[43] Abdurrahman En-Nahlavi: *Usulu 't-terbijjeti 'l-islamijjeti ve esalibuha*, Damask, 1991 (burim i skenuar).

Një libër tjetër i përbërë nga disa krerë, i cili ishte i paraparë për vite me radhë në programin e shumë instituteve shkencore në Jemen, dhe atë në programin e përgatitjes së mësuesve dhe mësueseve, me titull "Min usuli 't-terbijjeti fi 'l-Islami". Kjo vepër i ngjante një enciklopedie të përgjithshme, e cila i ngërthente pothuaj të gjitha tematikat e pedagogjisë islame.[44]

Xhelaliu u veçua me veprën "Mine 'l-usuli 't-terbevijjeti fi 'l-Islami", ku trajtoi tematika të ndryshme në fushën e edukimit islam.[45]

Sidoqoftë, qëkur Zoti na ka mundësuar të merremi me edukatën (*pedagogjinë*) islame, gjegjësisht që në vitin 1972, e kemi trajtuar konceptin *fundamente* si *burime*. Burimet në këtë libër janë fokusuar në Kur'an dhe Sunet, kurse vështrimi islam që fitohet prej tyre për çështjet themelore ideologjike, mund t'i japë formë një fundamenti "shkollor" të pedagogjisë islame. Pastaj, kjo tërësi normative është e detyrueshme për edukatorin (*pedagogun*) musliman.

Sa u përket fundamenteve të tjera, si p.sh. përvojës kulturore dhe trashëgimisë edukative, ato i trajtojmë si orientues dhe udhëzues jo të domosdoshëm, sepse prej tyre mund të përfitohet ashtu si zakonisht përfitohet nga studimi me karakter historik, nga i cili merre kështillë, tregohet konsideratë dhe përfitohet nga eksperienca e së kaluarës. Megjithatë, puna ndryshon sa i përket fundamentit që ndërlidhet me "problemet e aktualitetit dhe të perspektivës së umetit", prandaj në ndërtimin edukativ merr në konsideratë gjërat e domosdoshme, veçanërisht kur vështrimi i këtij aspekti është i lidhur me vizionin islam, i cili ngrihet mbi tre fundamentet e para.

[44] Hamid Mahmud Ismail dhe Hamdi Ebu 'l-Fetuh Utifeh: *Min usuli 't-terbijjeti fi 'l-Islami*, Sana, El-Hej'etu 'l-Ammetu li 'l-Meahidi 'd-Dinijjeti, disa vëllime, 1986

[45] Abdulfettah Xhelal: *Min 'l-usuli 't-terbevijjeti fi 'l-Islami*, Egjipt, El-Merkezu 'd-Duvelijju li 't-Ta'limi 'l-Vedhifijji li 'l-Kibari.

E treta: edukimi islam

Detyrim fetar dhe domosdoshmëri shoqërore

Detyrimi fetar

Është e ditur dhe e njohur mirë se feja nuk është thjesht sistem i riteve dhe i dokeve. As vetëm disa tekste që duhet nxënë apo doktrina që duhen njohur, por në rend të parë është "sjellje" me të cilën ec besimtari dhe e cila i dirigjon veprimet e tij në këtë apo në atë drejtim. Nëse ajo që njeriu beson nuk përkthehet në veprime dhe procese që personifikohen në rrjedhën e aktualitetit, atëherë i humb shumë vlera e ekzistencës në jetë. Përafërsisht, kjo mund ta përligjë dobësimin dhe vyshkjen e umetit islam në kohën aktuale, dhe atë pavarësisht rritjes së dukshme të realizimit të adhurimeve dhe të përhapjes së librave islamikë. Kjo rritje e dukshme nuk shkon paralel me rritjen e veprimtarisë dhe të sjelljes (*së muslimanëve*).[46]

Ndoshta e dimë këtë parim islam të njohur të cilin e ka thënë Pejgamberi a.s. "Feja është sjellje", pra duket se thelbi i fesë dhe i sjelljes jepen si sinonime. Sjellja përfshin veprimin, angazhimin dhe procesin angazhues. Me fjalën sinonim këtu synohet barazia në vlerë dhe në peshë. Kur i thuhet dikujt fetar, nënkupton se ai ka sjellje të mirë, kurse sjellja e mirë ndjell mirësi dhe dobi për vepruesin e saj dhe për mbarë umetin në kornizat e objektivave të sheriatit. Nëse kjo ka ndonjë kuptim, atëherë kuptimi më i denjë është lidhshmëria e fortë mes edukimit dhe fesë. Edukimi sipas fesë konsiderohet detyrim dhe mekanizëm që e përkthen gjendjen tekstuale në sjellje konkrete.

[46] Seid Ismail Ali: *Dirasatun fi 't-terbijjeti 'l-islamijjeh*, Kajro, Alemu 'l-Kutubi, 1982, f. 4.

Në të kaluarën dijetarët kanë thënë: "Atë që e përmbush vetëm detyrimi është detyrim." Në bazë të kësaj edukata është detyrim, sepse është mekanizmi themelor për aplikimin e detyrimeve dhe obligimeve fetare. Gjithashtu, dihet se asnjë sistem nuk mund të korrë fitore apo të aplikohet pa përgatitur burra dhe pa edukuar gjenerata, të cilët do ta realizojnë dhe do ta mbajnë barrën e atij sistemi, por dhe të shprehin dëshirë për ta aplikuar atë haptazi dhe fshehtazi. Prandaj, suret e Kur'anit Fisnik janë të mbushura përplot me ajete të cilat e konfirmojnë domosdoshmërinë që muslimani të vrapojë pas kërkimit të diturisë përmes rrugës së arsimimit, për të cilën do të flasim më gjerësisht më vonë. Megjithatë, këtu do të sjellim vetëm disa shembuj, si p.sh. konfirmimi nga ana e Allahut të Lartësuar që edhe shehadeti (*dëshmia islame*) duhet të bëhet mbi bazën e dijes (*vetëdijes*). Allahu xh.sh. thotë:

(وَلا يَمْلِكُ الَّذِينَ يَدْعُونَ مِن دُونِهِ الشَّفَاعَةَ إِلاَّ مَن شَهِدَ بِالْحَقِّ وَهُمْ يَعْلَمُونَ)

"Ata që i adhuruan pos Tij, nuk mund të ndërmjetësojnë (të bëjnë shefaat), përveç kush dëshmoi të vërtetën, e ata e dinë." (*Ez-Zuhruf: 86*)

(وَيَقُولُ الَّذِينَ كَفَرُواْ لَسْتَ مُرْسَلاً قُلْ كَفَى بِاللَّهِ شَهِيدًا بَيْنِي وَبَيْنَكُمْ وَمَنْ عِندَهُ عِلْمُ الْكِتَابِ)

"E ata që mohuan thonë: "Ti nuk je i dërguar!" Thuaj: "Mjafton që Allahu është dëshmitar midis meje dhe midis jush dhe (është dëshmitar) ai që ka njohuri të librit (të shpalljeve)". (*Er-Rra'du: 43*)

(وَلاَ تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُوْلَئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْؤُولاً)

"*Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.*" (*El-Isra: 36*) Tregohet se vëllezërit e Jusufit a.s. e cilësuan dëshminë (*shehadetin*) e tyre si të bazuar në dituri, prandaj më i moshuari tha:

(ارْجِعُواْ إِلَى أَبِيكُمْ فَقُولُواْ يَا أَبَانَا إِنَّ ابْنَكَ سَرَقَ وَمَا شَهِدْنَا إِلاَّ بِمَا عَلِمْنَا وَمَا كُنَّا لِلْغَيْبِ حَافِظِينَ)

"*Kthehuni te babai juaj dhe thoni: "O ati yni, djali yt vodhi, ne dëshmojmë vetëm për atë që dimë, e për të fshehtën ne nuk ishim roje!*" (*Jusuf: 81*)

Marrë parasysh faktin se arsimi është pjesë e pandarë e edukimit dhe se adhurimet nuk janë të vlefshme pa i njohur dispozitat dhe kushtet e tyre, atëherë apriori kuptojmë se edhe adhurimet kushtëzohen nga njohja dhe nga mësimi. Shikuar nga ky aspekt, "kërkimi i diturisë është detyrim për çdo musliman", siç është dhënë në hadithin e të Dërguarit. Të njëjtën e gjejmë edhe në Kur'anin Fisnik, ku Allahu xh.sh. nxit për kërkim të diturisë dhe për arsimim:

(وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنفِرُواْ كَافَّةً فَلَوْلاَ نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُواْ فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُواْ قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُواْ إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ)

"*Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t'u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ata, në mënyrë që ata të kuptojnë (e të ruhen).*" (*Et-Tevbe: 122*)

Këtu jepet sinjal për procesin e "arsimimit", ku një grup besimtarët detyrohen të lexojnë, t'i përvetësojnë gjërat, t'i diskutojnë, t'i kuptojnë, të nxënë aspekte të ndryshme të fesë e tjera, mirëpo këtë nuk guxojnë ta bëjnë vetëm për t'i rehatuar mendjet dhe zemrat e tyre, por duhet të kalojnë në hapin tjetër plotësues, pra të hedhin hapin për t'i arsimuar të tjerët që, kur të kthehen, t'ia tërheqin vëmendjen dhe ta mësojnë popullin e tyre për njohuritë fetare. Nga gjërat që duhet ditur muslimani, është të dijë të shmangë gjërat e ndaluara dhe të mos u afrohet atyre, dhe t'i kryejë detyrimet dhe obligimet e domosdoshme me të cilat mund ta fitojë kënaqësinë e Allahut të Lartësuar.[47]

Në vazhdim do të theksojmë një ajet tjetër, i cili i spikat kuptimet e thëna ma lartë, ku Allahu i Madhërishëm thotë:

(وَإِذْ أَخَذَ اللَّهُ مِيثَاقَ الَّذِينَ أُوتُواْ الْكِتَابَ لَتُبَيِّنُنَّهُ لِلنَّاسِ وَلاَ تَكْتُمُونَهُ فَنَبَذُوهُ وَرَاء ظُهُورِهِمْ وَاشْتَرَوْا بِهِ ثَمَنًا قَلِيلاً فَبِئْسَ مَا يَشْتَرُونَ)

[47] Sejjid Kutub: *Fi dhilali 'l-Kur'an*, Bejrut, Daru 'sh-Shuruk, 1982, botimi XI, vëllimi III, f. 1734.

"Dhe kur Allahu mori zotimin nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithqysh t'ua publikoni atë njerëzve, e të mos e fshihni, por ata e lanë pas dore atë për pak send të kësaj jete; pra, bënë punë të keqe." (*Alu Imran: 187*). Pra, Allahu i Lartësuar i mallkoi ata që e fshehin atë që e dinë dhe nuk e publikojnë në mesin e njerëzve, prandaj Allahu xh.sh. thotë:

(إِنَّ الَّذِينَ يَكْتُمُونَ مَا أَنزَلْنَا مِنَ الْبَيِّنَاتِ وَالْهُدَى مِن بَعْدِ مَا بَيَّنَّاهُ لِلنَّاسِ فِي الْكِتَابِ أُوْلَئِكَ يَلْعَنُهُمُ اللَّهُ وَيَلْعَنُهُمُ اللاَّعِنُونَ)

"Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruam njerëzve në librin, të tillët i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë." (*El-Bekare: 159*)

Kështu që, edukimi ka rol aktiv në zhvillimin dhe rënien e jetës së umetit. Islami thotë që kërkimi i diturisë të bëhet paralel me praktikën. Sipas vështrimit islam, edukimi nuk është thjesht fjalë që mësohet apo teori që lihet mënjanë dhe nuk praktikohet në jetën reale. Përkundrazi, Islami është ushtrim praktik në të cilin mishërohen vlerat etike dhe urtia. Te edukatori mishërohen shëmbëlltyra më e denjë, kurse te nxënësi dëgjueshmëria e vëmendshme. Për këtë arsye Allahu i Lartësuar e kundërshton urdhrin për bamirësi pa e vënë në praktikë atë:

(أَتَأْمُرُونَ النَّاسَ بِالْبِرِّ وَتَنسَوْنَ أَنفُسَكُمْ وَأَنتُمْ تَتْلُونَ الْكِتَابَ أَفَلاَ تَعْقِلُونَ)

"A i urdhëroni njerëzit për bamirësi kurse veten e harroni, dhe ju e lexoni Librin?! A nuk logjikoni?" (*El-Bekare: 44*).

Pastaj tregohet se Allahu i përjashton nga humbja ata që fjalën e shoqërojnë me sjellje (*të mirë*):

(وَالْعَصْرِ ۞ إِنَّ الإِنسَانَ لَفِي خُسْرٍ ۞ إِلاَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ)

"Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm." (*El-Asr: 1-3*)

Nga ana tjetër, Islami i ka urdhëruar prindërit të kujdesen që fëmijët e tyre të mos bëhen keqbërës, të mos rrëshqasin dhe të mos lajthisin, sepse kjo të çon në zjarr. Allahu xh.sh. ka thënë:

(يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ عَلَيْهَا مَلائِكَةٌ غِلاظٌ شِدَادٌ لا يَعْصُونَ اللَّهَ مَا أَمَرَهُمْ وَيَفْعَلُونَ مَا يُؤْمَرُونَ)

"O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar." (*Et-Tahrim: 6*). Pra, kjo ruajtje bëhet përmes edukimit, arsimimit, urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja.[48] Mbi bazën e kësaj shohim se Pejgamberi a.s. ka urdhëruar që fillimisht t'u mësohen fëmijëve urdhrat e fesë: "Mësojuni fëmijëve namazin në moshën shtatë vjeçare dhe edukoni (*rrihni*) në dhjetë vjet!".[49] Gjithashtu, Islami i ka bërë prindërit përgjegjës për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve, prandaj Pejgamberi a.s. ka thënë: "Secili prej jush është bari dhe secili është përgjegjës për kopenë e vet. Udhëheqësi është kujdestar dhe përgjegjës për popullin, burri është kujdestar dhe përgjegjës për shtëpinë, robi është kujdestar dhe përgjegjës për pasurinë e zotërisë, dhe gruaja është kujdestare dhe përgjegjëse për shtëpinë e bashkëshortit të saj."[50]

Nëse kjo është vëmendja që Islami i kushton edukimit, atëherë punë edhe më e përkryer është të sqarohet rëndësia e iniciativës fetare në fushën e zhvillimit të bijve të umetit. Në lidhje me atë që u fol më parë, duhet ditur se vetë historia njerëzore dëshmon për nevojën e fesë, madje ajo llogaritet si nevoja e parë psikike dhe mendore për njeriun. Nuk ka ndodhur që njeriu të jetojë komod pa e ndjekur së paku

[48] Seid Ismail Ali: *Fihhu 't-terbijjeh*, f. 92.
[49] Sunenu Ebi Davud, *Kitabu 's-salati*, hadithi: 417.
[50] Sahihu 'l-Buhari, *Kitabu 'l-Xhumuati*, hadithi: 844.

një fe të caktuar dhe pa u kushtuar vëmendje mësimeve dhe vlerave të saj. Shumë popuj arabë janë njohur qysh në lashtësi me orientimin shpirtëror dhe etik në edukimin e fëmijëve. Këtë nuk e pohon askush, sepse viset arabe kanë qenë djep i feve qiellore dhe toka ku Allahu i Madhërishëm zgjodhi t'i dërgojë një numër të konsiderueshëm të pejgamberëve.

Sot në kohën bashkëkohore shohim se edhe ne kemi nevojë shumë të madhe për një iniciativë (*institucionale*) edukative fetare, bile jo më pak se popujt e kaluar. Vërtet niveli i shkollimit dhe i përparimit tani është i pakrahasueshëm me atë të popujve të kaluar, megjithatë, nga prizmi etik, me theks të veçantë, shihet një kthesë famëkeqe ku kanë dominuar vlerat materialiste dhe janë tronditur vlerat esenciale të domosdoshme që sigurojnë mirëqenien e bijve të umetit. Fatkeqësisht, janë përhapur imazhe të arrogancës, lajthitjes dhe devijimit. Kush mund ta mbrojë umetin nga ky tufan amoral dhe kush mund ta mbajë ekuilibrin e tij, përveç edukimit që është ngritur mbi bazën e doktrinës (*besimit*) islame? Cila është rruga e drejtë në të cilën duhet lëvizur edukimi islam i kësaj sfere?

Rruga më e denjë për ta arritur këtë është që atyre t'u mësohet Kur'ani Fisnik dhe Tradita Pejgamberike e Muhamedit a.s., dhe pastaj këto të dyja të ndërlidhen me jetën praktike. Gjithashtu, nxënësi duhet të ballafaqohet me raste të ndryshme fetare dhe morale; të ketë guxim, dëlirësi, amanet, nxitje etj., pra, nxënësi duhet të ballafaqohet me situata të ndryshme që këto veti të nguliten tek ai nën mbikëqyrjen e edukatorit. P.sh. lëmosha duhet vënë në praktikë sa të ketë mundësi, por kjo të ushtrohet si pasojë e besimit dhe jo si një veprim mekanik apo formal, të cilin e ka mësuar nga mësuesi ku thjesht harxhon disa të holla. Njësoj është edhe me namazin. Namazi duhet ushtruar praktikisht në shkollë, duke e organizuar në atë mënyrë që

programet mësimore të mos bien ndesh me kohët e namazeve etj.

Po ashtu, obligim është që doktrina fetare (*besimi*) të jetë faktor që i shtyn anëtarët e një populli të lidhen dhe të kujdesen për njëri-tjetrin, madje edhe nëse në atë shoqëri ka pjesëtarë të feve të ndryshme qiellore, si p.sh. në Liban, në Egjipt dhe në vende të tjera arabe. Kjo i detyron nxënësit që gjatë edukimit fetar islam ta përvetësojnë kujdesin që Islami tregon ndaj debatit (*më të mirë*) konstruktiv, ndaj tolerancës dhe ndaj kujdesit për të drejtat e njerëzve, duke e ndihmuar këtë proces me shembuj nga jeta e Pejgamberit a.s. dhe nga jeta e gjeneratave të para (*muslimane*). Për shembull, një mësues në shoqërinë arabe rastis të ketë nxënës që u takojnë shkollave të ndryshme islame, të cilat ndajnë mendime të ndryshme në formën e adhurimeve apo të marrëdhënieve ndërnjerëzore, si p.sh. dallimet mes sunive dhe shiitëve. Në këtë rast mësuesi duhet t'i gërshetojë apo t'i paraqesë qëndrimet e të dy shkollave në mësimdhënien fetare, ku burimi i të dyjave është Kur'ani dhe Tradita Pejgamberike e Muhamedit a.s. Në këtë mënyrë do të mund t'i shmangë dallimet dhe mospajtimet të cilat mund ta përplasin shoqërinë kur këta nxënës të rriten. Kjo formë e edukimit është e pritshme pas një periudhe kohore të japë frytet e saja.

Edukimi (*pedagogjia*) është i domosdoshëm për shoqëritë tona islame, sepse duhet të forcohen degët e përbashkëta dhe të konfirmohet identiteti islam. Kjo realizohet përmes përkushtimit ndaj mësimit të gjuhës arabe, sepse ajo është gjuha e Kur'anit Fisnik dhe gjuha e kulturës arabe-islame qysh kur Allahu e nderoi këtë umet me Islam. Po ashtu, në asnjë mënyrë nuk nënvleftësohet thirrja se mësimi i gjuhëve të huaja është domosdoshmëri e kohës për të komunikuar drejt me burimet e reja dhe të ndryshme (*nga kultura jonë*). Në botë ekzistojnë popuj që kanë treguar zhvillim të madh,

si p.sh. japonezët, kinezët e tjerë, ku përmes mësimit të gjuhës së tyre mund të mësohen zhvillimet shkencore bashkëkohore dhe teknologjia. Mësimi i gjuhës arabe nuk bie ndesh me mësimin e gjuhëve të tjera të huaja, prandaj le t'i stimulojmë dhe le t'i nxisim bijtë tanë t'u qasen burimeve të ndryshme të dijes së re perëndimore![51]

Po ashtu, edukimi mund të konstatojë edhe mësimin e historisë dhe të gjeografisë me theks të veçantë, sepse ato mund të jenë sferë e bujshme dhe aktive për mësimin dhe mbjelljen e vlerave ndihmëse të identitetit islam dhe për arritjen e mëvetësisë mes anëtarëve të umetit. Sado të jenë të ndryshme etnitë dhe drejtimet sektare, përmes këtyre lëndëve (*historisë dhe gjeografisë*), mund t'u flasim bijve tanë për ngjarjet historike dhe për faktin se si muslimanët kur ishin të përkushtuar bashkërisht ndaj Litarit të Allahut, Allahu i ngriti dhe vërtet i bëri "umeti më i mirë për njerëzit". Gjithashtu, përmes këtyre bijtë tanë mësojnë se muslimanët në të kaluarën kanë dhënë një kontribut të frytshëm, të cilin njerëzimi e shfrytëzon edhe sot e kësaj dite. Pra, duhet t'i mësojmë bijtë tanë se muslimanët e kryesuan lëvizjen për zbulime shkencore dhe eksperiencën shkencore në kimi, fizikë, matematikë, astronomi, botanikë, mjekësi, inxhinieri dhe në shkenca të tjera. T'i njoftojmë me veprat e Xhabir bin Hajjanit, të Havarizmit, të Ibn Hejthemit, të Ibn Sinasë dhe me veprat e të tjerëve, mirëpo me kusht që të mos mjaftohemi vetëm me të kaluarën, por atë ta marrin si stimulues që i detyron gjeneratat e reja të veprojnë dhe të jenë pasardhësit më të mirë të paraardhësve më të dëlirë. Pastaj, duhet të rikthehet pjesëmarrja në lëvizjen reformuese botërore. Në të njëjtën kohë, t'u mësohet se këta dijetarë të çmuar, me veprat e tyre shkencore, menaxhonin vlerat etike të përftuara nga Libri i Allahut xh.sh. dhe nga tradita pejgamberike e

[51] Seid Ismail Ali: *Et-Ta'limu ala ebvabi 'l-karni 'l-hadi ve 'l-ishrine*, Kajro, Alemu 'l-Kutubi, 1996.

Muhamedit a.s. Veprat e tyre kontribuuan në realizimin e objektivave të sheriatit, dhe jo vetëm për përfitimin material dhe për sigurimin e mirëqenies së një grupi të caktuar klanor.

Domosdoshmëria sociale

Edukimi ka rol të dukshëm, kyç dhe të domosdoshëm në shumicën e proceseve sociale, veçanërisht në procesin e rregullimit social. Me frazën "rregullim social" nënkuptojmë rendin që e menaxhon lëvizjen e individëve, të asociacioneve dhe të organizatave brenda një shoqërie, dhe atë sipas kritereve dhe normave të caktuara. Disa mendojnë se "rregullimi" e privon lirinë dhe se individi e shijon lirinë aq sa mungon rregulli. Megjithatë, realiteti e thotë krejt të kundërtën e kësaj, sepse liria e plotë dhe pa rregull në fund domosdoshmërisht çon në humbjen e vetë lirisë dhe pastaj sundon logjika (*shtazarake*) ku i njihet liria vetëm më të fortit. Çdo mes i të fortëve ka edhe më të fortin, gjë e cila bën që në shoqëri të sundojë liria e pyllit dhe jo ajo e njeriut.[52]

Pavarësisht ekzistimit të "ligjeve" në sfera të ndryshme dhe me synime të llojllojshme për të vendosur rregullin shoqëror, megjithatë krejt këto mund të quhen rregullim i jashtëm, apo ligje të sjella si produkt i frikës dhe i ambicies nga një force tjetër njerëzore. Ky rregull i jashtëm, krahas rëndësisë dhe domosdoshmërisë, nuk është i mjaftueshëm, prandaj duhet edhe ana tjetër e rregullit, pra, rregulli i brendshëm, të cilin njerëzimi e quan si ndërgjegje. Në rastin e fundit shtytësi buron nga frika e njeriut ndaj Zotit, dhe nga dëshira për ta arritur kënaqësinë e tij. Ka dallim të madh që shpresa dhe frika të burojnë nga njeriu dhe të burojnë nga Allahu i Lartësuar. Në situatën e parë kur frika dhe shpresa burojnë nga njeriu, atëherë kemi të bëjmë me një nënshtrim

[52] Fiks Filipe H.: *Felsefetu 't-terbijjeh*, përkthim i Muhamed Lebib En-Nuxhejhi, Kajro, Daru 'n-Nehdati 'l-Arabijjeh, 1965, f. 444.

fals, i cili është i mbështjellë me mundësinë dhe vlerën e njeriut, kurse në situatën e dytë nënshtrimi (*adhurimi*) është për Allahun, Krijuesin dhe Furnizuesin Absolut. Në këtë të fundit shfaqet edukimi si faktor dhe forcë shumë e rëndësishme, e cila kontribuon në masë të madhe në formimin e këtij rregulli të brendshëm.

Nëse jeta e bartë vetinë e ripërtëritjes, atëherë njeriut si qenie e gjallë një ditë do t'i pushojë ekzistenca materiale dhe biologjike.[53] Megjithatë, puna nuk qëndron kështu sa i përket shoqërisë njerëzore, p.sh. sirianët që jetonin para më shumë se njëqind viteve, tani kanë shkuar në Botën Tjetër (*kanë vdekur*), mirëpo askush nuk mund të imagjinojë dhe të thotë se shoqëria siriane ka vdekur, sepse ajo vazhdon të qëndrojë në këmbë, falë Zotit, dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen, nëse do Zoti! Kjo nënkupton se ekzistenca sociale nuk mbështetet vetëm në ekzistencën individuale biologjike, por mbështetet në atë që mund ta quajmë ekzistencë kulturore. Çfarë nënkuptojmë me ekzistencë kulturore?

Nëse u hedhim një vështrim shoqërive të ndryshme të botës bashkëkohore, do të shohim se secila shoqëri dallohet nga të tjerat me tipin e raporteve të veçanta që ekziston mes anëtarëve të asaj shoqërie. Pastaj, këto raporte e krijojnë atë grup të vetëdijshëm i cili vrapon pas realizimit të qëllimeve të përbashkëta përmes mjeteve dhe të rrugëve përbashkëta.[54] Nëse egjiptiani flet, për shembull, për elementët përbërës të jetës egjiptiane, irakiani për elementët përbërës të jetës irakiane, apo për gjuhën arabe, për traditat islame, për mjetet specifike të prodhimit, për marrëdhëniet ndërnjerëzore, për vlerat morale, për tipat e disiplinave shkencore, për letërsinë dhe për artet apo për diçka tjetër, atëherë ai

[53] John Dewey, *Ed-Dimukratijjetu ve 't-terbijjeh*, f. 2.

[54] Alkene, Frederik, *Handel dhe Xherald: Et-Tiflu ve 'l-muxhtemeu, amelijjetu 't-tenxhi'eti 'l-ixhtimaijjeh*, Tanta, Muessesetu Seid Li 't-Tibaati, 1976, f. 10.

është duke folur për morinë e marrëdhënieve të trashëguara nga egjiptianët dhe irakianët gjatë historisë, derisa ato u bënë themeli nga i cili këta popuj e morën vetinë e tyre shoqërore. Njësoj si egjiptiani dhe irakiani është edhe puna e francezit, i cili flet për elementët e ndryshëm nga të cilët është formuar identiteti dhe ekzistenca e tij sociale.

Në bazë të kësaj, kultura është një tërësi komplekse organike e përfituar nga mundi shumëvjeçar, të cilin njeriu e ka fituar gjatë rrjedhës së tij historike, duke bashkëvepruar me atë që ua kanë transmetuar të dërguarit e Zotit, me komponentët e ambientit social dhe me vetë natyrën.

Nëse kultura është elementi esencial që e dallon njeriun,[55] atëherë si të paraqitet procesi edukativ si domosdoshmëri kulturore? Apo thënë më qartë: si të veprojë edukata (*pedagogjia*) në këtë sferë kulturore?

Po të spikasim ndryshimet e shoqërive njerëzore nga grupimet tjera të gjallesave, atëherë do të shohim se shoqëritë njerëzore angazhohen për ruajtjen e vetes, reformohen për të vazhduar jetën dhe angazhohen për të mbetur gjallë (*kultura*), kurse te grupet tjera të gjallesave vetëm ndërrohen gjeneratat vazhdimisht mbi bazën e instinktit pa ndryshuar dhe pa u reformuar asgjë.[56] Prandaj këto grupime shtazarake nuk posedojnë trashëgimi për ta bartur nga gjeneratat e kaluara tek ato vijuese. Nëse e trajnojmë një ari me ushtrime të veçanta, si p.sh. me shkathtësinë e luajtjes me top apo kërcimin në rrethin e zjarrtë, siç shohim nëpër lojërat e ndryshme në cirk, përsëri në fund do të vijmë në përfundim se ky ari nuk mund ta transmetojë ushtrimin te bijtë e vet, por duhet të njëjtin ushtrim t'ua mësojmë edhe të vegjëlve të tij nëse duam që ky veprim të përsëritet te gjeneratat vijuese.

[55] Muhjuddin Sabir: *Et-Tegajjuru ve tenmijetu 'l-muxhtemei*, Egjipt, 1962, f. 13.
[56] Mustafa Suvejf: *El-Usesu 'n-nefsijjetu li 't-tekamuli 'l-ixhtimaijju*, Kajro, Daru 'l-Mearif, 1955, f. 38.

Nga e gjithë kjo mund të themi se jeta njerëzore reformohet, zhvillohet dhe evoluon përpara përmes transmetimit të trashëgimisë kulturore nga brezat e kaluar në brezat e ardhshëm. Çdo gjeneratë njerëzore shton, heq, ndryshon, përmirëson apo zhvillon diçka. Duke e vështruar kulturën njerëzore në të cilën jeton njeriu bashkëkohor, na jep një mendim të qartë për trashëgiminë kulturore të akumuluar, të cilën e shfrytëzojmë dhe e cila është transmetuar te ne përgjatë mijëra vjetëve nga gjenerata në gjeneratë.[57]

Nga ana tjetër, rëndësia e edukimit përfaqet në procesin e normalizimit social përgjatë mësimit të gjuhës, e cila është mjet për të cilin mund të themi pa e tepruar aspak se po të mos ishte ajo, nuk do të kishte asnjë lloj zhvillimi në asnjë sferë. Njeriu është qenia e vetme së cilës Allahu i Lartësuar ia dhuroi këtë aftësi. Pavarësisht se edhe gjallesat tjera kanë aftësinë e komunikimit (*instinktiv*) apo të nxjerrjes së tingujve, nxjerrin zë dhe ndikohen prej tij, japin sinjal përmes zërit kur ballafaqohen me ndonjë rrezik e tjera, megjithatë, funksioni i gjuhës është shumë më tepër se kaq. Gjuha i mundëson njeriut t'i lidhë çështjet e kohës dhe të vendit, i ndihmon t'i diskutojë ndodhitë e së kaluarës dhe punët e së ardhmes, t'i trajtojë çështjet dhe ngjarjet në distancë apo i mundëson të diskutojë për çështje që realisht nuk ekzistojnë fare. Pra, njeriu përmes gjuhës mund të trillojë një ngjarje që për dëgjuesit të bëhet realitet, të imagjinojë imazhe të cilat ndoshta mund të përkthehen në realitet pas një periudhe kohore të gjatë apo të shkurtër.[58]

Gjuha nga vetë natyra nuk është e trashëgueshme, sepse përndryshe të gjitha shoqëritë njerëzore do të flisnin të njëjtën gjuhë. Ajo që është e trashëgueshme, është aftësia tingullore e përgjithshme, kurse ajo që i jep formë asaj që në një

[57] Dewey: *Ed-Dimukratijjetu ve 't-terbijeh*, f. 40

[58] Mustafa Suvejf: *El-Usesu 'n-nefsijjetu li 't-tekamuli 'l-ixhtimaijji*, f. 104.

vend të jetë gjuhë arabe, në një vend tjetër gjuhë franceze, angleze, gjermane apo kineze, është kultura rrjedhëse. Pastaj, familja me theks të veçantë bën ambientimin dhe inkuadrimin e bijve në atë gjuhë. Po ashtu, edhe shkolla i përgatit në aspektin shkencor, bashkë me një numër tjetër të institucioneve zhvillimore dhe edukative.

Sa i përket anës ekonomike,[59] çdo shtet përpilon projekt për zhvillimin ekonomik ku nuk mund të shpërfillet procesi i përgatitjes së individëve të cilët do të jenë krahu i prodhimit dhe i zhvillimit. Nuk ia vlen të ndërtohet një fabrikë për prodhimin e veturave apo të kompjuterëve nëse në të njëjtën kohë nuk merren masa për përgatitjen e inxhinierëve artistikë, të menaxherëve dhe të punëtorëve të shkathët, të cilët do ta lehtësojnë punën në atë fabrikë. Për këtë arsye disa specialistë insistuan që edukimi dhe arsimimi të kenë objektiva që përputhen me objektivat ekonomikë, në mënyrë që të përgatitet potenciali veprues për zhvillimin ekonomik, i cili konsiderohet komponenti më i rëndësishëm në këtë sferë qysh kur filloi të del në shesh roli i zhvillimit njerëzor. Vërehet qysh para disa dekadave, se ekonomistët dhe ata që i menaxhojnë punët e politikës ekonomike, i kushtojnë vëmendje më të lartë rolit që luan arsimi në zhvillimin ekonomik.

Thënë më mirë, arsimi dhe kultura kontribuojnë drejtpërdrejt dhe indirekt në mirëqenien e ekonomisë së umetit,[60] të cilat i mundësojnë individit zhvillimin e përkryer të aftësive dhe të potencialeve të tij, që kështu t'i bëjë mirë vetes dhe mbarë umetit. Kur kuptojmë se shumica e barrierave me të cilat ballafaqohet formimi dhe zhvillimi ekonomik kthehen te disa tradita dhe te disa mendime dominuese në vendet e zhvilluara, atëherë e kuptojmë sigurt se për ta civilizuar masën në epokën e dijes dhe të

[59] Murish Ifur: *Ilmu 'l-ixhtimai 't-terbevijji*, përkthim Hasen El-Fekkij, Kuvajt, 1993, f. 104.
[60] Nadir Ferxhani: *Hedru 'l-imkanijjeti*, Bejrut, Merkezu Dirasati 'l-Vahdeti 'l-Arabijjeh, 1980, f. 16.

shkencës, duhet ta stimulojë zhvillimin ekonomik dhe ta shtyjë atë përpara.

Eksperiencat e shoqërive të zhvilluara që i janë përkushtuar punës dhe prodhimit, bashkë me zhvillimin arsimor, na shpalosën një sërë konceptesh dhe drejtimesh të reja, të cilat shprehin raportin e gjallë dhe dialektik mes zhvillimit dhe edukimit[61] dhe të cilat konsiderohen burim i inspirimit dhe i orientimit të punëtorëve nëpër institucionet arsimore aktualisht. Prej tyre janë:

- Ndoshta koncepti dhe drejtimi i parë në këtë sferë është zhvillimi. Sidoqoftë pika fillestare e zhvillimit, ajo konsiderohet një proces gjithëpërfshirës, i cili trajton aspekte të ndryshme të jetës sociale, ekonomike dhe politike. Pikërisht për këtë arsye duhet realizuar ndonjë aktivitet zhvillimor në ndonjë aspekt të jetës, duke e vështruar edhe raportin aktiv dhe pasiv të këtij aktiviteti me aktivitete në aspektet tjera të jetës, bashkë me këtë vështrimin e përgjithshëm ndaj shoqërisë dhe jetës. Në krejt këtë mjedis, edukimi është një element i përbashkët, i cili patjetër të merret në konsideratë, pavarësisht nëse zhvillimi është politik, ekonomi apo social.

- Zhvillimi ekonomik dhe social nuk është një çështje që bëhet spontanisht apo si rezultat i një angazhimi të paplanifikuar, por është një proces me synim të caktuar dhe i rregulluar mirë, ku sundojnë faktorët e vetë ndryshimit, mobilizimit dhe të orientimit. Po ashtu, në projektimin e menduar mirë për një vizion të së ardhmes për shoqërinë, çështje kyçe është edhe tematika e ndryshimit (*evoluimit*). Meqë edukimi është një ndër faktorët esencialë të ndryshimit, duke e bërë atë si mjet të ndryshimit për njeriun, atëherë projektimi i çdo zhvillimi patjetër t'i marrë në konsideratë nevojat e potencialeve njerëzore. Jo siç shohim zako-

[61] Muhamed Mahrus Ismail: Iktisadijjatu 't-ta'limi, Kajro, El-Ahram, *Silsiletu Kitabi 'l-Ahrami 'l-Iktisadijji*, shtator, 1993, f. 10.

nisht në shumë projekte tradicionale të cilat ndalen në kufijtë e vlerësimit numerik të kërkesës së shtruar nga punëtorët e arsimit, por të përcaktohet edhe karakteri edukativ që paraqesin këto kërkesa të parashtruara.

- Qëllimi esencial i zhvillimit është implementimi i ligjit të Zotit, gjegjësisht nënshtrimi i resurseve në të mirë të popullit ku në qendër të vëmendjes është vetë njeriu. Njeriu, me mendje, me besim, me shëndet dhe me shkathtësinë e vet, është shtylla dhe gjeneratori i parë i zhvillimit, bile edhe i faktorëve të tjerë të zhvillimit bosht kyç është njeriu, si p.sh. i kapitalit (*zhvillimor*), i organizimit dhe i menaxhimit. Kapitali vjen nga kursimi, kursimi nga rritja e prodhimit dhe konsumi i vogël, kurse krejt këto realizohen nga puna, angazhimi, vetëdija dhe vlera që posedon vetë njeriu. Po ashtu, edhe organizimi dhe menaxhimi tek e fundit janë proces human dhe social. Prandaj, themel i zhvillimit të çdo shoqërie është zhvillimi i vlerave, i potencialeve intelektuale dhe i shkathtësive, të cilat konsiderohen si një infrastrukturë qendrore e zhvillimit në çdo sektor. Potencialet njerëzore janë të lidhura me interesin e vetë shoqërive që janë të vetëdijshme për problemet dhe synimet e veta. Këto shoqëri, gjithashtu, janë të pajisura me njohuri dhe shkathtësi të cilat lëvizin drejt përparimit, duke prodhuar mundësi dhe resurse lëndore dhe natyrore në këtë rrugëtim.

E katërta: metodologjia e hulumtimit në fundamentet e edukimit islam

Ibn Mendhuri e përkufizon metodën (*menhexhin*) si rruga e qartë dhe e kthjellët. Minhaxhi është njësoj si menhexhi (*metoda*), siç thuhet në Kur'anin Fisnik:

(لِكُلٍّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَاجًا)

"*Për secilin prej jush caktuam ligj dhe metodë (program)*" (*El-Maide: 48*)

Apo, siç shprehet Ibn Kethiri për fjalën minhaxh: "Rruga e qartë dhe e lehtë: ligjet dhe rrugët".[62]

Nëse metoda është rruga që çon drejt qëllimit, atëherë përcaktimi i qëllimit, qartësia dhe vetëdija e shëndoshë janë çështje themelore në përfitimin e metodës së qartë, të thukët dhe të saktë. Mjerë për popujt që humbasin ligjin, objektivin jetik dhe rrugën (*e duhur*)! Po ashtu, mjerim është për popujt që e kanë shkëputur programin dhe metodën e funksionimit të tyre nga burimi, prandaj thahet dhe shteron. Pastaj këta popuj enden rrugëve për të kërkuar në çdo derë burim tjetër. Megjithatë, në fund të udhëtimit, pasi të kenë trokitur çdo derë, kthehen duarbosh dhe të poshtëruar.

Realisht, umeti të cilin Allahu i Lartësuar e cilësoi si umeti më i mirë për njerëzimin dhe të cilit iu dhurua metoda dhe ligji i përkryer, nuk i takonte të hiqte dorë prej kësaj rruge, sepse kështu rrugët i kryqëzohen, i mjegullohen dhe vijnë një pas një vërshimet dhe ciklonet. Umeti filloi të gjurmojë kthimin e krenarisë, u turr pas shkaqeve tjera jashtë asaj që Allahu u zbriti, por kjo bëri që ai të përfundojë i nënçmuar dhe i poshtëruar. Kjo do të vazhdojë kështu derisa të zgjohet nga gjumi, t'i kthehet Allahut dhe të vetëdijesohet se krenaria i takon Allahut, të Dërguarit dhe besimtarëve. Filloi të punojë me zell për ta reformuar veten, ndoshta kështu do të kapte diçka nga ajo që i ka ikur dhe ta kthejë amanetin (*besimin*) që ajo të bëhet burimi nga ku do të lind dhe zhvillohet kultura (*e tyre*). Megjithatë, kjo nuk realizohet pa iu përkushtuar ligjit dhe programit (*të menduar mirë*).

Programi apo metoda në ligjin bashkëkohor nënkupton kujdesin ndaj motiveve pozitiviste lëndore të sjella nga shkenca, të cilat ndonjëherë janë të ndërtuara mbi bazën e supozi-

[62] Ibn Kethir: *Tefsiru 'l-Kur'ani 'l-Adhim*, Bejrut, Daru 'l-Andalus, 1400 h, vëllimi II, f. 588.

mit dhe të arsyes, e cila aspak nuk është e privuar nga egoja, bile ndonjëherë e quan përmirësim. Allahu xh.sh. thotë:

(وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ قَالُوا إِنَّمَا نَحْنُ مُصْلِحُونَ)

"Kur u thuhet atyre: "Mos bëni çrregullime në Tokë!" Thanë: "Ne jemi vetëm mirëbërës" (*El-Bekare: 11*)

Nuk është nevoja të perceptohet kjo 'bamirësi', e cila i çon huq punët e tyre, por ka nevojë për dikë i cili do t'ia zë frymën asaj, t'ia thyejë prangat dhe të depërtojë në rrugën (*metodën*) e cila është përftuar nga e vërteta, është themeluar nga dija e cila buron nga i Gjithëdijshmi dhe i Informuari hollësisht, dhe burim të vetin ka bindjen. Pra, vetëm atëherë do të lëvizin drejt përpjekjet që shpenzohen për ta bërë mirë atë që është shkatërruar me kalimin e kohës, siç supozojnë ata (*dyfytyrëshit*).

Duket se ne gjendemi para dy rendeve (*sistemeve*) pa alternativë tjetër: rendi kulturor, i cili ngrihet mbi prurjen shkencore e cila në shumicën e rasteve bazohet në hamendje dhe pak në ego. Ky rend pasohet me metodat dhe informatat pozitiviste të sistemeve dhe shkollave ku sundojnë sjelljet dhe grupet që besojnë në to. Kurse rendi (*i dytë*) është sistemi kulturor i kundërt (*me të parin*), i cili shtyllë të vetën ka diturinë e vërtetë dhe udhëzimin (*shpalljen*). Ky rend pasohet nga metodat që dalin nga burimi i së vërtetës dhe i udhëzimit. Në këtë mënyrë i ofron sistemet sociale, të harmonishme dhe njoftuese mes njëri-tjetrit mbi bazën e ligjit të tij (*të sheriatit*). Sa i përket rendit të parë, është në fuqi për momentin dhe cilësohet si bashkëkohor. Koha nuk ka të bëjë aspak me këtë rend, sepse është rend ku sundon dominimi. Ndërsa rendi i dytë është ai i cili kërkohet. Edhe pse nuk është i disponueshëm për momentin, ai mund të realizohet në dritën e vetëdijes, vendosmërisë dhe angazhimit që disponon.[63]

[63] Mina Abdulmun'im Ebu 'l-Fedli: Nahve minhaxhijjeti li 't-teamuli mea mesadiri 't-tendhiri 'l-islamijji bejne 'l-mukaddemati ve 'l-mumavvimati, në "*El-Menhexhijjetu 'l-islamijjetu*, burimi i mëparshëm", vëllimi III, f. 18.

Nëse përkufizimi i fjalës menhexh (*metodë*) është rruga e lehtë dhe e qartë apo traditë dhe rrugë, ky atëherë është një përkufizim i përgjithshëm që vlen për çdo aspekt dhe për çdo sferë të jetës, si p.sh. për agronominë, për artizanatin, për tregtinë, për edukimin për lëmenjtë e tjerë. Një grup i madh i specialistëve të pedagogjisë (*edukimit*) metodës (*menhexhit*) i japin kuptim tjetër, pra nuk e kanë për qëllim atë që flitet për "metodologjinë", por e paraqesin kështu: "Një tërësi eksperiencash dhe aktivitetesh të ofruara nga shkolla, nën mbikëqyrjen e saj, për nxënësit, me qëllim të kontaktit dhe të bashkëveprimit të tyre me të. Si rezultat i këtij kontakti dhe i këtij bashkëveprimi ndodh arsimimi dhe përmirësimi i sjelljeve të nxënësve, e pastaj kjo çon drejt zhvillimit gjithëpërfshirës dhe të përkryer", e që kjo e fundit është objektiv i vetë pedagogjisë (*edukimit*).[64]

Në këtë përkufizim vërehen dy çështje: e para, ky përkufizim është i gjerë dhe përfshin përvojat e ndryshme pedagogjike, përmes të cilave transmetohet përmbajtja e metodës (*menhexhit*). Gjithashtu, përfshin lëndët, mënyrat dhe mjetet që përdoren në procesin arsimor. E dyta, se koncepti i metodës (*menhexhit*) këtu i përfshin lëndët e përcaktuara, kurse lënda e përcaktuar përfshin njësitë dhe njësitë formohen nga disa mësime.[65]

Ky koncept për metodën (*menhexhin*), pavarësisht gjerësisë dhe gjithëpërfshirjes, nuk mund të jetë koncept i metodës (*menhexhit*) së pedagogjisë islame. Ky nocion nuk nënkupton "metodën" në hulumtimin shkencor, por është një nocion që i ul njerëzit në tokë, i përgatit ta shfrytëzojnë, ta ndërtojnë dhe të luftojnë për të shikuar te Krijuesi i tokës dhe i qiellit dhe pa e lidhur njeriun me burimin e ekzistencës së tij.

[64] Muhamed Izzet Abdu El-Mevxhudi dhe kolegët e tij: *Esasijjatu 'l-menhexhi ve tendhimatihi*, Kajro, Daru 'th-Thekafeti li 't-Tibaati ve 'n-Neshri, 1981, f. 11.

[65] Ali Medkuri: *Menhexhu 't-terbijjeti fi 't-tesavvuri 'l-islamijji*, Bejrut, Daru 'n-Nehdati 'l-Arabijjeh, 1990, f. 39.

Pra, ky koncept vlen për të gjithë shoqëritë dhe për të gjitha kulturat. Në bazë të kësaj metode, çdo shoqëri mund ta projektojë një metodë (të vetën) që i përshtatet jetës së tyre në tokë.

Puna qëndron krejt ndryshe me metodologjinë e pedagogjisë islame. Detyra e parë dhe e fundit e kësaj metode është që njeriu të lidhet me Allahun për ta përmirësuar gjendjen e tij në tokë, për ta sistemuar, për ta ndërtuar dhe për ta ngritur atë përmes mundit dhe zellit të vazhdueshëm. Po ashtu, përmes analizimit të jetës, shfrytëzimit të krejt potencialeve dhe mundësive perceptuese që i ka falur Allahu. Krejt këtë duhet ta bëjë duke qenë i orientuar me mendje dhe zemër drejt Allahut. Në këtë mënyrë lidhet mbretëria e tokës me atë të qiellit.[66]

Sa i përket nocionit të metodës në procesin e "hulumtimit shkencor" në përgjithësi, përdorimi i kësaj fjale nënkupton "një plan të sistemuar të disa proceseve mendore dhe shqisore për të arritur zbulimin e një realiteti apo prove rreth saj."[67] Në një përkufizim tjetër thuhet: "Metoda është art i sistemimit të drejtë të një sërë mendimeve, ose për të zbuluar realitetin që nuk e dimë, ose për t'ua argumentuar atë të tjerëve që nuk e njohin."[68] Ndërsa "hulumtimi shkencor" është mjet studimi, përmes së cilit mund t'i zgjidhim problemet e ndryshme, dhe atë nëpërmjet hulumtimit gjithëpërfshirës dhe të thukët të të gjitha dukurive, variableve dhe provave që kanë të bëjnë me problemet e hulumtimit. Kjo nuk ka të bëjë thjesht me arritjen e të vërtetave të reja dhe zbulimin e tyre për t'i zhvilluar njohuritë e njerëzimit, por ka nevojë edhe për aplikim. Pra, nocioni "hulumtim shkencor" flet edhe për aspektet praktike për të zgjidhur problemet jetike.[69]

[66] Po aty.

[67] Mexhdij Vehbeh dhe Kamil El-Muhendis: *Mu'xhemu 'l-mustalehati 'l-edebijjeti fi 'l-lugati ve 'l-edebi*, Bejrut, 1984, Mektebetu Lubnan, f. 293.

[68] Abdurrahman Bedevij: *Menahixhu 'l-bahthi 'l-ilmijji*, Kuvajt, Vekaletu 'l-Met'buati, 1977, f. 4.

[69] Ali Halil Mustafa Ebu El-Ajnejni: Menhexhijjetu 'l-bahthi fi 't-terbijjeti 'l-islamijjeh, "Risaletu 'l-Halixhi 'l-Arabijji", Rijad, *Mektebu 't-Terbijjeti 'l-Arabijji li Duveli 'l-Halixhi*, e shkëputur nga numri 23, viti VIII, 1988, f. 13.

Kjo përshtatet me hulumtimin pedagogjik, i cili, po ashtu, përfaqëson një përpjekje për të zgjidhur problemet akademike dhe praktike me të cilat synohet me theks të veçantë dhënia përgjigje pyetjeve me të cilat ballafaqohen pedagogët (*edukatorët*). Gjithashtu, kërkon t'i shpalosë anët e zymta të procesit edukativ dhe hedh dritë mbi to, duke bërë përpjekje të sqarojë gjërat e paqarta dhe të ofrojë zgjidhje për zgjidhjen e ndonjë problemi të caktuar, apo të zbulojë ndonjë dije të re (*shkencore*), duke u thelluar në të gjitha dimensionet e ndryshme të sferës së edukimit (pedagogjisë). Hulumtimi shkencor nuk përqendrohet vetëm në eksperiencën e terrenit, sepse shkenca është shpirt, metodë dhe mënyrë, por është edhe soditje me të cilën bëhet përpjekje për t'u arritur kuptimi dhe dituria mbi një bazë të qartë. Një metodë e konsoliduar nënkupton një mendim shkencor (*të mirëfilltë*). Hulumtimi në pedagogjinë islame vazhdon të jetë i përkushtuar pas stilit të qartë shkencor, bile ai është thelbi i shkencës dhe i studimeve shkencore.[70]

Kush arrin ta kuptojë gjendjen dhe cekëtinë e mendimit pedagogjik islam të kohëve të fundit, kupton se zgjidhja e problemeve pedagogjike në shoqërinë muslimane dhe sfida me problemet e saj përmes thellimit, guximit dhe përkushtimit, mund të bëhet vetëm përmes themelimit të një disipline shkencore metodologjike dhe përmes studimit shkencor të vazhdueshëm. Pra, nuk bëhet fjalë këtu për përsiatjet intelektuale spontane dhe të kufizuara, të cilat kanë qenë të pranishme gjatë historisë islame, por atyre u ka munguar potenciali dhe vizioni i nevojshëm shkencor-pedagogjik.[71]

Pavarësisht se përsiatjet e mendimit islam rreth problemeve të pedagogjisë islame na i pasqyrojnë objektivat e mirëfillta pas së cilave është vënë feja islame dhe të cilat du-

[70] Po aty, f. 14.

[71] Abdulhamid Ebu Sulejman: Islamijjetu 'l-ma'rifeti ve ilmu 't-terbijjeh, në konferencën "*Nahve binai nadharijjetin terbevijjetin islamijjetin*", vëllimi 2, f. 20.

het mbjellë në shpirtin e muslimanit në mënyrë që ato të jenë tulla dhe bërthama e shëndoshë për ndërtimin e umetit dhe shoqërisë muslimane. Mirëpo, mungesa e studimit metodologjik-shkencor në sferën e shkencave bihevrioriste ka rezultuar me kufizim të informacioneve shkencore, gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të sistemuara për natyrën dhe karakteret njerëzore, për mënyrën e formimit dhe të zhvillimit të tyre, dhe për fazat në të cilat kalojnë ato. Zhvillimi i tyre në jetën e individit nuk është më pak i zhvilluar sesa zhvillimi i vetë trupit të tij, bile zhvillimi psikik (*shpirtëror*) është më i thukët dhe më kompleks se zhvillimi i trupit, madje edhe më i nevojshëm për t'u studiuar, kuptuar, kujdesur, ndërtuar dhe për t'u vlerësuar.

Deri tani e pamë se fjala menhexh (*metodë*) ka kuptimin e përgjithshëm "rrugë e jetës" dhe kuptimin e veçantë në hulumtimin shkencor, atëherë shtrohet pyetja: çfarë i lidh këto dyja? Në vazhdim do ta sqarojmë këtë:

Cilido qoftë fusha e specializimit të studiuesit musliman, ai nuk i studion dukuritë vetëm mbi bazën e metodave të hulumtimit dhe larg fundamenteve islame që ndërlidhen me tematikën studimore, por me hulumtimet e tij reflektonte një frymë shkencore islame, ku studimi infiltrohej dhe lidhej me një vështrim të përgjithshëm për universin, njeriun dhe shoqërinë. Nëse u hedhim një vështrim inspektues librave të studiuesve muslimanë të sferave të ndryshme shkencore, do të del në shesh vetia esenciale e metodologjisë islame, e cila ka gërshetuar thukëtinë shkencore, përdorimin e metodave të ndryshme hulumtuese dhe shoqërimin me tekstet e shenjta (*nga Kur'ani Fisnik dhe nga Tradita Pejgamberike*), pavarësisht nëse tematika shkencore që studiohej i takonte sferës së shkencave natyraliste, politike, ekonomike apo edukative.[72]

[72] Abdurrahman Abdurrahman En-Nekibi: *Nahve menhexhijjetin ilmijjetin fi 'l-bahthi 't-terbevijji 'l-muasiri*, në revistën (e thënë më parë), 207.

Për shembull, Ibn Sehnuni (202 h. – 256 h.), në veprën e tij "Adabu 'l-mual-limine", për trajtimin e temave edukative (*pedagogjike*) e ka përdorur metodën usuliste-analitike. Është e ditur se Ibn Sehnuni e përfaqëson drejtimin fikhor në pedagogjinë islame, kurse vepra e tij konsiderohet ndër shkrimet e para pedagogjike të njohura te ne deri më sot. Ndërsa Ibn Meskevejhi (320 h. -410 h.) në librin "Tehdhibu 'l-ahlak" e përdor metodën analitike-filozofike, ku e analizon dukurinë dhe problemin përball elementëve tjerë, saqë mund të perceptohet qartë. Pastaj e ribën sipas pikëpamjes filozofike që ka përdorur në studim.[73] Ibn Halduni (732 h. – 808 h.) anon kah përdorimi i asaj që mund ta quajmë "gërshetim" i metodave hulumtuese, kurse në Mukaddimen e përdor metodën sociale. Mirëpo, në kreun e gjashtë të Mukaddimes së tij të njohur, ku flet për shkencën dhe arsimin, e ka përdorur metodën historike, duke e shfrytëzuar aty-këtu edhe metodën krahasuese për tematikat që e kërkojnë atë.

Studiuesi i pedagogjisë islame nuk mundet dhe as nuk duhet që besimin e plotë në fundamentet e pakontestueshme të Islamit (*në Kur'anin Fisnik dhe në Traditën e vërtetë pejgamberike*) ta ndajë nga teknikat e hulumtimit shkencor, por t'u përkushtohet këtyre paralelisht përmes leximit me kujdes të librave të metodologjisë së hulumtimit shkencor dhe përmes ushtrimit vetjak, duke u ndihmuar edhe nga përvojat e ekspertëve në fushën e hulumtimit pedagogjik. Pra, vetëm mbështetja në teknikat e njohura të hulumtimit pedagogjik nuk mjafton për të fituar metodologjinë islame (pedagogjike), përderisa në të njëjtën kohë nuk ka referim të plotë në fundamentet islame që flasin për temën që hulumtohet. Kështu, ky referim do të reflektojë gjatë prezantimit të rezultateve të studimit.[74]

[73] Po aty, f. 212.

[74] Abdulvehhab Ibrahim Ebu Sulejman: *Menhexhu 'l-bahthi fi 'l-fikhi 'l-islamijji*, Mekë, El-Mektebetu 'l-Mekkijjeh, 1996, f. 16.

Mbi bazën e kësaj, hulumtuesi i fundamenteve të pedagogjisë islame mund t'i përdorë të njëjtat metoda hulumtuese që i përdor çdo drejtim tjetër, veçse kushtëzohet të plotësohen këto tri çështje:

E para: hulumtimin ta fillojë nga pikëpamja islame për Zotin, për kozmosin, për njeriun dhe për shoqërinë.

E dyta: gjatë hulumtimit t'i përmbahet sistemit të vlerave etike të aprovuara nga Islami, gjegjësisht nga Libri i Allahut dhe nga Tradita Pejgamberike.

E treta: të kujdeset që hulumtimi i tij të jetë një hap i hedhur në rrugën drejt objektivave të sheriatit.

Për shembull, nëse hulumtuesi është i interesuar të studiojë zhvillimin e institucioneve edukative, si mektebet, xhamitë, medresetë dhe të tjera, atëherë duhet t'u përmbahet rregullave të metodës historike, të cilat janë të njohura tek ekspertët e metodës së hulumtimit historik, duke i shtuar kësaj edhe atë që u theksua në paragrafin paraprak.

Njësoj vepron nëse është i interesuar të studiojë një koncept, një ide apo një drejtim të ideologëve të pedagogjisë islame. Me këtë rast, patjetër duhet t'i vërë veshin metodës filozofike, pikërisht siç njihet ajo tek ekspertët e kësaj metodologjie (*të filozofisë*) etj.

E nëse hulumtimi lidhet me një çështje nga Kur'ani Fisnik, nga tradita Pejgamberike apo nga të dyja bashkërisht, atëherë domosdo duhet mbështetur në metodën e usulistëve të fikhut islam. Edhe këtu shohim disa hapa të cilat duhet ndërmarrë hulumtuesi i kësaj sfere:[75]

I pari: paraqitja e tërësishme e teksteve që lidhen me tematikën, pavarësisht nëse e mohojnë apo e pohojnë atë, të përgjithshme apo specifike etj. Pastaj i klasifikon dhe i rendit varësisht siç e kërkon analiza shkencore.

[75] Po aty, f. 17.

I dyti: analizimi shkencor i teksteve. Këtu shfaqet shkathtësia dhe potenciali shkencor i hulumtuesit. Në këtë pikë studiuesit dallojnë nga njëri-tjetri, prandaj dallojnë edhe kuptimet. Secilit i shpalosen kuptime, domethënie, mundësi dhe degëzime që nuk i shfaqen tjetrit. Analizimi shkencor i argumenteve të hulumtimit usulist nënkupton dallimin e tyre bashkë me kuptimet dhe interpretimet e tyre. Provat e forta i pranon, të dobëtat i hedh anash, kurse kuptimet dhe imazhet e tyre i sqaron. Pastaj u bën kritikë dhe i shpall si të dobëta ato që kanë nevojë për një gjë të tillë.

I treti: nxjerrja e përfundimeve (*dispozitave*). Ky hap përfaqëson synimin përfundimtar të procesit hulumtues (*në lëmin e usulit*), ku hulumtuesi me këtë rast i fiton drejtimet, idetë, dispozitat dhe rregullat e përgjithshme. Ky hap do të jetë efikas aq sa është ecur drejt dhe me korrektësi në dy hapat paraprakë.[76]

Disa shtojnë edhe burime të tjera pasuese të Kur'anit dhe të traditës Pejgamberike, si p.sh. ixhmain (*konsensusin*), kijasin (*analogjinë*) dhe urfin (*traditën*). Pastaj interesin e përgjithshëm të muslimanëve (*maslahatin*), i cili kryesisht konsiderohet si "ixhtihad" (*përpjekje*), i cili duhet të plotësojë disa kushte dhe rregulla, dhe jo të mbetet një tokë e hapur për të gjithë.

Nuk ka dyshim se problemet pedagogjike mund kenë më shumë hapësirë për ixhtihad (*përpjekje intelektuale*), veçanërisht kur dihet se ato janë çështje që pësojnë ndryshime në varësi të kohës dhe të vendit. Gjithashtu, shumica e tyre nuk hyjnë në rrethin e mendimit apo analizimit. Megjithatë, përzgjedhja e njërës mënyrë apo tjetër nga ana e mësuesit nuk hyn në këtë sferë, sepse atë e diktojnë rrethanat dhe ndryshimet që jeton qëndrimi pedagogjik.

Po ashtu, të gjitha çështjet edukative mund të mos i nënshtrohet as ixhmait (*konsensusit*), sepse disa çështje kanë

[76] Po aty, f. 18.

pikëpamje të ndryshme dhe dallojnë në varësi të kulturave dhe qytetërimeve, edhe pse kjo në asnjë mënyrë nuk e mohon ixhtihadin (*konsensusin*) për disa rregulla të përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, si p.sh. nxënësit ta shoqërojnë mësuesin e tyre për të arritur dituri, shprehja e mendimit, diskutimi dhe kritika, d.m.th. këto janë rregulla të pranuara nga të dy pedagogët (*islam dhe profan*). Po ashtu, ka një sërë rregullash etike që aprovuara nga konsensusi, si p.sh. ndalimi i mashtrimit, vjedhja e provimeve etj.

Edhe urfi (*tradita*) pajtohet plotësisht me fundamentet e përgjithshme pedagogjike (*edukative*). Nga gjërat që i pranon mendimi pedagogjik është se procesi edukativ u ekspozohet ndryshimeve të kontekstit kulturor ekzistues, të atij që e njeh shoqëria dhe në të cilin njerëzit janë ambientuar. Ky është një kusht themelor në këtë kontekst kulturor, ku assesi me të nuk synohen ndryshimet e përkohshme dhe të rastësishme.

Ndoshta më mirë këtu është të paraqesim një shembull praktik të një ixhtihadi (*përpjekjeje*) klasike të një studiuesi dhe një pedagogu të fikhut, gjegjësisht të Kabisiut, i cili përgjatë përpjekjes (*ixhtihadit*) të tij përpiqej të nxjerrë disa ide, rregulla dhe drejtime pedagogjike të cilat realisht mund t'i cilësojmë si "islamike". Kabisiu u mbështet në provat nga Kur'ani Fisnik dhe nga tradita Pejgamberike, ku ndër të tjerash kemi shkëputur këto:[77]

1. Allahu i Madhëruar në Librin e Tij Fisnik e ka sqaruar dhe e ka cilësuar lexuesin si më poshtë:

(إِنَّ الَّذِينَ يَتْلُونَ كِتَابَ اللهِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنْفَقُوا مِمَّا رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً يَرْجُونَ تِجَارَةً لَنْ تَبُورَ)

"Me të vërtetë, ata që e lexojnë Librin e Allahut, e falin namazin dhe japin nga ajo që ne i kemi furnizuar fshehtas dhe haptas, shpresojnë një tregti që nuk humb." (*Fatir: 29*)

[77] Seid Ismail Ali: *Mesadiru 't-terbijjeti 'l-islamijjeh*, në "Seid Ismail Ali (recension)": Libër vjetor në pedagogji dhe në psikologji, Kajro, Alemu 'l-Kutubi, 1973, 67

Hasan Basriu ka thënë: "Kush e lexon Kur'anin me shkathtësi, urdhërohet ta lexojë atë. Prandaj Allahu xh.sh. thotë:

(يَاأَيُّهَا الْمُزَّمِّلُ ، قُمِ الَّيْلَ إِلَّا قَلِيلًا ، نِصْفَهُ أَوِ انْقُصْ مِنْهُ قَلِيلًا ، أَوْ زِدْ عَلَيْهِ وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلًا)

"O ti i mbështjellur! Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj. Gjysmën e saj ose diç më pak se gjysmën. Ose shto diç prej saj dhe Kur'anin lexoje me vëmendje." (*El-Muzzemmil: 1-4*)

2. Domosdoshmëria që mësuesi të sillet me butësi me nxënësit mbështetet në fjalët e Muhamedit a.s. të transmetuara nga Aishja r.a.: "O Zot, atij që i jepet pushtet ndaj umetit tim, bëje të sillet butë me ta dhe të sillen butë me të, ashtu që kush i ngarkon ata, ta ketë ngarkuar edhe atë."[78]

3. Për lejueshmërinë e mësimit të poezisë është mbështetur në atë që është transmetuar nga Muhamedi a.s., ku thotë: "Poezia është fjalë: e bukura është e bukur dhe e shëmtuara është e shëmtua."

Nga shembujt që tregojnë mbështetjen e tij në ixhma (konsensus) janë vetë fjalët e tij ku thotë se prekja e mus'hafit nga fëmijët që nuk kanë avdes nuk është e lejuar, megjithatë puna ndryshon për pllakat që përdoren nëpër mektebe. Pohon se nuk ka divergjencë mes dijetarëve të mëdhenj të fikhu për ndalesën e prekjes së mus'hafit pa avdes."

Gjithashtu, Kabisiu e ka përdorur edhe analogjinë sheriatike, p.sh. dispozita e prindit për mësimin e fëmijës së vet Kur'an, ku mbështetet në atë që është transmetuar, se "Pejgamberi a.s. kaloi pranë një gruaje që ishte ulur në karrige, së cilës iu tha: ky është i Dërguari i Allahut a.s. Ajo e kapi me gishta një fëmijë të vogël që kishte me vete dhe tha: "A ka haxh të pranuar ky?" Muhamedi a.s. i tha: "Po! Dhe ti do të kesh shpërblim."[79] A shpërblehet kjo grua për fëmijën e saj vetëm pse e ka sjell në haxhillëk?! Sigurisht,

[78] E ka paraqitur Imam Ahmedi në "*Musnedin*" e tij, vëllimi VI, f. 256, Damask, Daru 'l-Fikr.
[79] *Sahihu Muslim*, Kitabu 'l-haxhxhi, hadithi numër 2378.

mësimi i Kur'anit këtij fëmije është më afatgjatë dhe më i vlefshëm."[80]

Kështu Kabisiu sjell një analogji tjetër për mësimin e fëmijës nga ana e prindit, "se dispozita e fëmijës gjersa është i vogël bie mbi prindin. A e le prindi fëmijën e vet pa ia mësuar fenë?! Mësimi i Kur'anit konfirmon njohjen edhe të fesë." Në këtë analogji mbështetet në hadithin e Muhamedit a.s., të cilin e sqaron gjerësisht. Muhamedi a.s. ka thënë: "Çdo fëmijë lind në natyrën e tij të pastër. Prindërit e bëjnë atë hebre, të krishterë apo adhurues zjarri. Njësoj si kafshët që lindin kafshë. A sheh këtu ndonjë ndërprerje?!"[81] Të pranishmit thanë: "O i Dërguari i Allahut, e çfarë bëhet me fëmijën që vdes i vogël?" Muhamedi a.s. tha: "Allahu e di më mirë se çfarë mund të vepronin." Kabisiu e interpreton kështu: "Pejgamberi a.s. na ka treguar për atë çfarë fëmija arrin të marrë nga prindërit, gjegjësisht atë që mëson, kurse sa i përket asaj se nëse fëmija vdes para se të arrijë moshën madhore, Muhamedi a.s. këtë çështje e le në dije të Zotit, sepse vetëm Ai e di se çfarë do të punonin nëse do të jetonin. Nëse fëmija është i jobesimtarëve, atëherë mund ta prekë dëmi i baballarëve të tyre, kurse të besimtarëve mund kenë dobi nga baballarët e tyre."

Pastaj mbështetet edhe në traditë (*urf*) dhe thotë: "Sipas meje, njësoj qëndron puna edhe me mësuesit dhe traditat, të cilat nëse janë të mira, atëherë duhet përhapur në bazë të asaj që i përshkruam." Aplikim i traditës sipas fjalëve të tij është p.sh. lënia e lirë e fëmijëve ditën e enjte nga koha e namazit të iqindisë për të vrapuar, kuptohet sipas traditës së disa popujve." Po ashtu, edhe për pushimin e bajrameve etj.

Kabisiu e sheh edhe interesin e nxënësve në raport me themelet psikologjike, prandaj e ka obliguar sjelljen e butë

[80] Ahmed Fuad El-Ehvani, *Et-Terbijjetu fi 'l-islami, ev et-ta'limu fi re'ji 'l-Kabisijji*, Kajro, Daru Ihjau 'l-Kutubi 'l-Arabijjeti, 1955, f. 288.

[81] *Sahihu 'l-Buhari*, Kitabu 'l-xhenaizi, vëllimi II, f. 127, hadithi numër: 1385.

ndaj fëmijëve dhe mos ngrysjen para tyre. Ngrysja e mësuesit nuk duhet ndodhur asnjëherë, sepse vrazhdësia është e padëshiruar, por duhet t'i shoqërojë fëmijët dhe t'u japë guxim para vetes. Pra, nëse e përdor butësinë dhe i familjarizon ata gjatë edukimit, atëherë kjo tregon se edukata është transmetuar dhe ata shoqërohen me të." Në këtë sferë ai tregon domosdoshmërinë e shmangies së sharjes nga ana e mësuesit, sepse "fjalët e shëmtuara dalin nga gjuha kur i jepet hapësirë nervozizmit, kurse këtu nuk ka vend aspak nervozizmi."[82]

Megjithatë, ka disa kondita themelore në të cilat duhet të mbështetet hulumtimi shkencor:[83]

1. Perceptimi i një problemi mund të bëhet vetëm përmes shqisave, ku shikimi dhe dëgjimi kanë një rol të madh, edhe pse të gjitha janë të rëndësishme. Mjetet që përdoren nga disa dijetarë për paraqitjen e disa vërejtjeve vetëm se i ndihmojnë këto shqisa dhe ua shtojnë efikasitetin atyre, si p.sh. mikroskopët dhe teleskopët nuk janë mjete alternative të shikimit, por mjete ndihmëse të cilat përdoren për zmadhimin e gjërave të imëta dhe afrimin e gjërave të largëta. Njësoj qëndron puna edhe me dëgjueset mjekësore. Edhe këto nuk janë mjete alternative të shqisës së dëgjimit, por janë aparate ndihmëse për rritjen e zhurmës së tiktakeve të zemrës. Allahu i Lartësuar e ka pajisur njeriun me mjete që i mundësojnë mësimin dhe fitimin e dijes, pra, njeriu i përdor këto shqisa për të fituar dituri, sepse kur lind nuk di asgjë. Allahu i Madhërishëm thotë:

(وَٱللَّهُ أَخۡرَجَكُم مِّنۢ بُطُونِ أُمَّهَٰتِكُمۡ لَا تَعۡلَمُونَ شَيۡـٔٗا وَجَعَلَ لَكُمُ ٱلسَّمۡعَ وَٱلۡأَبۡصَٰرَ وَٱلۡأَفۡـِٔدَةَ لَعَلَّكُمۡ تَشۡكُرُونَ)

"Allahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja duke mos ditur ju asgjë. Ju bëri juve dëgjim, shikime dhe zemra, që ju të falënderoni." (*En-Nahl: 78*)

[82] Ahmed Fuad El-Ehvani: *Et-Terbijetu fi 'l-Islami*, f. 37

[83] Hamdi Ebu 'l-Fetuh Utifeh: Tesavvurun mukterehun li es'limeti 'l-hutati 'd-dirasijjeti li 'l-ulumi 'l-medresijjeh, në "*El-Alemu 'l-islamijju*", Mekë, El-Merkezu 'l-Alemijju li 't-Ta'limi 'l-Islamijji, 1406 h., f. 46

2. Mbështetja në arsye. Arsyeja është mjeti që mundëson krijimin e marrëdhënieve mes dukurive, të cilat në shikim të parë duken të pa ndërlidhura.[84] Individi mund të vërejë se kur një shufër hekuri nxehet, zgjatet. Herën tjetër sheh se edhe bakri dhe alumini kur nxehen zgjaten. Pra, në krejt këto raste e përdor shqisën e shikimit për të vërejtur zgjatjen gjatë nxehjes. Mirëpo, nuk mund të vijë në përfundim se të gjitha metalet zgjaten në nxehtësi nëse nuk e përdor mendjen që të perceptojë lidhshmërinë mes hekurit, bakrit dhe aluminit. Prandaj, nuk ka pse habitemi kur shohim se versetet kur'anore që flasin për rëndësinë e dëgjimit dhe të shikimit, ato në të njëjtën kohë bëjnë një ndërlidhje të shqisave me arsyen duke zënë në gojë menjëherë pas tyre zemrat (*ef'idetun*).

(إِنَّ ٱلسَّمۡعَ وَٱلۡبَصَرَ وَٱلۡفُؤَادَ كُلُّ أُوْلَٰٓئِكَ كَانَ عَنۡهُ مَسۡـُٔولٗا)

"Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha këto janë përgjegjëse për të." (*El-Isra': 36*)

(أَفَلَمۡ يَسِيرُواْ فِي ٱلۡأَرۡضِ فَتَكُونَ لَهُمۡ قُلُوبٞ يَعۡقِلُونَ بِهَآ أَوۡ ءَاذَانٞ يَسۡمَعُونَ بِهَاۖ فَإِنَّهَا لَا تَعۡمَى ٱلۡأَبۡصَٰرُ وَلَٰكِن تَعۡمَى ٱلۡقُلُوبُ ٱلَّتِي فِي ٱلصُّدُورِ)

"A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të kenë zemra me të cilat do të kuptojnë, dhe veshë me të cilat do të dëgjojnë? Pse në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharor." (El-Haxh: 46)

3. Këtu ka një aspekt në ajetet kur'anore, i cili e sqaron edukatën e hulumtimit shkencor, pra të jetë e shoqëruar me modesti dhe të ecë drejt të vërtetave, duke i shmangur dyshimet dhe supozimet. Më pastaj, hulumtuesi në Islam e ndjen në çdo moment nevojën e shtimit të diturisë, prandaj thërret: (وَقُلۡ رَبِّ زِدۡنِي عِلۡمٗا) *"Dhe thuaj: O Zot, ma shto diturinë!" (Taha: 114)*. Sado të zgjerohet dhe të profesionalizohet, ai përsëri e konsideron diturinë si diçka të humbur, prandaj

[84] Po aty, f. 47.

çdoherë lutet me fjalët e Zotit: (وَمَا أُوتِيتُمْ مِنَ الْعِلْمِ إِلَّا قَلِيلًا) *"Nuk ju është dhënë dituri përveçse pak." (El-Isra: 85)*. Në përfytyrimin e besimtarit, burim i dijes është Allahu, prandaj thotë: (سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا)*"I pa të meta je Ti (o Zot)! Nuk dije përveç asaj që Ti na ke mësuar." (El-Bekare: 32)*. Kështu besimtari turret pas të vërtetave dhe jo pas dyshimeve, sepse (إِنَّ الظَّنَّ لَا يُغْنِي مِنَ الْحَقِّ شَيْئًا)*"Vërtet supozimi nuk është asgjë përball të vërtetës." (Junus: 36)*. Supozimi është rënie në errësirë, goditje ndaj të vërtetës dhe nënçmim i fisnikërisë së arsyes. Pastaj pason fjala e Allahut të Lartësuar ku nënvleftësohen popujt jobesimtarë që përdorin supozimin: (يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَمَا تَهْوَى الْأَنْفُسُ)*"Ndjekin vetëm supozimin dhe çfarë jua do ëndja." (En-Nexhm: 23)*

4. Pjesë e edukatës së hulumtimit shkencor është që njeriu të mos flasë asgjë pa dije. Allahu xh.sh. thotë: (فَلِمَ تُحَاجُّونَ فِيمَا لَيْسَ لَكُمْ بِهِ عِلْمٌ)*"Përse debatoni për atë që s'keni dituri?" (Alu Imran: 66)*; (وَلَا تَقْفُ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ إِنَّ السَّمْعَ وَالْبَصَرَ وَالْفُؤَادَ كُلُّ أُولَئِكَ كَانَ عَنْهُ مَسْؤُولًا)*"Mos u ndal në atë që s'ke dituri. Dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha këto janë përgjegjëse për të." (El-Isra: 36)*; (وَتَقُولُونَ بِأَفْوَاهِكُمْ مَا لَيْسَ لَكُمْ بِهِ عِلْمٌ وَتَحْسَبُونَهُ هَيِّنًا وَهُوَ عِنْدَ اللهِ عَظِيمٌ)*"Thoni me gjuhët tuaja atë që s'keni dituri, madje e mendoni diçka të vogël, por ajo te Allahu është e madhe." (En-Nur: 15)*; (وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يُجَادِلُ فِي اللهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ وَلَا هُدًى وَلَا كِتَابٍ مُنِيرٍ)*"Ka njerëz që debatojnë për Allahun pa dituri, pa udhëzim dhe pa libër të qartë." (El-Haxh: 8)*.

5. Allahu na tërheq vërejtjen për diturinë sipërfaqësore, e cila i mashtron të zotët e saj.[85] Allahu xh.sh. thotë: (يَعْلَمُونَ ظَاهِرًا مِنَ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَهُمْ عَنِ الْآخِرَةِ هُمْ غَافِلُونَ)*"E dinë pjesën e dukshme të kësaj bote, por ndaj Botës Tjetër janë të pavëmendshëm!" (Er-Rrum: 7)*. Kjo dituri sipërfaqësore është produkt i

[85] Tevfik Muhamed Seba': *Nufusun ve durusun*, Kajro, Mexhmeu 'l-Buhuthi 'l-Islamijjeh, gusht, 1971, vëllimi 1, f. 221.

egos, ku thuhet: (أَفَرَأَيْتَ مَنِ اتَّخَذَ إِلَهَهُ هَوَاهُ وَأَضَلَّهُ اللهُ عَلَى عِلْمٍ وَخَتَمَ عَلَى سَمْعِهِ وَقَلْبِهِ وَجَعَلَ عَلَى بَصَرِهِ غِشَاوَةً فَمَنْ يَهْدِيهِ مِنْ بَعْدِ اللهِ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ) *"A e pe atë që për zot e mori egon e vet?! Atë Allahu e humbi me dituri, ia vulosi dëgjimin dhe zemrën, dhe shikimit të tij i bëri një perde. E kush mund të udhëzojë pas Allahut?! A nuk kujtohen ata?!" (El-Xhathijeh: 23).*

Në këtë mënyrë metodologjia pedagogjike islame bëhet një sistem (*rend*) i përkryer. Ky sistem posedon besim që ka pikëpamje islame për Zotin, për kozmosin, për njeriun dhe për shoqërinë, ofron shkathtësi për përdorimin e teknikave të hulumtimit shkencore që janë të njohura te ekspertët e fushave, mbështetet në sistemin e vlerave etike islame dhe punon për implementimin e objektivave të sheriatit.

Përkushtimi ndaj kësaj metodologjie, sipas këtij koncepti, i shoqëruar me sjellje të mirë teorikisht dhe praktikisht, mund të na ndihmojë në masë të madhe t'i ndërtojmë fundamentet e pedagogjisë islame.

KREU I DYTË

Përbërësit themelorë të doktrinës islame

Hyrje

Shembulli i njeriut në këtë botë i ngjan personit, i cili ka zbritur në qytet pa pasur paraprakisht aspak dituri për të, por dëshiron të ecë, të njoftohet me veçoritë e tij dhe të jetojë aty. Pra, çfarë duhet të bëjë ai?

Ai duhet të gjejë një hartë të përgjithshme të qytetit për të mësuar vendet, për të projektuar lëvizjen e mëtutjeshme dhe për të përcaktuar orientimet. Aq sa harta të jetë e detajuar dhe e qartë, dhe aq sa njeriu ta kuptojë, ta lexojë drejt dhe t'i përmbahet asaj, po aq do të realizojë edhe synimin e mendimit, veprës dhe sjelljeve të tij në përgjithësi. Edhe për të kundërtën është njësoj.

Mirëpo, jeta nuk është thjesht "vende" dhe shenja, por edhe horizonte, sfera, ide, drejtime, orientime, vizione, sisteme, institucione, reaksione, imazhe, luftë, bashkëpunim, konkurrencë dhe shumë gjëra të tjera të kësaj bote. Këtu nuk nevojitet harta gjeografike, por ajo që quhet harta ideologjike, e cila i përcakton të gjitha pozitat e përgjithshme: pozitën e njeriut në këtë kozmos, realitetin e vetë kozmosit, drejtimin e marrëdhënieve mes njerëzve. Po ashtu, e definon synimin apo qëllimet e njërës dhe të tjetrës. Para së gjithash i përgjigjet pyetjes: kush qëndron pas krejt kësaj bote në të cilën jetojmë?

Tërësia e diskutimeve të këtij lloji dhe të ngjashme janë pikërisht ato të cilat shumica i quajnë "filozofi", apo të cilën për ta kuptuar më lehtë e ne e quajmë "hartë ideologjike". Disa të tjerë ndonjëherë e quajnë "ideologji", kurse disa shkrimtarë muslimanë e quajnë "përfytyrim islam".

Kjo tregon se njeriu ka shumë nevojë për një filozofi apo për një përfytyrim të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, në mënyrë që ta kuptojë domethënien e ekzistencës së tij në këtë botë. Cili është Krijuesi dhe fati i tij? Cila është rruga e duhur në jetën e kësaj bote dhe cila për jetën pas kësaj?

Qysh në lashtësi këto pyetje të përgjithshme e preokupojnë mendjen njerëzore. Nëse i meditojmë pyetjet e fëmijëve në vitet e para të jetës kur fillojnë të flasin dhe të mendojnë, atëherë do të shohim se i parashtrojnë këto pyetje, por në formën që u përshtatet viteve të tyre: nga ku kam ardhur? Kush më krijoi? Ku do të shkoj?[86]

Pavarësisht mijëra viteve që ka kaluar njerëzimi duke kërkuar që përmes mendimit të arrijë t'u japë përgjigje të kënaqshme dhe të qetësohet, por ende vazhdon të jetojë i hutuar dhe i pikëlluar, përveç atë që e ka mëshiruar Zoti. Kjo vazhdoi derisa i erdhi e vërteta bindëse përmes gjuhës së pejgamberëve të Zotit dhe përmes librave të Tij, mision që u përmbyll me shpalljen e fundit, gjegjësisht me fenë islame, e cila i siguroi njeriut themelet dhe elementët doktrinarë (besimore) për të formuar një vizion i cili do ta drejtojë atë në rrugën e drejtë.

Ky themel doktrinar (besimor), këto parime apo reflektime, të cilat i ndjek çdo fe apo drejtim sa i përket ekzistencës, kanë efekt të thellë dhe të fuqishëm në aspektet edukative të jetës. Supozojmë nëse një njeri mendon se jeta është vetëm materiale dhe nuk ka jetë tjetër pas kësaj, atëherë ai e ndërton sjelljen, mendimin, moralin dhe jetën e tij social mbi këtë parim. Drejtimet ateiste të cilat thonë se njeriu është i përbërë vetëm nga materia dhe se ai e jeton vetëm jetën e kësaj bote, mendojnë se njeriu është një shtazë prodhuese që ha, pi, punon dhe nuk ka pas kësaj asgjë. Përfy-

[86] Seid Ismail Ali: *El-Usulu 'l-felsefijjetu li 't-terbijjeh*, Kajro, Daru 'l-Fikri 'l-Arabijji, 2001, f. 56.

tyrimi i këtyre drejtimeve për njeriun, jetën dhe ekzistencën patjetër të sjellë rezultate praktike edukative. Për shembull, nëse u hedhim një vështrim banorëve të Indisë, do të shohim se ata janë jomuslimanë dhe shenjtërojnë disa lloje të kafshëve si majmunin dhe lopën, prandaj dhe nuk e therin lopën. Kjo sjell rezultate ekonomike të rëndësishme, sepse nuk janë vetëm qindra milionë njerëz që hanë dhe pinë në kontinentin indian, por ka edhe qindra milionë lopë që hanë dhe pinë pa u shfrytëzuar mishi i tyre sepse janë të shenjta. Pra, vështrimi ndaj ekzistencës në tërësi ndikon edhe në sistemin edukativ, politik, ekonomik dhe në vetë sjelljen etike.[87]

Këtu mund të pohojmë se shkenca pedagogjike nga vetë natyra çdoherë ka nevojë për një vështrim të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, mbi të cilin do të ndërtohet, do të projektohet, do të orientohet dhe do të ecë. Bile ka edhe filozofë jomuslimanë si p.sh. filozofi amerikan John Dewey, i cili thotë se edukata patjetër të ketë një filozofi dhe teori që do t'ia vizatojë drejtimin, do t'ia përcaktojë objektivat dhe do t'ia zgjedhë mjetet. Përndryshe procesi edukativ do të shndërrohet në një veprimtari spontane të padobishme.[88]

Nga kjo kuptojmë se ndërtimi i pedagogjisë islame patjetër duhet që në fillim t'u drejtohet elementëve themelorë të doktrinës islame dhe vështrimit të tyre ndaj këtyre tërësive themelore, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të orientohet në rrugën e duhur dhe të qëndrueshme. Kjo qasje do t'i vlejë për mirë edukatorit dhe atij që edukohet, por për këtë do ta trajtojmë në pjesën vijuese...

[87] Po aty, f. 65.

[88] John Dewey: *Ed-Dimukratijjetu ve 't-terbijjetu*, përkthim i Mina Akravit dhe Zekiria Mihailit, Kajro, Lexhnetu 't-Te'lifi ve 't-Terxhemeti ve 'n-Neshri, 1954, 340.

E para: Allahu

Vërtet, besimi në zot është koka e të gjitha doktrinave fetare. Kush e njeh besimin që një popull ka për zotin, e ka njohur një pjesë të konsiderueshme të të kuptuarit dhe të ndërgjegjes së tyre. Po ashtu, ka mësuar matësin e drejtë me të cilin ai popull e mat të keqen dhe të mirën, dhe me të cilin i vlerëson punët e mira dhe të këqija. Në këtë frymë, nuk mund të bie vlera e fesë përderisa besimi në Zot është i lartë, e as mund të lartësohet një fe që besimin në Zot e ka të zbehët. Pra, nuk përshtatet me vetitë e ekzistencës së parë të cilën e ndjekin të gjitha ekzistencat tjera.[89]

Vështrimi në cilësitë e Zotit ishte një arenë konkurrence mes shumë kokave të filozofisë ideologjike dhe urtarëve të fesë. Detyra e filozofëve ishte më e kollajshme se detyra e urtarëve të fesë, sepse filozofi teorik nis nga pikëpamja e mendimit dhe vlerësimit të tij, i cili nuk lidhet me detyrimet e adhurimit dhe as me marrëdhëniet ndërnjerëzore, siç është i kufizuar urtari i fesë. Dihet se të gjithë ata që i besojnë dhe i ndjekin (këto detyrime) në jetën e përgjithshme dhe në atë individuale janë të kufizuar. Në mesin e filozofëve teorikë kishte shumë që për shkak të qëndrimit konstruktiv për Zotin u ngritën aty ku s'e imagjinon dhe atë falë mendimit dhe ndjesisë së tyre.

Është e vërtetë se kishte të tillë që e dëgjonin zërin e fitres (intuitës natyrore), i cili u pështpëriste se është e logjikshme dhe e arsyeshme që pas gjithë këtij universi të ketë një Krijues. Kjo shpaloset në tregimin e Ibrahimit a.s., i cili mendoi për Shpikësin e ekzistencës dhe për Drejtuesin e qiejve dhe të tokës. Shikoi një yll dhe e besoi për zot. Kur perëndoi, u bind se ky zot nuk është Allahu, sepse për-

[89] Abbas Mahmud Akkad: *Hakaiku 'l-Islami ve ebatilu husumihi*, Kajro, Daru 'l-Hilal, Silsisletu Kitabi 'l-Hilali (169), prill, 1965, f. 36.

ndryshe nuk duhej të perëndojë. Të njëjtën logjikë e aplikoi për hënën dhe pastaj për diellin, derisa arriti te Krijuesi i Madhërishëm:

(وَكَذَٰلِكَ نُرِيٓ إِبۡرَٰهِيمَ مَلَكُوتَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِ وَلِيَكُونَ مِنَ ٱلۡمُوقِنِينَ ٧٥ فَلَمَّا جَنَّ عَلَيۡهِ ٱلَّيۡلُ رَءَا كَوۡكَبٗاۖ قَالَ هَٰذَا رَبِّيۖ فَلَمَّآ أَفَلَ قَالَ لَآ أُحِبُّ ٱلۡأٓفِلِينَ ٧٦ فَلَمَّا رَءَا ٱلۡقَمَرَ بَازِغٗا قَالَ هَٰذَا رَبِّيۖ فَلَمَّآ أَفَلَ قَالَ لَئِن لَّمۡ يَهۡدِنِي رَبِّي لَأَكُونَنَّ مِنَ ٱلۡقَوۡمِ ٱلضَّآلِّينَ ٧٧ فَلَمَّا رَءَا ٱلشَّمۡسَ بَازِغَةٗ قَالَ هَٰذَا رَبِّي هَٰذَآ أَكۡبَرُۖ فَلَمَّآ أَفَلَتۡ قَالَ يَٰقَوۡمِ إِنِّي بَرِيٓءٞ مِّمَّا تُشۡرِكُونَ ٧٨ إِنِّي وَجَّهۡتُ وَجۡهِيَ لِلَّذِي فَطَرَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضَ حَنِيفٗاۖ وَمَآ أَنَا۠ مِنَ ٱلۡمُشۡرِكِينَ)

"E kështu Ibrahimit ia mundësuam t'i shohë madhësitë e qiejve e të tokës për t'u bërë edhe më i bindur. E kur atë e mbuloi nata, ai e pa një yll e tha: "Ky është Zoti im!" E kur u zhduk ai (perëndoi) tha:" Unë nuk i dua ata që humben". Kur e pa hënën të posalindur tha: "Ky është Zoti im!" e kur perëndoi ajo, tha: "Nëse Zoti im nuk më udhëzon, unë do të jem prej njerëzve të humbur!" Kur e pa diellin të lindur, tha: "Ky është Zoti im, ky është i madh!" e kur ai perëndoi, tha: "O populli im, unë jam i pastër nga ajo që ju i shoqëroni!" Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt e tokën, larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë shok!" (El-En'am: 75-79)

Me këtë rast mund ta theksojmë tregimin e njohur të arabit analfabet dhe të thjeshtë, të cilin vetë natyra e tij e pastër e kishte udhëzuar në të vërtetën. Një ditë dikush e pyeti: si e njohe ekzistencën e Zotit? U përgjigj: "I Lartësuar është Allahu! Bajga e devesë tregon për devenë, gjurma tregon rrugën, kurse qielli me yje dhe toka plotë brigje, a nuk tregojnë këto ekzistencën e të Gjithëdijshmit?!"

Ky beduin arriti që ta kuptojë këtë realitet përmes natyrës së tij të pastër dhe përmes arsyes së thjeshtë dhe të pa turbulluar me mendime të helmuara, kurse për të njëjtën, filozofët dhe mendimtarët derdhën shumë mund. Kuptuan se çdo pasojë duhet të ketë shkakun e vet. Aq sa është e madhe pasoja, aq është madhështor edhe shkaku, prandaj

patjetër Krijuesi i çdo ekzistence të jetë i Gjithëfuqishëm dhe të ketë forcë absolute.[90]

Megjithatë, Islami mbështetet në faktin që ngarkimi i njeriut me besim në Zotin të bëhet mbi bazën e logjikës dhe të bindjes, të respektohet arsyeja dhe mendimi për qenësinë e njeriut. Mënyra se si Islami i paraqet provat e ekzistimit të Zotit, Krijuesit, është shumë e thjeshtë dhe e lehtë. Gjërat e zakonshme të jetës njerëzore dhe gjithçka sheh syri i ka bërë çështje të mëdha kozmike, përmes së cilave arsyeja zbulon atë që e qetëson dhe e bind në ekzistencën e Krijuesit të Lartësuar.[91]

Kur'ani Fisnik, Libri islam, është i mbushur përplot me argumente dhe prova të llojllojshme. Mjafton këtu t'i përmendim këto ajete:

نَحْنُ خَلَقْنَاكُمْ فَلَوْلَا تُصَدِّقُونَ (٥٧) أَفَرَأَيْتُم مَّا تُمْنُونَ (٥٨) أَأَنتُمْ تَخْلُقُونَهُ أَمْ نَحْنُ الْخَالِقُونَ (٥٩) نَحْنُ قَدَّرْنَا بَيْنَكُمُ الْمَوْتَ وَمَا نَحْنُ بِمَسْبُوقِينَ (٦٠) عَلَىٰ أَن نُّبَدِّلَ أَمْثَالَكُمْ وَنُنشِئَكُمْ فِي مَا لَا تَعْلَمُونَ (٦١) وَلَقَدْ عَلِمْتُمُ النَّشْأَةَ الْأُولَىٰ فَلَوْلَا تَذَكَّرُونَ (٦٢) أَفَرَأَيْتُم مَّا تَحْرُثُونَ (٦٣) أَأَنتُمْ تَزْرَعُونَهُ أَمْ نَحْنُ الزَّارِعُونَ (٦٤) لَوْ نَشَاءُ لَجَعَلْنَاهُ حُطَامًا فَظَلْتُمْ تَفَكَّهُونَ (٦٥) إِنَّا لَمُغْرَمُونَ (٦٦) بَلْ نَحْنُ مَحْرُومُونَ (٦٧) أَفَرَأَيْتُمُ الْمَاءَ الَّذِي تَشْرَبُونَ (٦٨) أَأَنتُمْ أَنزَلْتُمُوهُ مِنَ الْمُزْنِ أَمْ نَحْنُ الْمُنزِلُونَ (٦٩) لَوْ نَشَاءُ جَعَلْنَاهُ أُجَاجًا فَلَوْلَا تَشْكُرُونَ (٧٠) أَفَرَأَيْتُمُ النَّارَ الَّتِي تُورُونَ (٧١) أَأَنتُمْ أَنشَأْتُمْ شَجَرَتَهَا أَمْ نَحْنُ الْمُنشِئُونَ (٧٢) نَحْنُ جَعَلْنَاهَا تَذْكِرَةً وَمَتَاعًا لِّلْمُقْوِينَ (٧٣) فَسَبِّحْ بِاسْمِ رَبِّكَ الْعَظِيمِ (٧٤)

"Ne ju krijuam, përse nuk pohoni? E vini re çfarë hidhni?[92] *Ju e krijuat apo Ne krijojmë? Ne e përcaktojmë mes jush vdekjen, askush s'mund të Na parakalojë. Që ta zëvendësojmë shembullin tuaj dhe t'ju krijojmë në një gjendje për të cilën s'keni dijeni. Ju dini krijimin e parë,*[93] *përse nuk mendoni? E vini re atë që mbillni? Ju e rrisni apo Ne rrisim? Po të kishim dashur, e bënim pluhur e hi dhe të thoshit të hutuar: "Humbëm! Ngelëm pa gjë!"*

[90] Ahmed Rexheb El-Esmer: *Felsefetu 't-terbijjeti 'l-islamijjeh*, Aman, Daru 'l-Furkan, 1997, f. 95.
[91] Hasen Sa'b: *El-Islamu ve 'l-insan*, Bejrut, Daru 'l-Ilmi li 'l-Melajini, 1981, f. 53.
[92] Farën e riprodhimit.
[93] Si erdhët në këtë botë.

E vini re ujin që pini? Ju e zbritët nga retë apo Ne e bëjmë të zbresë? Po të kishim dashur, e bënim të hidhët. Përse nuk falënderoni? E vini re zjarrin që ndizni? Ju e krijuat lëndën e tij apo Ne krijojmë? E bëmë atë një kujtesë dhe mjet për ata që udhëtojnë. Pra, thuri lavde Emrit të tët Zoti, të Madhit!" (El-Vakia: 57-74)

Me këtë logjikë bindëse dhe të lehtë, Kur'ani iu drejtua arsyes dhe mendimit njerëzor, pra, me një stil të mrekullueshëm ku gjen hapësirë veprimi arsyeja e thjeshtë dhe mendimi filozofik në të njëjtën kohë. Pastaj mendimi shkencor gjen në terren pjellor dhe një pikënisje për te besimi i ngulitur dhe i drejtë.[94]

Ibn Rushdi pohon se mënyra më e mirë për të vërtetuar se bota ekziston falë Allahut të Lartësuar është vetë mënyra që e spikat Kur'ani Fisnik, ku i thërret të gjithë. Nëse e hulumtojmë krejt Kur'anin, do të shohim se kjo mënyrë është dy lloje:[95]

Lloji i parë: ndalja në kujdesin e treguar ndaj njeriut, ku çdo krijesë është dhënë për shkakun e tij. Kjo provë njihet si prova e përkujdesjes.

Lloji i dytë: mënyra që shfaqet nga shpikja (apo krijimi) e esencave të gjërave ekzistuese, si p.sh. krijimi i jetës në tokë, krijimi i perceptimeve ndijore dhe i arsyes. Kjo quhet prova e shpikjes dhe e krijimit.

Kur e sjellim provën e parë, shohim se ngrihet mbi dy fundamente: i pari është se bota me gjithë pjesët e saj është në përputhshmëritë plotë me ekzistencën e njeriut dhe me të gjitha ekzistencat tjera që gjenden aty, kurse fundamenti i dytë është se krejt çfarë ekziston është në përputhshmëri me arsyen, janë të orientuara drejt një synimi të vetëm. Pra, kjo tregon se bota "është e krijuar" domosdoshmërisht dhe

[94] Jusuf Abdulhadi Esh-Shejal: *El-Islamu ve binau 'l-muxhtemei 'l-fadili*: Kajro, Mexhmeu 'l-Buhuthi 'l-Islamijjeh, Silsiletu 'l-buhuthi 'l-islamijjeh (60), dhjetor, 1972, f. 27.

[95] Muhamed Jusuf Musa: *Ed-Dinu ve 'l-felsefetu*, Kajro, Daru 'l-Mearifi, 1959, f. 147.

se nga këto dy fundamente del fakti se bota është e krijuar dhe se ka Një Krijues.

Këtë të vërtetë e shprehin ajetet kur'anore në vijim:

أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهَادًا (٦) وَالْجِبَالَ أَوْتَادًا (٧) وَخَلَقْنَاكُمْ أَزْوَاجًا (٨) وَجَعَلْنَا نَوْمَكُمْ سُبَاتًا (٩) وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ لِبَاسًا (١٠) وَجَعَلْنَا النَّهَارَ مَعَاشًا (١١) وَبَنَيْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعًا شِدَادًا (١٢) وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَّاجًا (١٣) وَأَنزَلْنَا مِنَ الْمُعْصِرَاتِ مَاءً ثَجَّاجًا (١٤) لِّنُخْرِجَ بِهِ حَبًّا وَنَبَاتًا (١٥) وَجَنَّاتٍ أَلْفَافًا (١٦)

"Tokën shtrat a nuk e bëmë? Edhe malet direkë? Ju krijuam në palë. Gjumin pushim jua bëmë, natën mbulesë edhe ditën jetesë. Ngritëm mbi ju shtresa shtatë;[96] bëmë një pishtar të zjarrtë. Ulëm nga shimbartëset ujë-rrjedhë, nxjerrim me të drithëra e bimë dhe kopshte të begatë." (En-Nebe': 6-16)

Nëse njeriu i mediton këto ajete, atëherë do të gjejë një përputhshmëri të plotë të pjesëve të botës me ekzistencën e vetë njeriu. Prandaj, Allahu i Lartësuar ka filluar dhe ka spikatur një çështje të njohur për mbarë njerëzimin, se toka është krijuar në atë gjendje që ne të mund të jetojmë në të. Nëse do të ishte krijuar me përmasa dhe kushte tjera, atëherë nuk do të mund të jetonim aty. Krejt kjo është thënë në fjalën e të Lartësuarit (أَلَمْ نَجْعَلِ الْأَرْضَ مِهَادًا)*"A nuk e bëmë Tokën shtrat?!" (En-Nebe': 6)*. Fjala *mihad* (shtrat) përfshin kuptimin e përshtatjes në formë, në qetësi dhe në situatë. Po ashtu, kësaj mund t'i shtohet edhe kuptimi i butësisë.[97]

Pastaj, përmes fjalës (وَالْجِبَالَ أَوْتَادًا)*"dhe malet shtylla" (En-Nebe': 7)*, Allahu ka spikatur dobitë ekzistuese nga qetësia e Tokës, e cila vjen si rezultat i maleve. Nëse do të ishin më të vogla, seç janë atëherë ajo do të lëkundej nga lëvizjen e ujit dhe të ajrit. Kështu do të bëheshin tërmete, toka do të dilte nga boshti i vet dhe do të shkatërrohej çdo gjallesë mbi të. Pra, përshtatshmëria e qetësisë me ekzistencat e saj nuk

[96] Shtatë qiejtë.
[97] Po aty, f. 148.

është krejt një rastësi, por është synim i qëllimshëm i Vullneti absolut. Ky synim është i realizuar domosdoshmërish nga Vullneti Absolut, nga Allahu i Madhërishëm, dhe është me masë të caktuar.

Pas kësaj vijnë këto fjalë të Allahut të Lartësuar: (وَجَعَلْنَا اللَّيْلَ لِبَاسًا وَجَعَلْنَا النَّهَارَ مَعَاشًا) *"E bëmë natën mbulesë dhe ditën jetesë." (En-Nebe': 10-11)*. Këto fjalë prekin përputhshmërinë e natës me ditën për të gjitha gjallesat dhe bimët, pra, nata i mbron nga nxehtësia e diellit njësoj si teshat që e mbulojnë dhe mbrojnë trupin nga nxehtësia. Megjithatë, nata jep jetë duke siguruar gjumin, prandaj thotë (وَجَعَلْنَا نَوْمَكُمْ سُبَاتًا) *"Gjumin jua bëmë pushim!"*, pra, njeriu fle gjumë të thellë si pasojë e asaj errësire të natës.

Pastaj thotë (وَبَنَيْنَا فَوْقَكُمْ سَبْعًا شِدَادًا) *"Ngritëm mbi ju shtatë (shtresa) të fuqishme"*. Ato janë qiej të cilat cilësohen me ndërtim për shkak të krijimit dhe madhështisë. Po ashtu, thuhet se janë ngritur, sepse kanë sistem, harmoni dhe përshtatje me atë për të cilin janë krijuar. Është theksuar fjala "të fuqishme", sepse Allahu u ka dhënë atyre fuqi që vazhdimisht të lëvizin, prandaj dhe nuk ekziston frika e rrënimit të kulmit të tyre. Krejt kjo është vëmendje nga Krijuesi për përshtatjen e qiejve me orbitat dhe me gjithçka që ka në to: krijimi, format, gjendjet dhe lëvizjet. Po ashtu, tregon për krijesat mbi tokë dhe rreth tij, saqë nëse ky sistem ndalon, atëherë shkatërrohet gjithçka në qiej dhe në tokë.[98]

Më pastaj, përmes fjalës (وَجَعَلْنَا سِرَاجًا وَهَّاجًا) *"Dhe bëmë një pishtar të zjarrtë"*, spikat dobinë e diellit dhe përshtatjen e tij me gjithçka ekziston në tokë. Po të mos ishte drita e tij, nuk do të bënte pa të asnjë njeri dhe as një gjallesë. E ka theksuar këtë dobi të diellit, sepse ajo është më e dobishmja dhe më e dukshmja.

[98] Po aty, f. 149.

Në fund, përmes ajeteve (وَأَنْزَلْنَا مِنَ الْمُعْصِرَاتِ مَاءً ثَجَّاجًا لِنُخْرِجَ بِهِ حَبًّا وَنَبَاتًا وَجَنَّاتٍ أَلْفَافًا) *"Ullëm nga shimbartëset ujë-rrjedhë, nxjerrim me të drithëra e bimë, dhe kopshte të begatë"*, shpaloset urtësia e Krijuesit, kujdesi për lëshimin e shiut, ku Ai lëshon shi dhe mbinë bimë aty ku ka gjallesa. Shiu lëshohet me sasi të caktuar dhe në vend të caktuar, jo rastësisht, por si pasojë e kujdesit hyjnor për tokën.

Kurse sa i takon provës së shpikjes (*apo të krijimit*), ai ngrihet mbi bazën se çdo gjë: qiejt, toka, gjallesat dhe bimët, janë të krijuara. Kjo shihet nga vrojtimi me vëmendje i krejt këtyre, nga lëvizja e qiejve dhe të tokës të cilat na janë nënshtruar. Pra, të gjitha gjërat janë krijuar, sepse përderisa kemi krijim, atëherë kemi edhe Krijues.[99]

Përderisa Allahu na urdhëron të themi: (قُلْ هُوَ اللهُ أَحَدٌ ، اللهُ الصَّمَدُ ، لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ، وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَد) "Thuaj: *"Allahu është Një, Allahu është i Amshuar. Nuk ka lind, as është i lindur dhe nuk ka të krahasuar."*, atëherë ne nuk duhet të adhurojmë dikë tjetër, përveç Tij, të mos i frikësohemi askujt pos Tij dhe ta ndërtojmë formimin tonë sipas rrugës të cilën ai e ka vizatuar në Kur'anin Fisnik dhe në Traditën Pejgamberike.

Kjo tregon njohjen e Zotit si të Vetëm në adhurim dhe besimin se Allahu është Zoti i Vetëm i botëve, prandaj tevhidi (*unikaliteti*) është dy lloje: tevhidi uluhije (*unikaliteti në adhurim*) dhe tevhidi rububijjeh (*unikaliteti në zotërim e sundim*).[100]

Tevhidi uluhijeh (njëshmëria në adhurim) është detyra me të cilën Allahu i ka dërguar të gjithë pejgamberët. Allahu i Madhërishëm thotë:

(وَمَا أَرْسَلْنَا مِن قَبْلِكَ مِن رَّسُولٍ إِلَّا نُوحِي إِلَيْهِ أَنَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدُونِ)

[99] Po ashtu, f. 152.
[100] Abdulkerim Zejdan: *Usulu 'd-da'veti*, Aman, Mektebetu 'l-Beshairi, 1988, f. 18.

"Nuk dërguam para teje ndonjë pejgamber pa i kumtuar se s'ka Zot tjetër veç Meje, pra, Mua më adhuroni!" (*El-Enbija: 25*)

(وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ فَقَالَ يَا قَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُم مِّنْ إِلَٰهٍ غَيْرُهُۥٓ أَفَلَا تَتَّقُونَ)

"Dërguam Nuhin te populli i tij dhe tha: "Populli im, adhuroni Allahun! S'keni veç Tij tjetër Zot. A nuk përmbaheni?" (*El-Mu'minune: 23*)

(وَإِلَىٰ عَادٍ أَخَاهُمْ هُودًاۗ قَالَ يَا قَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُم مِّنْ إِلَٰهٍ غَيْرُهُۥٓ أَفَلَا تَتَّقُونَ)

"Te Adi, dërguam të vëllanë, Hudin. Tha: "Populli im, adhuroni Allahun! S'keni Zot tjetër veç Tij. A nuk përmbaheni?" (El-A'raf: 65)

Tevhidi rububijeh (njëshmëria e zotërimit apo sundimit) do të thotë se Allahu është Zoti real i botëve dhe se nuk ka zot tjetër pos Tij. Ai është Krijuesi, Jetëdhënësi, Jetëmarrësi dhe Zbatuesi i të gjitha urdhrave dhe vendimeve të Tij te krijesat. Në dorë të Tij është çdo gjë, prandaj sillet në kozmos si të dojë, pa e sfiduar askush gjykimin e Tij. Ai i realizon të gjitha punë e krijesave dhe mbikëqyr gjithçka është në dobi të tyre. Mund t'i sjell dobi apo dëm kujtdo. Kur dikujt do t'i bëjë mirë, s'ka kush e kthen, por edhe nëse do ndryshe për dikë tjetër, s'mund ta ndalojë askush.[101] Allahu i Lartësuar thotë:

(وَإِن يَمْسَسْكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَۖ وَإِن يُرِدْكَ بِخَيْرٍ فَلَا رَادَّ لِفَضْلِهِۦۚ يُصِيبُ بِهِ مَن يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِۦۚ وَهُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ)

"Nëse Allahu të prek me një dhimbje, askush veç Tij s'mund ta largojë. Në ta do të mirën, nuk kthehet pas mirësia e Tij. Ia arrin atij që do ndër robtë e Vet. Ai është Falësi, Mëshirëploti." (*El-En'am: 17*) Allahu i Lartësuar është unik në dhënie dhe në privim, në shkaktimin e dëmit dhe të dobisë, ndërsa të gjithë të tjerët përveç Allahu janë fukarenj dhe nevojtarë për Të: "O ju, njerëz! Ju jeni fukarenj kundrejt Allahut", pra, varfëria është cilësim organik i çdo krijese, siç është kamja cilësim qenësor i Allahut, Zotit të botëve.

[101] Po aty, f. 200.

Këtu lind detyrimi për të pasur dashuri të sinqertë ndaj Allahut të Madhërishëm dhe për të mos i përshkruar ortak Atij në dashuri, siç i do Ai robërit. Kush vepron ndryshe, bëhet politeist:

(وَمِنَ النَّاسِ مَن يَتَّخِذُ مِن دُونِ اللَّهِ أَندَادًا يُحِبُّونَهُمْ كَحُبِّ اللَّهِ ۖ وَالَّذِينَ آمَنُوا أَشَدُّ حُبًّا لِّلَّهِ ۗ وَلَوْ يَرَى الَّذِينَ ظَلَمُوا إِذْ يَرَوْنَ الْعَذَابَ أَنَّ الْقُوَّةَ لِلَّهِ جَمِيعًا وَأَنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعَذَابِ)

"Ka njerëz, cilët i bëjnë Allahut ortakë, i duan këta me dashurinë e Allahut, ndërsa besimtarët kanë më të fuqishmen dashuri për Allahun. Po të vërenin dhunuesit kur të përballen me dënimin, tërë fuqia është e Allahut. Allahu ka ndëshkim të rreptë." (*El-Bekare: 165*) Politeizëm (*shirk*) i madh, të cilin Allahu e fal vetëm me pendim, është që robi t'i përshkruan Allahut ortak në dashuri, siç e do Allahun e Lartësuar. Përderisa njeriu në vetë natyrën e tij e ka të ngulitur dashurinë ndaj vetvetes, prindërve, fëmijëve, vatanit dhe pasurisë, nuk do të thotë se adhurimi me sinqeritet ndaj Allahut i rrëzon këto tendenca të qenësishme. Përkundër kësaj, nga besimtari kërkohet që të ketë dashuri ndaj çdo gjësë në dynja pas dashurisë ndaj Allahut të Madhërishëm. Dashuria ndaj Allahut duhet qenë para së gjithash te robi. Pra, duhet të sakrifikojë çdo vlerë në këmbim të kësaj dashurie nëse e kërkon kjo bie ndesh me diçka tjetër. Allahu i kërcënon ata që u japin përparësi këtyre vlerave të përbotshme ndaj dashurisë, ndaj Allahut dhe ndaj Pejgamberit a.s.. Allahu i Patëmetë thotë:

(قُلْ إِن كَانَ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ وَإِخْوَانُكُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ وَأَمْوَالٌ اقْتَرَفْتُمُوهَا وَتِجَارَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَاكِنُ تَرْضَوْنَهَا أَحَبَّ إِلَيْكُم مِّنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَجِهَادٍ فِي سَبِيلِهِ فَتَرَبَّصُوا حَتَّىٰ يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ)

"Thuaj: "Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria e fituar, tregtia së cilës i frikësoheni në humbje dhe trojet që ju pëlqeni, janë më të dashura se Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në Rrugën e Tij, pritni sa

Allahu të bëjë urdhër." Allahu nuk i drejton njerëzit e pabindur." (*Et-Tevbe: 24*)

Tevhidi (*njëshmëria*) kërkon disa çështje:[102]

1. Domosdoshmërish të njihet Allahu si i Vetëm në lutje dhe në mbështetje, dhe se askush nuk duhet vlerësuar mbi Atë.

Allahu xh.sh. thotë:

(وَلَا تَدْعُ مِنْ دُونِ اللهِ مَا لَا يَنْفَعُكَ وَلَا يَضُرُّكَ فَإِنْ فَعَلْتَ فَإِنَّكَ إِذًا مِنَ الظَّالِمِينَ)

"Mos lut, veç Allahut, ç'nuk të sjell dobi e dëm. Përndryshe do të ishe ndër dhunuesit." (*Junus: 106*)

(وَعَلَى اللهِ فَتَوَكَّلُوا إِنْ كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ)

"Vetëm Allahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë!" (*El-Maide: 23*)

(إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَالَّذِينَ هَاجَرُوا وَجَاهَدُوا فِي سَبِيلِ اللَّهِ أُولَٰئِكَ يَرْجُونَ رَحْمَتَ اللَّهِ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ)

"Ata që besojnë, emigrojnë dhe luftojnë në Rrugën e Allahut, shpresojnë në mëshirën e Allahut. Allahu është Falës, Mëshirëplotë." (*El-Bekare: 218*)

2. Domosdoshmërish të kihet frikë vetëm prej Allahut. Kush beson se disa krijesa mund ta dëmtojnë me dëshirën e vet dhe ka frikë prej tyre, atëherë ka devijuar nga rruga e besimit të vërtetë. Allahu xh.sh. thotë: (فَإِيَّايَ فَارْهَبُونِ) *"Vetëm Mua më keni frikë!"* (*En-Nahlu: 51*)

(وَإِن يَمْسَسْكَ اللَّهُ بِضُرٍّ فَلَا كَاشِفَ لَهُ إِلَّا هُوَ ۖ وَإِن يُرِدْكَ بِخَيْرٍ فَلَا رَادَّ لِفَضْلِهِ ۚ يُصِيبُ بِهِ مَن يَشَاءُ مِنْ عِبَادِهِ ۚ وَهُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ)

"Nëse Allahu të prek me një dhimbje, askush veç Tij s'mund ta largojë. Në ta do të mirën, nuk kthehet pas mirësia e Tij. Ia arrin atij që do ndër robtë e Vet. Ai është Falësi, Mëshirëploti." (Junus: 107)

3. Domosdoshmërish të veçohet Allahu me të gjitha llojet e adhurimeve trupore, si p.sh. namazi, rukuja, sexhdeja, agjërimi, kurbani, rrotullimi rreth Qabesë; me të

[102] Muhamed Neim Jasin: El-Imanu, erkanuhu, hakikatuhu, nevakiduhu, Aman, Xhemijjetu Ummali 'l-Metabii 't-Teavunijjeh, 1979, botimi II, f. 13.

gjitha adhurimet shprehëse, si p.sh. betimi, istigfari (kërkimi falje) etj.[103]

Kur'ani Fisnik është i mbushur plot me ajete ku ua prezanton Allahun robërve, duke u hequr nga mendja atyre çdo lajthitje dhe devijim, dhe duke pranuar Atë ashtu siç i takon. Allahu xh.sh. thotë:

(اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ ۚ لَّهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ مَن ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِندَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ۚ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ ۖ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ ۚ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ ۖ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۚ وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ)

"Allahu, s'ka zot veç Tij, është i Gjalli, i Përjetshmi. Nuk e kap kotje e gjumë. Të Tijat janë ç'ka në qiej e në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë te Ai pa lejen e Tij? Di të tashmen dhe të ardhmen e tyre, ndërsa ata nuk mund të nxënë nga Dija e Tij, vetëm aq sa Ai dëshiron. Pushteti i Tij shtrihet në qiej e në tokë dhe nuk e bezdis ruajtja e tyre. Ai është i Larti, Madhështori." (*El-Bekare: 255*)

Ky ajet në mesin e muslimanëve njihet si "ajeti kursij", për vlerën dhe pozitën e së cilit është prononcuar vetë suneti pejgamberik. Ky ajet përbëhet nga dhjetë fjali të lidhura kuptimisht, të cilat flasin për Allahun dhe për cilësitë e Tij. Imam Gazaliu e analizon kështu këtë ajet:[104]

1. (اللهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ...) "*Allahu, s'ka zot tjetër pos Tij...*" do të thotë se nuk ekziston askush që mund ta kalojë pragun e adhurimit pos Tij. Çdo gjë është rob i Allahut, kur Ai është unik në hyjni në qiej dhe në tokë, siç e sqaruam më parë.

2. (الْحَيُّ الْقَيُّومُ) "*I Gjalli, i Përjetshmi*". Të gjitha krijesave të gjalla nuk u buron jeta domosdoshmërish nga vetvetja, por jeta është dhuratë nga jashtë, e cila një ditë do t'i merret dhe nuk do t'i kthehet pa vullnetin e Dhuruesit. "El-Hajju" është i Gjalli pa fillim dhe pa mbarim. Jeta për Të është një veti e domosdoshme, eternale dhe e pambarueshme. Ky është dallimi mes Krijuesit dhe krijesave. Pas kësaj jete të përsh-

[103] Po aty, f. 14.

[104] Muhamed El-Gazaliu: *El-Xhanibu 'l-atifijju mine 'l-Islami,* Kajro, Daru 'd-Da'veti, 1990, f. 28.

kruar shkon të pasojë cilësia "El-Kajjum", i Cili mbulon universet, krijesat dhe çdo lëvizje apo heshtje të tyre. Allahu mbikëqyr gjithçka dhe i menaxhon punët e çdo gjësë. Çdo gjë ka nevojë për Atë, kurse Ai s'ka nevojë për askënd.[105]

3. (لَا تَأْخُذُهُ سِنَةٌ وَلَا نَوْمٌ) "*Nuk e kap kotje dhe as gjumë.*" Këtu bëhet fjalë për kotje (përgjumje) dhe për gjumë të plotë. Kjo do të thotë se ne njerëzve kohë pas kohe na humb vetëdija dhe humbim kontrollin e vetvetes, bile edhe zgjuar kur jemi, efikasiteti mendor yni është i ndryshëm për atë që mendojmë dhe për atë që na rrethon. Kur lodhemi, vëmendja jonë dobësohet, elani bie dhe gabimet shtohen, kurse Allahun nuk e lodh asgjë, nuk i ik as imtësia më e vogël në qiell dhe në tokë, nuk e prek lodhja dhe plogështia, dhe përkushtimi i vetëdijshëm i Tij për çdo imtësi është i përsosur. Nuk ka harresë dhe as përgjumje.[106]

4. (لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ...) "*Atij i takon ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë*" Allahu është Pronar i gjithanshëm. Nuk themi se pronësi e Tij janë horizontet e qiejve dhe të tokës, por mbarë bota fund e krye është pronë e Tij.

5. (مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ) "*E kush mund të ndërmjetësojë tek Ai përpos me lejen e Tij*". Një parim islam thotë se ndërmjetësim nuk ka për politeistin dhe për ateistin. Asnjë melaqe apo i dërguar nuk ka të drejtë të thotë "O Zot, fale filanin" apo "Lëre, mos e dëno filanin!", sepse parimi i parë i shpëtimit është besimi dhe puna e mirë.[107]

6. (يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ) "*Di të tashmen dhe të ardhmen e tyre.*" Allahut nuk i fshihet asgjë në tokë dhe në qiell. E djeshmja, e sotmja dhe e ardhmja tek Ai janë njësoj qysh kur i ka krijuar dhe deri kur do të bëhen njësh. Për Të është i afërmi dhe i largëti, apo i pari dhe i fundit, sepse Krijuesi

[105] Po aty, f. 29.
[106] Po aty, f. 30.
[107] Po aty, f. 31.

di se çfarë ka krijuar, madje askush nuk mund të imagjinojë diçka për të ardhmen pa e ditur mirë atë Allahu.[108] Krijimi apo shpikja janë shumë më shumë sesa shkenca, prandaj atë s'mund ta bëjë askush përpos Allahut. Po ashtu, transformimet që ndodhin në materie, të cilat janë bosht i veprave njerëzore, bëhen vetëm me përcaktim të Allahut, por kjo njohje (caktim) është paradije (dhe jo përcaktim i detyrueshëm).

7. (وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ) "*Ata nuk mund të kapin nga dija e Tij, përveç asaj që do Ai.*" Burime e diturisë shpërthejnë duke filluar me vullnetin e Krijuesit, madje edhe dituria që arrihet me dëgjim dhe me shikim. Nëse nuk do ta pajiste njeriun me arsye perceptuese,[109] nuk do të mund të kuptonte asgjë që e rrethon dhe nuk do të mund t'u qasej gjërave më të thella se kjo, të cilat përbëjnë nivelet e inteligjencës njerëzore. Kjo inteligjencë na është dhënë me sasi të caktuar qysh në barkun e nënës.

8. (وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ) "*Pushteti i Tij shtrihet në qiej dhe në tokë.*" Dikush mund të mendojë se pushteti i Allahut shtrihet vetëm në qiej dhe në tokë.[110] Kjo është gabim, sepse këto janë vetëm disa shenja të fuqisë së lartësuar të tij. Ne realisht nuk e dimë se çfarë është "kursij". Krejt çfarë dimë për këtë fjalë është ajo që na është treguar nga Vetë Zoti Fuqiplotë për mbarë krijesat, qofshin ato që i shohim apo që nuk i shohim.

9. (وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا) "*dhe nuk e bezdis ruajtja e tyre*". Nuk ndjen asnjë mundim për t'i ruajtur dhe për t'i menaxhuar me perfeksion gjithçka në qiej dhe në tokë. Po ashtu, Ai nuk ndjen asnjë lloj mundimi për krijimin e parë.[111]

[108] Po aty, f. 32.
[109] Po aty, f. 33.
[110] Po aty, f. 34.
[111] Po aty, f. 35.

10. (وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ) "*Ai është i Larti, Madhështori*". Kuptimet e mëparshme përmbyllen me dy emra të bukur të Allahut që i përshtaten këtij ajeti, sepse potencohet lartësia dhe madhështia, të cilat janë domosdoshmëri e Allahut të Lartëmadhërishëm.[112]

Njëshmëria (tevhidi) nuk është thjesht një problematikë filozofike, sektare apo kelamiste, por është edhe problem pedagogjik (edukativ), edhe pse librat pedagogjisë rrallë e paraqesin këtë. Provë se kjo është edhe problem pedagogjik është fakti se sa i madh është ndikimi i njëshmërisë (tevhidit) në personalitetin e besimtarit, të cilin mund ta përmbledhim me sa vijon:[113]

- Tevhidi (njëshmëria) e çliron njeriun nga çfarëdolloj robërie, pos robërisë ndaj Allahut të Lartësuar. Kështu çlirohet arsyeja e tij nga mitet dhe legjendat. Çlirohet ndërgjegjja nga ndjesia e nënshtrimit, poshtërimit dhe dorëzimit. Jeta frymon lirshëm nga dhuna e despotëve, e zotërinjve dhe e atyre që u kanë rënë në qafë robërve të Allahut.

- ndihmon në formimin e personalitetit të ekuilibruar me synim dhe rrugë të unifikuar. Kështu, nuk ka zot tjetër përveç Allahut, tek i Cili njeriu i adreson gjithë punët dhe hallet e tij.

- i fal siguri dhe qetësi shpirtit të njeriut. E bën që mos të ketë frikë nga askush përveç Allahut. Për këtë arsye, ai që e njeh Zotin një dhe të vetëm është i sigurt kur njerëzit frikësohen, është i qetë kur njerëzit mërziten dhe është i relaksuar kur njerëzit tërbohen.

- Dhuron fuqi të madhe shpirtërore, prandaj i lutet vetëm Allahut, ka besim tek Ai, i mbështetet Atij, është i kënaqur me caktimin e Tij, duron kur Ai e sprovon dhe nuk

[112] Po aty, f. 36.

[113] Jusuf Abdulganij Ali: *Havle mefhumi 't-tevhidi fi rihabi 'l-Kur'ani 'l-mexhid*, revista e Fakultetit të Usulidinit dhe Daves, Universiteti i Ez'herit, Esjut, 1985, numër III, f. 61.

kërkon nevojë nga krijesat e Tij. Ky njeri është stoik si mali dhe nuk plogështohet nga hallet dhe sprovat.

- Tevhidi (njëshmëria) është themel i vëllazërisë dhe i barazisë njerëzore, sepse vëllazëria dhe barazia nuk realizohen në jetë nëse njerëzit mbahen zotërinj për njëri-tjetrin. E nëse të gjithë ndjehen robër të Allahut, atëherë ky element është fundamenti i barazisë dhe i vëllazërisë mes njerëzve. Për këtë arsye, thirrja që Muhammedi a.s. u bënte mbretërve dhe krerëve të shteteve të ndryshme përfundonte me këtë ajet:

(قُلْ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ تَعَالَوْا إِلَىٰ كَلِمَةٍ سَوَاءٍ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ أَلَّا نَعْبُدَ إِلَّا اللَّهَ وَلَا نُشْرِكَ بِهِ شَيْئًا وَلَا يَتَّخِذَ بَعْضُنَا بَعْضًا أَرْبَابًا مِّن دُونِ اللَّهِ ۚ فَإِن تَوَلَّوْا فَقُولُوا اشْهَدُوا بِأَنَّا مُسْلِمُونَ)

"Thuaj: "Pjesëtarë të Librit, ejani te një fjalë e përbashkët mes nesh e jush: të adhurojmë Allahun, të mos i bëjmë Atij shok, të mos marrim në vend të Allahut njëri-tjetrin për zota." Po të largohen, thoni: "Dëshmoni se ne jemi muslimanë!" (*Alu Imran: 64*)

- Nëse njeriu e njeh plotësisht konceptin e tevhidit, kjo e shtyn drejt sinqeritetit, mirësisë dhe trimërisë, prandaj nuk sheh asgjë pos Allahut dhe nuk i frikësohet askujt përveç Tij.

- Koncepti i tevhidit në Islam vizaton një rreth të plotë (të funksionimit) për shoqërinë dhe për mendimin human. Krejt kjo mbështetet në faktin se njeriu duhet ta udhëheqë universin nën dirigjim të Allahut dhe atëherë do të puqen vlerat shpirtërore me ato lëndore, do të lidhet zemra me mendjen dhe dynjaja me ahiretin.[114] Krejt kjo realizohet në kuadrin e një elementi gjithëpërfshirës dhe të plotësuar (siç është tevhidi) ku sundon harmonia dhe mirëkuptimi. Pra, përderisa Krijuesi është Një dhe i Vetëm, atëherë patjetër edhe te krijesat e Tij të sundojë një sistem i përkryer.

[114] Omer Muhamed Et-Tumi Esh-Shejbani: *Felsefetu 't-terbijjeti 'l-islamijjeh*, Tripoli, El-Menshe'etu 'l-Ammetu li 'n-Neshri ve 't-Tevzi'i, 1983, 39.

MENDIMI ISLAM
LOGOS·A
9 789989 158858 7

Këtë vepër e paraqes si një hyrje të denjë në rrugën e njohjes edukative islame, veçanërisht në këto rrethana që i jeton krejt bota dhe të cilat e kanë mbërthyer Islamin, muslimanët dhe mendimin islam me shumë mëdyshje të errëta. Këto faqe proklamojnë se Islami është një besim (dogmë) që e ndërton njeriun i cili i druhet Allahut, i do vëllait atë që i do vetvetes, mediton, përsiat dhe debaton me të tjerët në formën më të mirë, në mënyrë që përgjegjësinë e të qenit mëkëmbës ta realizojë përmes ndërtimit dhe ngritjes. Nuk mendojmë se kemi nevojë të sjellim argumentet, dëshmitë dhe provat që e justifikojnë përkushtimin tonë të veçantë ndaj Kur'anit fisnik dhe traditës së dëlirë pejgamberike, mirëpo ajo që duam të spikatim këtu është që qasja dhe përpjekja jonë ndaj këtyre dy fundamenteve themelore të edukimit islam të jetë një udhëzues për lexuesin dhe hulumtuesin, gjegjësisht me mënyrën e bashkëveprimit të këtyre dyjave në spektrin edukativ, apo thënë më saktë: si mund të nxjerrim nga ata dy (nga Kur'ani dhe Suneti) pikëpamje edukative që na ndihmojnë në formimin e identitetit musliman, i cili na afron me Zotin e botëve dhe na jep forcë shtytëse, e cila do ta shpjerë umetin drejt përparimit kulturor.

Këtu lexuesi mund të spikatë një lloj interpretimi rreth hulumtimit të "racionalizmit" dhe atë në shumë rrugë të burimeve të pedagogjisë islame. Në mungesë të arsyes, u luftuam nga të huajt, qoftë ekonomikisht dhe ideologjikisht... Në mungesë të arsyes u dyndën ushtritë okupatore për të na shkatërruar dhe për të na vrarë në shumë vende tona... Në mungesë të arsyes, na mbuloi prapambetja e cila na i paralizoi të gjitha potencialet njerëzore... Në mungesë të arsyes, teksti fetar u lexua në formën që ngre një mur mes tij dhe ëndrrës së lëvizjes për jetë... Arsye nuk zhvillohet vetëm duke e "mbushur" trurin apo thjesht vetëm duke mbledhur më shumë informacione fetare dhe pedagogjike, por kushti themelor për zhvillimin e arsyes në përgjithësi dhe të arsyes pedagogjike në veçanti, është vetëdija fetare e ekuilibruar me objektivat e sheriatit, e cila mundëson ushtrimin e lirisë së mendimit.